


HALIL QENDRO

# Si në balada

novelë  
tregime



8JH-32

240

Halil Qendro

---

Si në balada

novelë,  
tregime



49559

---

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

# E qara e jetës

## I Katërti

Ne jemi tre: Besari, Fatmiri dhe unë. Në të vërtetë jemi katër. I katërti është pa emër, ose, më saktë, ai ka emër, po ne nuk ia dimë. Besari e thërret Luftëtar. Po si të them, mua ky emër më duket sikur s'i shkon një foshnje kaq delikate. Besari buzëqesh dhe thotë: Po s'qe foshnjë, s'bëhesh kurrë burrë. Unë, si femër, jam më tepër kureshtare t'ia di emrin. Po s'mund ta pyesësh dhe ai s'mund të të përgjigjet për asgjë. Kujtoj emra që kam dëgjuar në këtë zonë si: Bashar, Ali, Selim, Dragush, Shaban, Kujtim, Zenun, e thërres në secilin prej tyre dhe vë re se mos fëmija reagon, po ose është shumë i vogël, ose unë nuk e godit dot emrin që i kanë vënë nëna dhe babai. Kështu, tani për tani edhe unë, kur dua ta thërres në emër, e quaj si Besari, Luftëtar. Ndofta emri që i ka vënë Besari mund të jetë më i gjeturi. Vërtet tingëllon pak i rreptë për një foshnjë, megjithëse në këtë kohë edhe fëmijët sikur rriten më shpejt dhe i riu burrërohet për një ditë. Fatmirit kjo nuk i bën asnjë përshtypje. Ai e merr në duar, kur i vjen

radha, e mbështjell mirë e mirë me velenxën e leshtë dhe, kur fillon e qan. duket që e bezdis. Por ai gjithnjë qan. Qan në krahët e mi, qan në krahët e Besarit, qan në krahët e Fatmirit. Më kot Besari e ngre lart në duar, e gudulis me mustaqet e tij të zeza për ta pajtuar. Atëherë qan dhe më shumë.

— Mbaje sa të ndez zjarrin, — më thotë mua, — përpigu mos e pushon.

Unë zbërthej xhakaventon dhe kthehem në anën tjetër. Këtë e bëj kur fëmija meket së qari dhe ne s'kemi asnjë mënyrë tjetër ta pushojmë. Në fillim ai s'e kapte fare gjirin tim, pastaj u mësua me erën e tij. Po tani e lëshon shpejt atë dhe fillon të qajë përsëri. E qara e tij mbytet nga zhurma e shiut të rrëmbyeshëm që bie. Strehët e shpellës kullojnë me çurrila dhe para nesh relievi i thyer malor vishet nga rrebeshi plot duman. Pothuajse është muzg. Në të vërtetë s'duhet të ketë perënduar dielli, megjithëse atë nuk e kemi parë gjithë ditën. Po ditët e janarit mbarojnë shpejt dhe, kur janë kështu me re, mjegulla e shira, është e vështirë të vësh kufi midis pasdrekes së vonë dhe mbrëmjes që vjen. Shiu që ka rënë e po bie, ka squllur dhe gurin dhe unë s'e kuptoj se si do ta ndezë zjarrin Besari. Shpella ku jemi strehuar është një zgavër e madhe plot kthina. Nga çatia e saj vende-vende pikojnë pika. Besari thotë se këto pika s'janë të shiut, po të vetë shpellës, që pikon kështu dhe në ditët e nxehta të verës. Ai diku kërkon rrëzave e kthinave të kësaj kamareje të madhe, megjithëse syri s'të sheh asnjë bimë. Besari kthehet me një dorë barishte që as unë s'di ku i ka gjetur. I lë ato mbi një gur dhe del përjashta shpellës. Shiu bie pa pushim. Tani s'fryn më erë. Litarët e tij duket si-

kur janë trashur e toka sikur kërcet nën për-  
plasjet e tyre. Kthehet me një degë të madhe të  
thatë. E lë dhe atë diku pranë dhe fillon e pret  
vetëm majat, i mbledh në dorë dhe u fryn me  
frymë të teren. Pastaj këput një copë leckë nga  
pelena e fëmijës, e mbledh kokël, vë mbi të fije  
për fije nga ajo dora e barit të thatë, nxjerr nga  
xhepi i brendshëm i xhamadanit të tij prej sha-  
jaku qesen e vogël me urorin, strallin dhe eshkën.  
Pas dy tri goditjeve, midis gishtit të madh të  
Besarit dhe strallit feks një pikëz e kuqe dhe  
menjëherë përhapet përreth era e eshkës që di-  
gjet. E fut atë ngadalë te leckë. Trupi i tij i  
madh ulet në gjunjë dhe fillon t'i fryjë eshkës,  
në fillim ngadalë, pastaj bulçitë e tij fryhen e  
shfryhen më shpejt. Pas timit të zi u duk vezu-  
llimi i parë i kuq i flakës. Besari vendos ngadalë  
majat e shkarpave të prera. Kur flaka zotëroi mbi  
togun e vogël, ai u kthye nga ne me një ndje-  
një kënaqësie dhe tha:

— Tani ky zjarr i vogël do të djegë dhe dru-  
rin e njomë — dhe nisi të thyente degën e thatë.  
Ne u mblodhëm të tre rreth zjarrit dhe filluam  
të ngroheshim, po nga krahët ende ndienim të  
ftohtë. Fëmija po qante. Unë e mbaja pranë  
zjarrit dhe fytyra e tij, ca nga reflekset e fla-  
këve, ca nga të qarët me ngashërime, kishte ma-  
rrë ngjyrën e kuqe të bakrit.

— Qan nga uria, ku ta dish se kur ka pirë  
për herë të fundit, — foli Besari me një ndjenjë  
dhembjeje.

Ai u ngrit dhe nxori nga çanta një copë bukë  
misri dhe qesen e bollgurit. Këto ishin të vetmet  
rezerva ushqimore që kishim. Unë mora një  
copëz bukë, e thërrmova, e njoma dhe ia futa  
fëmijës në gojë, por ai e nxirrte atë jashtë dhe  
qante. Shokët, kur u ndamë, bollgurin na e

dhanë për foshnjën, kurse atë cope bukë për ne. Bollgur më kishte takuar të haja vetëm tani që isha partizane. A do ta hante atë ky fëmijë, që mua më dukej se nuk ishte më shumë se tremuajsh? Po s'kishim asgjë tjetër. Te shpella e Malit me Thepa, ku morëm këtë jetim, midis të vrrarëve, gjetëm këtë bollgur, një thes me misër dhe pak bukë. Pjesën më të madhe të bukës na e dhanë neve, që niseshim me një fëmijë diku midis njerëzve, ndofta te një nënë. Ai u kishte shpëtuar plumbave të gjermanit dhe s'do ta llinim të vdiste. Ky fëmijë, midis asaj masakre, u bë më i rëndësishëm se jeta e batalionit tonë, që kalonte nga një pritë në tjetrën, që vuante nga uria dhe të ftohtët, që duhej t'i shpëtonte darës së hekurt të operacionit armik duke rënë dhe një, dy dhe tri herë në ditë në përpjekje. Poshtë lugina nxirrte tymin e shtëpive që digjeshin. Një ditë më parë forcat e batalionit tonë bënë një manovër të guximshme. Kaluan qafën më të lartë të Malit me Thepa dhe i zunë gjermanët e ballistët në befasi. Ajo qafë në kohë dimri qe i vetmi shteg që e kishin lënë ta ruante me duart e saj të ftohta dëbora. Kur pandehnin se partizanët ishin tretur, ne u ramë në befasi, vramë e zumë robër. Të tjerët, në panik, nuk dinin nga të iknin. Pasdreke erdhën forca të reja gjermane nga qyteti duke pasur para një tank. Pas 3 orë luftimesh ne u tërhoqëm në drejtim të Malit me Thepa. Dy kompani u vendosën të manovronin andej nga kishin qenë para dy ditësh. Kur u kthyem te shpella, gjetëm gra, pleq, fëmijë të pushkatuar, të hedhur tok mbi njëri-tjetrin, të copëtuar e të shpuar me bajonetë dhe këtë fëmijë të gjallë, përposh djepit, të këthyer përmbys, të mbuluar nga trupi i gjakosur i nënës. Atë e morën partizanët me radhë në duar. Qante

fëmija e bashkë me të rridhnin dhe lotët e shokëve. Komanda e batalionit thirri Besarin, Fatmirin dhe mua. Ne duhej ta nxirrnim këtë fëmijë në një zonë të lirë. Me çdo çmim duhej të siguronim jetën e tij. Me siguri mua më zgjodhën si femër. Unë duhej të isha në vendin e nënës, kurse ata të dy, Besari dhe Fatmiri, mbrojtësit e vërtetë të tij. Por unë isha ende vajzë. Tani përpiqesha të kujtoja diçka nga fëmijëria ime, si kisha ngrënë, si më kishte ushqyer nëna, ose çfarë mbaja mend nga ato që kisha parë. Kisha qenë fëmija i dytë i shtëpisë dhe i fundit. Babai im ishte mësues e në krahasim me fëmijët e tjerë unë duhej të isha rritur më mirë. Më vinte inat që huqet e një fëmije unë i njihja më keq se Besari. Tani do t'i jepnim bollgur, po, dhe nëse do ta hante, ku do ta zienim? Ja një hollësi që nuk na kishte shkuar fare në mend. Se, ndryshe, ne atje në shpellë do ta kishim gjetur një sahan ose një gavatë te partizanët. Këtë gjë duhej të bluante në mend tani dhe Besari, se shikonte qesen me bollgur dhe heshtte. Ai mori një pllakë guri dhe e vuri në tokë, mbi të vuri qesen me bollgur, kërkoi dhe gjeti një gur të rrumbullakët sa grushti dhe filloi ta rrihte, gjersa e thërrmoi imët. Mua m'u kujtua mielli i orizit që u jepnin nënat fëmijëve, sidomos kur u prisnin gjirin. Besari miellin e hollë e hodhi në pagur dhe e vuri për ta zier në zjarr. Paguri që e vetmja enë që kishim ne të tre me vete. A do ta kish gjetur ndonjëri nga ne të tre këtë zgjidhje, mendova me vete, kur po shikoja profilin e Besarit pranë zjarrit. Po nga këto mendime më shkëputën të qarat e fëmijës. Atij tani i ishte ngjirur zëri.

— Shiko mbase e pushon dhe pak, sa të marrë një valë të zier, — u dëgjua zëri i Besarit.

Unë zbërtheva kraharorin, u ktheva krahët të dy shokëve dhe ndjeva atë gudulisjen e zakonshme të gjiri. Pagurin e mbushur me bollgurin e porsazier, për t'u ftohur sa më shpejt, e nxorëm nën shiun që binte përjashta. Në grykën e pagurit, të kthyer kokëposhtë, vendosëm një shami dhe lëngu filloi të kullonte në lugën prej druri të Besarit. Nisëm t'ia jepnim fëmijës. Në fillim ai s'e pranoi. Teshtiu duke rrudhur buzët e vogla. Unë e provova se mos ishte i nxehtë. Ia vura përsëri lugën te goja, por ai i mbante të mbyllura buzët. Ne që të tre heshtnim, buzët e fëmijës qenë nën vështrimet tona të përqendruara. Ia hapa lehtë gojën me anë të lugës, po prapë fëmija s'po reagonte. Po sikur të mos hante? Nga kjo varej jeta e tij. Ne s'kishim ç't'i jepnim tjetër dhe as mund ta dinim se ku mund ta gjenim një ushqim të përshtatshëm për të. Kjo foshnjë mund të bëhej vetë shkaktar i vdekjes së tij. Si mund të merreshe vesh me të?

— Hidhi pak në gojë, sa të mësohet, — tha Besari.

Buzët e foshnjës lëvizën dhe unë e ktheva lugën që t'i shkante sa më shumë lëng bollguri.

— Po pi, — i thashë.

— Është me ymër të gjatë, — foli Besari.

Fatmiri po i vinte dru zjarrit për të bërë flakë që të mund të shihnim për të ushqyer fëmijën. Fëmija filloi të rrufiste gjithnjë e më shumë dhe ne të tre shihnim se si boshatisej luga. Flaka binte mbi fytyrën e të voglit.

— Mos nuk duhet të hajë shumë se i bën dëm, — u dëgjua zëri i Fatmirit.

— Ka shumë uri, — tha Besari.

Unë ia mbaja lugën plot te goja. Pas një pushimi të shkurtër nisi të rrufiste prapë. Besari i fshinte me shami bollgurin që i binte



nga luga në të dyja anët e buzëve. Dhe ashtu siç e mbaja në duar, me sytë gjysmë të mbyllur, vazhdonte t'i lëvizte buzët në mënyrë të pavetëdijshme, gjersa e zuri gjumi.

— Ta vëmë të flejë, — tha Besari. — Mbaje ashtu në duar, sa t'i bëj një shtresë të vogël.

Silueta e tij u zhduk në errësi. Pas pak erdhi me një krah degësh në duar. I theu, i ngrohu një për një pranë zjarrit për t'u ikur lagështia dhe i shtroi njëra mbi tjetrën, duke formuar një shtrat të vogël. Unë shtrova në fillim velenxën dhe pastaj e shtriva në shtratin prej shkarpush. Gjithçka ky fëmijë e kishte të tijën, siç ia kishte përgatitur e ëma. Ne e gjetëm te shpella të lidhur në djep. Dukej që e ëma as kish pasur kohë ta zgjidhte. Ndofta ky kishte qenë dhe fati i fëmijës që i kishte shpëtuar egërsisë shtazarake të gjermanëve. Kur kujtoj atë skenë, më rrëqethet mishtë dhe përpiqem ta harroj. Por është e pamundur. Ky fëmijë i gjallë është kujtimi i përhershëm i tyre. Ishte fare pranë zjarrit. Dukej vetëm fytyra e rrumbullakët me hundën e sytë e vegjël, kur ende asgjë s'ka marrë formë të veçantë. Për herë të parë po flinte i qetë dhe ne të tre po ndienim në shpirt paqen e fytyrës së tij. Besari mori lugën, e fshiu dhe e futi në xhep.

— Ky bollgur që jeta e tij, — tha. — Ai kushedi sa ka pa ngrënë. Ne ndofta as nesër s'do të kemi mundësi t'i gjejmë ushqim tjetër që i duhet këtij voçërraku.

Ai nxori thikën dhe ndau copën e bukës së misrit në tri pjesë. Ne e thekëm dhe filluam të hanim. Darka jonë që e varfër dhe e shkurtër. Por asnjëri s'mendonte kështu. Shokët e batalionit mundet që sonte s'kanë ç'të vënë në gojë, kurse ne e kishim një copë bukë.

Jashtë nata qe varur errët. Ne zjarrin e kishim ndezur në një cep të shpellës, pas një bërryli që as era të mos na zinte, as zjarri të mos diktohej. Fëmija u përpëlit dhe lëvizi. Filloi përsëri të qante. Unë e mora dhe po e mbaja në duar.

— Mos do të pijë?

Fatmiri pruri pagurin. Mbusha përsëri lugën e drunjte të Besarit dhe fillova ta ushqeja. Piu fare pak dhe filloi sërish të qante.

— Ma jep mua, — tha Besari.

Ai e mori në duart e mëdha dhe po e lëkundte si në djep.

Ooooooo!

*Merre, gjumo, djalino!*

*Aaaa!*

*Djali ynë marshalla!*

*Rritu, rritu si bandill,  
të të vërë xhaxhi yll.*

Ooooooo!

Zëri i Besarit mbushte shpellën e zgavruar dhe ajo i përgjigjej me akustikën e saj.

— Ti duhej të kishe lindur grua, — tha Fatmiri.

— Unë jam djali i parë pas shtatë vajzash, — foli Besari. — Nëna më ka lindur në arë. Jam shtatanik dhe vjeshtak. Nënë e goditi me shqelm në bark kau, kur po lëronte. Gjyshja thoshte se isha sa një krimb dhe askush nuk besoi se do të rroja. Më mbante me lesh të palarë.

— Shtatanikët bëhen më të fortë, thonë.

— Ja, shikomë mua, — tha Besari me çiltërsi.

Flaka e zjarrit ia bënte dhe më të kuqe fytyrën e gjerë me tipare që s'harrohen kollaj. Besari qe në togën e dytë të kompanisë sonë

dhe e njihja, kurse Fatmiri qe i kompanisë së parë dhe nuk e kisha parë më shumë se dy-tri herë; megjithëse tani e mora vesh se jemi nga i njëjti qytet. Ndryshe nga Besari, që e ka shpirtin të hapur e të lexueshëm si zalli i një lumi, Fatmiri fliste pak dhe unë s'e kuptoja përse kishin zgjedhur pikërisht atë, që mua më dukej se nga ne të tre, për detyrën që na kishin ngarkuar, shqetësohej më pak. Por edhe për Besarin nuk dija ndonjë gjë të madhe. E merrja me mend që ishte fshatar. Ai dukej për këtë në çdo veprim: nga të folurit me zë të lartë, nga të ndenjurit këmbëkryq, nga luga prej druri e brisku, siç i thoshte ai një thike të vogël me dorezë e këllëf briri. E prapë këtë njeri më dukej sikur e njihja prej kohësh, edhe para se të vinte partizan.

— Ty, Fatmir, mbase nëna të ka lindur në dyshek, — tha Besari, — si të gjithë fëmijët e qytetit.

— Nuk e di.

— Si s'e di? S'ke rënë ndonjëherë në muhabet me nënën?

— S'e kam njohur as nënën, as babanë. Jam rritur në Strehën Vorfnore.

Pas këtyre fjalëve ra heshtja dhe unë e Besari kishim ulur sytë te prushi i zjarrit.

— Mbase të lëndova, po s'dija gjë, — tha Besari me një zë, më të trashë e më të mbytur nga ç'fliste përherë.

Fëmijën ia kishte zënë gjumi në duar.

— Shqipëria e lirë do të jetë më parë e jetimëve, — foli dhe e uli foshnjën ngadalë në shtratin e vogël prej shkarpash. Fatmiri s'fliste. Pas atij dialogu të shkurtër, unë ngrita sytë dhe hetova fytyrën e tij, sikur atje do të gjeja diçka që s'e kisha zbuluar dot më parë. Por

asgjë. Tiparet e tij të hequra djaloshare kishin po atë rregullsinë e përhershme. Ne ishim nga i njëjti qytet. Qyteti ynë s'është aq i madh. Banorët e tij, në mos një për një, njohin familjet e njëri-tjetrit, llagapet, lagjet. Ai mbiemri i tij Grezda ishte edhe për mua i njohur. Banonin në lagjen e fundit, mbështetur te faqja e kodrës, menjëherë sa hedh urën e lumit. Duhet të jetë dy-tre vjeç më i madh se unë, që kam lënë përgjysmë klasën e tretë të gjimnazit. Po tani e kuptoj gjithçka. Ai shkollën dhe banimin i ka pasur në një qytet tjetër, se në qytetin tonë nuk ka pasur Strehë Vorfnore. Tani ishte e shpjegueshme për mua natyra e tij e ftohtë. Ai në jetë s'kishte ndier kurrë dorë nëne dhe të afërmi. Për të njerëzit janë njësoj të afërt dhe të largët. Shikova përsëri fëmijën që flinte dhe s'di pse ndjeva një boshllëk në zemër, kur mendova se rreth zjarrit qëndronin dy jetimë. Ndofta komanda prandaj dhe duhej ta kishte caktuar Fatmirin, se midis atij që po përcillnin dhe jetës së tij, kishte fije të forta që i lidhnin. E kishin caktuar apo Fatmiri kishte dalë vetë vullnetar? Unë këtë s'e dija dhe më vinte çudi me vete pse i shkoja tani gjithë këto gjëra nëpër mend.

— Ti, Teuta, do të rrish pranë djalit dhe do të flesh bashkë me të, — u dëgjua zëri i plotë i Besarit. — Unë e Fatmiri do të bëjmë rojë me radhë. Po filloj unë i pari, ju të dy bini të flini. Nesër do të ngrihem herët.

U ngrit dhe shkoi në dalje të shpellës. U kthye dhe filloi t'i hidhte dru zjarrit. Ai ishte lagur më shumë se ne të dy, se hynte e dilte vazhdimisht nga shpella. I ktheu krahët zjarrit dhe nga shajaku i zi i palltos dilyn avuj. Ai ishte veshur trashë. Me përjashtim të një kape italiane, të tjerat i kishte prej shajaku. Unë e Fatmiri kishim nga

një palë kilota, xhakavento italiane dhe këpucë me qafa. Fatmiri i kishte vënë këpucët pranë zjarrit. Ato ishin hapur të dyja dhe i futnin ujë nga balli. Unë këpucët i kisha më të reja, se m'i kishin dhënë pak para fillimit të operacionit. Fatmiri kishte vënë automatikun nën kokë dhe e kishte zënë gjumi. Unë isha shtrirë pranë fëmijës dhe doja të flija. Gjatë ditës kishim udhëtuar duke hetuar mirë për çdo hap që do të hidhnim. Duhej t'i shmangeshim çdo lloj përpjekjeje me armikun. Nuk llogaritej jeta jonë, po jeta e fëmijës. Shpesh ishim kthyer në vende të mbrojtura për të mos lagur shiu fëmijën. Po të lagej, rrezik të na vdiste në duar, se ai ishte tepër i njomë. Unë dëgjoja frymëmarrjen e tij këtu pranë, një frymëmarrje të lehtë, të shpeshtë dhe kisha qejf ta përgjoja, t'i qëndroja mbi kokë. Sa bukur, mendova me vete. Po më lind dashuria e nënës shumë shpejt, dhe m'u duk sikur ky mendim shkonte gjer te Besari, që po ngruhej pranë zjarrit. Papritur më vajtën sytë në tavani të shpellës, te loja e flakëve që po luhateshin vazhdimisht. Pastaj u dëgjua e gërhitura e lehtë e Fatmirit. Pashë të lëvizte silueta e Besarit, që u afrua, zhveshi pallton prej shajaku dhe mbuloi me të fëmijën e pjesën që mbeti e hodhi mbi krahët e mi. Unë pulita qepallat dhe për këtë njeri më rrodhi në zemër një ndjenjë mirësie. Dhe ashtu më zuri gjumi.

### *E qara e jetës*

U nisëm që pa zbardhur. S'dinim sa mund të ishte ora, po yjet digjeshin në qiellin blu të errët dhe dukeshin të kuqe e të kujtonin lulet e

shegës. Ishte ende errësirë e plotë e me përjashtim të dëborës, që zbardhte nën këmbët tona, gjithçka përreth ishte gëlltitur nga terri. Vetëm kur u shkonim pranë, shquanim turbull trungjet e pishave. Terreni ku udhëtonim, që i pjerrët dhe ne i hidhnim këmbët me kujdes mos shkisinim mbi dëborën e ngrirë. Herë pas here dëgjohej zhurma e dëborës që binte nga pishat e shoqërohej me një «kraf» të degëve që thyheshin. Në qetësinë që zotëronte, hapat tanë dëgjoheshin me një ritmikë monotone. Përpara ecën Besari, në mes unë me fëmijën dhe pas meje Fatmiri. Bën shumë ftohtë, sa e ndiejmë brymën e frymës që na ngrin te buzët. Kjo heshtje e kredhur në errësirë të ndjell pabesinë dhe të bën t'i mprehësh më shumë veshët e shikimin.

Papritur, qetësia që zotëronte u prish nga ulërima të frikshme. Një ulërimë ngrihej e thekshme dhe pasohej nga të tjera, sa vendi dridhej përreth.

— Lukuni ujqish, — tha Besari.

Ne kishim ndaluar të tre. Ulërimat ishin diku përpara nesh. Filluam të ecnim ngadalë; e dini se s'mund të ktheheshim prapa. Ulërimat çirrnin terrin dhe po na afroheshin gjithnjë e më shumë. Qëndruam.

— Po sikur të zbritnim poshtë?

— Tani ata do të na ndjekin kudo që të shkojmë, — tha Besari. — Janë të uritur dhe të hakërryer nga dimri.

Ujqit vinin nga sipër. Ne dëgjonim ulërimat që po na afroheshin. Kisha dëgjuar gjatë jetës sime në male dhe herë të tjera ulërima ujqish, po kurrë kaq afër.

— T'i qëllojmë për t'i trembur, — tha Fatmiri.

— Kur janë lukuni, kështu të uritur, vështirë se tremben nga krismat, — tha Besari. — Pastaj, të shkrepësh në këtë errësirë memece, do të thotë të japësh alarmin e të të dëgjojnë një ditë larg.

Ne kishim qëndruar te trangu i një pishe me armët gati. Me sy nuk shikonim asgjë, po zhurmat dhe ulërimat e tyre i ndienim, se i kishim shumë afër. Për një çast ulërimat pushuan dhe ne dëgjuam nga të gjitha anët kërcëllima dhëmbësh. Unë kurrë në jetën time s'kam dëgjuar gjë më të tmerrshme e më të frikshme. Ishin ca kërcëllima të thekshme, sikur i pille thellimi e të ngjante si një kërkëllimë eshtrash që brejnë njëra-tjetrën.

— Po na rrethojnë për të na sulmuar. Ti me fëmijën hip lart në pishë, — urdhëroi Besari. — Ndihmoje, Fatmir, fëmijën po e mbaj unë.

Fatmiri uli kurrizin të mbështetësja dhe fillova të ngjitesha. Kur hipa në degën mbi koka të tyre, ma dhanë fëmijën.

Fatmiri u bë gati të qëllonte me automatik nga vinin ato kërcëllima të kobshme dhëmbësh.

— Mos! — tha Besari. — Ashtu egërsohen më shumë. Hidhma një degë pishe dhe një copë leckë. Shpejt! — m'u drejtua mua.

Unë s'po kuptoja ç'i duhej dega e pishës dhe leckë. Preva një degë, këputa një copë rreckë nga pelenat e Luftëtarit dhe ua hodha me dorën që më dridhej. Ajo kërcitje dhëmbësh gjithnjë e po ngushtohej nga të gjitha anët. I kisha ngulur sytë atje poshtë. Me një dorë mbaja fëmijën e tjetrën e kisha vënë në këmbëzën e shkrepjes së automatikut të mbështetur në gjoks. Diku aty afër pashë dy sy me një ndriçim të verdhë, të palëvizshëm, sikur të digjeshin dy pika fosfori në trup të natës. E drejtova tytën e

automatikut drejt tyre. Ndërkaq Besari kishte nxjerrë një fishek maliheri, me majën e thikës e hapi gëzhjojën, i hoqi plumbin, barutin, e hodhi në leckë dhe e ndezi me eshkën që kishte zënë me uror. Me flakën e leckës ndezi pishtarë prej degave të pishës dhe me Fatmirin po qëllonin nga të gjitha anët në drejtim të ujqve. Zbrita dhe unë. Gjetëm degë të thara përreth dhe të tre filluam të qëllonim vazhdimisht me pishtarë. Ashtu duke vërtitur pishtarët, na shfaqeshin nofulla të shtrënguara me dhëmbë të shpërveshur që iknin të frikësuar prej zjarrit.

Ai rrethim dhëmbësh më në fund ishte çarë. Ujqit diku mbi ne kishin filluar përsëri ulërimat. Ishte zgjuar Luftëtari dhe po qante. Unë fillova ta lëkundja si në djep, gjersa pushoi dhe ne të tre u nisëm përsëri. Vendosëm që një pishtar ta mbanim të ndezur. Me të në duar Besari na udhëhiqte rrugën. Pishtari na ndriçonte atë copë vend ku ecnim. Flaka e tij në dorë të Besarit dukej në mes territ si zemra e kuqe e një shalqiri e kur binte mbi bar, ajo merrte një ngjyrë të verdhë, gati si të portokallit. Shpati ku ecnim ishte i pjerrët, me pisha disi të rralla e të larta. Nuk kishte asnjë shenjë rruge dhe Besari na thoshte se diku përpara na priste një qafë. Duhej të përfitonim nga errësira që atë qafë ta kalonim sa më shpejt që të qe e mundur! Po sulmi i papritur i ujqve na kishte vonuar. Pak nga pak yjet po zbardhëlleheshin dhe ajo ngjyra blu e errët e qiellit po ia linte vendin agut të mëngjesit. Sendet po përvijonin konturet dhe gjendja përreth na shfaqej e kredhur në një dritë të mugët. E shuam pishtarin. Na ishte shfaqur me tërë bukurinë e tij të egër peizazhi përreth. Poshtë nesh shtrihej një luginë që për-kundej si një djep në mes dy shpateve të thepi-



sura malesh. Ajo ishte e çliruar nga dëbora dhe mes për mes saj dredhonte një rrugë këmbësore që të nxirrte në qafën që ngrihej mbi të, e harku i qiellit dukej midis dy çipineve si kolona viganë në të dyja anët. Vende-vende zbardhnin vllanngat e dëborës që dukej se e kishte shkrirë shiu i djeshëm. Ne, duke hetuar vendin që nga shpella, kishim vendosur ta mënjanonim rrugën që ecte gjatë luginës, pasi ishte kohë operacioni dhe gjermanët mund të na dilnin në çdo çast. Më në fund dolëm sipër qafës, në gërxh dhe qëndruam. Duhej të kishim udhëtuar më shumë se dy orë. Mëngjesi ishte hapur dhe drita po zotëronte gjithnjë e më shumë. Fëmija ende po flinte. Duke e ndërruar me radhë, në ecje e sipër, në krahët tanë ai ishte si në një djep lëvizës. Te qafa kryqëzoheshin rrugë të shumta këmbësorësh. Disa u ngjiteshin shpateve në të dy krahët dhe humbisnin te kufiri i dëborës, ndërsa rruga kryesore zbriste poshtë, gjersa humbiste te briri i këmbës së malit. Ashtu të ulur, tani ndienim të mardhurën e këmbëve, ndërsa hunda, veshët dhe gishtërinjtë e duarve gati na ishin tharë.

— Kjo quhet Qafa e Kreshtës, — tha Besari.  
— Po të dalësh tej bririt, të shfaqet rrafshnalta e Shpatit. Vitin që kaloi për tërë natën kemi përshkuar këtë zonë dhe kemi dalë te kjo qafë.

Unë s'mbaja mend asgjë. Fatmiri ndoshta atëherë ende s'kishte ardhur në batalionin tonë. Po për ne ishte gjë e zakonshme të përshkonim zona e krahina të tëra natën duke na mbetur përfytyrimi i turbullt i tyre. Larg, në qiellin që varej tej bririt, u dukën re të holla.

— Ato janë re tymi, — tha Besari. — Zona e shpatit po digjet.

49559

Retë e holla puplore po shtoheshin. Syri i Besarit nuk kishte gabuar. Kjo na bënte të ishim dhe më të vëmendshëm. Mëngjesi po zbardhte horizontet dhe çdo gjë përreth po kri-dhej në dritën lehonë të ditës që vinte. Ne e njihnim zakonet e gjermanëve, që s'leviznin kurrë natën. Ata, sapo gdhihej, fillonin ndjekjet. Nuk po merrnim asnjë vendim për të lëvizur më tej. Fëmija filloi të qante.

— Ka nevojë për ushqim, — thashë unë, që përpiqesha më kot ta pajtoja.

Besari nxori pagurin, që e mbante varur në brez. Ai me vështirësi i hoqi mbyllësen.

— Ka ngrirë, — tha.

Më kot e tundte. Lëngu i trashë i bollgurit ndofta atje brenda do të qe bërë tutkall. Po mendonim se a mund të ndiznim shpejt e shpejt një zjarr, ndryshe e qara e fëmijës do të na shoqëronte gjatë gjithë rrugës. Neve vetëm kjo s'na kishte shkuar ndër mend. Me prushin e zjarrit, që kishte qëndruar gjithë natën ndezur në shpellë, mund ta kishim ngrohur pagurin në mëngjes para se të niseshim ose mund ta kishim ngrohur me pishtarët gjatë rrugës. Besari u ngrit të mbli-dhte shkarpa për të ndezur zjarrin, ndërsa unë vazhdoja ta tundja fëmijën, ashtu siç e kisha të lidhur në duar, duke e shoqëruar me një o të zgjatur. U dëgjua rrokullima e thatë e një guri dhe pastaj zëri i mprehtë plot tension i Fatmirit:

— Gjermanët!

Te briri kishte dalë kreu i murrmë i kolonës gjermane. Bishti i saj qe i shkurtër. Ajo duhej të ishte pararoja dhe pas saj duhej të vinin repartet ndjekëse. Ne tashmë ishim mësuar me zakonet e reparteve alpine të gjermanëve. Kishte ardhur dhe Besari dhe qëndronim të tre, në mes të gërxxhit, të fshehur, pas gurëve me thepa. Fë-

mija qante. Briri s'ishte as 300-400 metra larg nesh dhe tani, të lëviznim, do të binim në sy. Pararoja ecte ngadalë. Dukej që gjermanët s'ishin të shqetësuar nga asgjë. Ndofta mund të shkonin ashtu pa i shqetësuar gërxhi ku ishim strehuar ne, por ajo e qara e fëmijës nuk mund të mos dëgjohej. Unë zbërtheva xhakaventon dhe shpejtova t'i vija gjirin në gojë. U ndesha me sytë e Fatmirit dhe në fytyrë më shkoi e skuqura djegëse. Fëmija e zuri gjirin dhe po e thithte. Pararoja kishte dalë në qafë, kishte qëndruar dhe dylbitë e një frici herë i drejtoheshin luginës, herë shpatit të djathtë e herë të majtë të dy masiveve malore që ngriheshin në të dyja anët e qafës. U drejtua dhe nga gërxhi ynë. Ne ishim platitur mes gurëve me thepa e shikonim mes të çarave të tyre gjithë veprimet e pararojës gjermane. Fëmija e lëshoi gjirin dhe ia plasi të qarit. Piskama e foshnjës kishte shkuar deri atje në qafë, se nazisti me dylbi përsëri iu drejtua gërxhit. E futa kokën e vogël të fëmijës në gjoks, që të paktën zëri t'i platitej sa të ishte e mundur. Dylbitë s'i hiqeshin më gërxhit dhe dukej se gjermanët diç thoshin mes tyre. U dëgjuan dy të shkrepura dhe në qiell fluturuan një raketë blu dhe një e kuqe.

— Na diktuan! — tha Fatmiri.

— Duhet të veprojmë sa më shpejt, pa ardhur forcat e tjera, — thashë unë.

— Ju të dy do të ikni me fëmijën, ndërsa unë do të qëndroj këtu, — foli Besari. — Po ju jap porosinë e komandës dhe bazën ku do ta lini fëmijën.

— Jo, — tha Fatmiri, i qetë, — këtu do të qëndroj unë. Pas Teutës, ti duhet të jesh i fundit që do të ndahesh nga fati i këtij fëmije.

— Këtu vendos unë, — tha Besari.

— Vendos fati i foshnjës. Ne të tre jemi për atë. Ai që do të qëndrojë këtu jam unë, — përsëriti qetë e me zë të vendosur Fatmiri. — Çdo minutë është e shtrenjtë. Çdo vonesë është vdekje. Ikni! — tha ai me ton të prerë. — Për mua mos kini merak. Unë e di se ç'duhet të bëj.

Pas atyre fjalëve Besari s'foli më, sytë e tij të zinj morën një shkëlqim të veçantë e u mbushën me një lëng pa ngjyrë. E mbështolli trupin e imët të Fatmirit në kraharorin e madh, më rrëmbeu mua fëmijën dhe ma bëri me shenjë që të niseshim. Edhe unë doja ta përqafoja, por ai që shtirë në pozicion dhe kishte vënë automatikun në shenjë nga vinin gjermanët. Automatiku i tij shkrep. Ne ecëm gati barkas gjersa hymë në korijen e pishave. Unë shkoja pas Besarit. Ishim kthyer faqes së malit nga kishim ardhur. Këtej vendi ishte më i veshur dhe kishim mundësi të largoheshim pa u diktuar. Fëmija qante, po ne atë të qarë duhej ta çonim sa më larg gjermanëve. Krismat te gërxi vazhdonin. Herë pas here dëgjonim të shtënat e vetmuara të automatikut të Fatmirit. Po krismat e gjermanëve ishin të shumta. Ai e kishte tërhequr gjithë atë batare krismash rreth vetes dhe po na jepte gjënë më të shtrenjtë, kohën. Ecnim pothuaj po asaj rruge që kishim ardhur e, për të mos lënë gjurmë, nuk shkelëm asnjëherë në brezin e dëborës që na shoqëronte gjatë gjithë shpatit të malit.

Unë kujtova se Besari do të na çonte te shpella ku kishim kaluar natën dhe, po të na diktonin, do të bënim atë që po bënte Fatmiri te gërxi. Po te gryka e një hosi që varej nga mali, Besari qëndroi. Ai e hetoi atë humnerë shkëmbore me sy dhe filloi të ngjitej i pari me

fëmijën në dorë, që s'e kishte pushuar ende të qarën. E thepisura e hosit s'e mbante fare dëborën, ajo qe e zhveshur dhe mund të dallohe-shim që larg. E ndoqa pas. Po ngjiteshim. Gjer në njëfarë vendi për mua u bë e pamundur t'u qepesha atyre thepave. Duart më ishin vrrarë dhe nga njëra më rridhte gjak.

— Ik, Besar! Unë s'ngjitem dot më lart.

— Nuk të lë vetëm.

— Njëri nga ne duhet të jetojë, të shpëtojë fëmijën.

— Më prit këtu, — tha dhe, me fëmijën në njërën dorë, filloi të ngjitej.

Unë e ndiqja me sy, pastaj humbi mes kthinave të thepave. Dëgjohej vetëm piskama e foshnjës, që në zgavrën e humnerës hollohej edhe më e, po të mos e dije, mund ta merrje për ndonjë klithmë shpendi... Pas pak u duk tek po zbriste.

— Hiq rripin e mesit, — tha.

Ma lidhi fort pas qafës së dorës; ai ngjitej i pari dhe unë pas tij, duke u mbajtur pas rripit. Arritëm te fëmija. Kështu bëmë dhe tri ngjitje të tjera, gjersa mbërritëm te një petaraq i madh, që kishte një guvë shkëmbi përsipër. Unë merresha me fëmijën për ta pushuar, por ai vazhdonte të qante. Tani ishim larg, kjo e qarë nuk na rrezikonte më. Jehona e krismave arrinte gjer te ne. Ndoshta kishim ecur gjysmë ore, ndoshta më shumë, por ishim larguar aq, sa gjermanët vësh-tirë të na i gjenin gjurmët. Mendja ime dhe e Besarit ishin te krismat. Pas pak ato pushuan. Një raketë e gjelbër u harkua në kupën e ftohtë të qiellit dhe ra diku në luginë. Unë shikova Besarin. Ai kishte ndezur çibukun dhe nxirrte shtëllunga tymi. Pastaj mori fëmijën, e puthi duke e mbuluar me mustaqet e zeza dhe një pikë loti i rrodhi gjer te mjekra. Mbarimi i atyre kris-

mave na lajmëronte se Fatmiri nuk ishte më. Unë ula kokën, se s'desha të më shikonte Besari vrushkullin e lotëve që po më mbushnin sytë. S'kaluan as dhjetë minuta dhe gjermanët filluan ndjekjen në formacion luftimi gjatë gjithë luginës. Ata ishin poshtë këmbëve tona dhe ne i ndiqnim lëvizjet e tyre, që dukeshin e zhdukeshin mes lisarishtës e gëmushave të rralla. E kaluan tërë atë luginë duke shkrepur batore herë pas here. Jehonat e krismave përhapeshin me një zhurmë të madhe që na kujtonte betejat. Këto jehona shtyheshin gjithmonë e më tutje, gjersa u mbytën në grykat e thella të maleve. Peizazhi i ngrirë i ditës së janarit kishte hyrë dhe midis nesh. Nuk fliste asnjëri. Besari vazhdonte të mbushte dhe të zbrazte çibukun. Ai mund të rrinte pa ngrënë, po s'mund të rrinte dot pa e tymosur çibukun e vogël prej druri në ngjyrë të verdhë të ndritshme. Kur donte të kursente, e rrotullonte bishtin e tij nëpër dhëmbë, kurse këtë mëngjes as që e vinte re qesen e duhanit që po boshatisëj. Të dy vazhdonim të heshtnim. Ishte një heshtje e gjatë e munduese që përzë fjalët midis njerëzve. Mbase nuk ishte fare heshtje. Ne diç bisedonim thellë me vetveten. Kur papritur u dëgjuan cicërimat e një zogu, ca cicërima të holla e të mekura që dukeshin sikur dikur do të këputeshin. Kjo duhej të ishte kënga e tij. Ishte diku mbi kokat tona, në një kthinë të shkëmbit. M'u duk sikur Besari diç deshë të thoshte. Ai u ngrit dhe hodhi mbi një pllakë aty pranë ca kokrriza bollguri. Zogu u ul t'i çukiste.

— Këtij ne i themi cinxami. Është i vogël, po një zog trim, që di të përballojë dimrat dhe në vendet më të ftohta, — tha Besari.

Kishte krahë ngjyrëkafe të errët dhe kraharor të përhimtë. Ishte dhe më i vogël se la-

purakët e çerdheve. E çuditeshe! Ku e gjente fuqinë të këndonte në këtë mesdimër, kur kudo mbizotëronte dëbora. U ngjit përsëri te shkëmbi dhe filloi të cicëronte. Ne e dëgjonim dhe s'flisnim. U dëgjua dhe e qara e Luftëtarit. Besari u ngrit dhe nderzi një zjarr. Ngrohu bollgurin dhe ushqyem fëmijën, kurse zogu lart vazhdonte të këndonte. Na u desh të prisnim gjatë te ky hos, ku ishte e vështirë të ngjiteshin gjermanë. Ata që përshkuan luginën e dy faqet e shpatit ishin më tepër se pararoja që ndeshëm ne te gërxhi. E megjithatë, për të qenë të sigurt, qëndruam gjersa kaloi dreka. Kur zbritëm poshtë, dielli kishte filluar të varej mbi male. Frynte një thëllim i lehtë. Pasdrekja e kishte ftohur motin dhe më shumë dhe dielli atje lart ishte i pafuqishëm ndaj gjithçkaje.

Te gërxhi gjetëm trupin e Fatmirit të vvarë. E kishin marrë shumë plumba dhe fytyrën ia kishte mbuluar gjaku. Kishte rënë përmbys. Pas kokës dukej e çara e një plage të madhe, e qëlluar nga afër. Varrin e tij e hapëm në dëborë, nën një lis shekullor me degë të mëdha e të gjera.

Qëndruam të dy para varrit dhe nderuam me grusht. Sipas zakonisht partizan, lamtumira e fundit jepej me një batore pushkësh. Po ne këtë s'mund ta bënim. Këto ditë, në ndryshim nga gjithë partizanët e Shqipërisë, përpiqeshim t'i fshihnim armikut çdo gjurmë. Nuk mund ta qëllonim, edhe kur e dinim se mund ta vrisnim, nuk mund t'i shfaqeshim edhe kur zemra na ndizej e gjaku na vlonte nga urrejtja për hakmarrje. Kjo e bënte detyrën tonë edhe më të vështirë, edhe më të rëndë. Na dukej sikur Fatmirit i kishim një borxh.

— Na e bëj hallall, vëlla! — u dëgjua zëri i Besarit, duke ulur grushtin.

Ai nxori biçakun e vogël dhe me majën e tij gdhendi mbi trungun e lisit: F.G.44.

Erdhi çasti të ndaheshim. Shokun duhej ta linim te ky qivur i bardhë nën degët e lisit shekullor me rrënjë të thella dhe të iknim përmes rreziqeve që na prisnin për të shpëtuar jetën e fëmijës. Ky ishte dhe amaneti i Fatmirit. Të masakruarit te shpella, nëna e gjakosur pranë djepit, Fatmiri i rënë te gërxi, shokët që e merrnin në duar dhe s'u ndaheshin lotët, të gjithë na dukej sikur na ndiqnin në udhëtimin tonë me këtë fëmijë. Na flisnin shumë gojë dhe përherë e më shumë na rëndonin në këtë rrugë amanetet. Kjo foshnjë në duart tona bëhej më e shtrenjtë, më e madhërishme. E mbaja në duar dhe më dukej sikur dikush mund të ma rrëmbente. Vëreja fytyrën e vogël dhe, kur e shikoja me sytë e mbyllur, trembesha se mos nuk ishte gjumi, po diçka tjetër, e frikshme, e kobshme, që ia kishte mbyllur qepallat dhe e tundja të zgjohej. Kur qante, megjithëse kjo përbente përherë rrezikun të diktoheshim, gëzohesha, se ajo ishte e qara e jetës.

Kishim mbetur tre. Ishim aq pak, sa edhe mungesa e njërit nuk mund të mos ndihej. I katërti ishte gjallë dhe kjo na bënte që ta mposhtnim dhembjen për shokun e humbur. Po rreziqet nuk na ishin ndarë.

Ne ende s'kishim rënë në kontakt me asnjeri në këto zona gjatë këtyre dy ditëve udhëtimi dhe kjo bënte që çdo hap ta hidhnim me kujdes. Ishim të ndërgegjeshëm se nga mungesa e informacionit mund të gjendeshim në rrethana të vështira e të papritura, si kjo te ky gërxi. Duhej të niseshim sa më shpejt. Në këto vende të panjoh



hura mund të orientoheshim vetëm me ditë. Veç kësaj, duhej të gjenim një strehë për të kaluar natën. Do të kalonim pikërisht atë qafë, ku sot në mëngjes u ndeshëm me pararojën gjermane. Besari shkoi te briri për të vrojtuar vendin, u ul pas një guri dhe po vëzhgonte, pastaj kaloi tej, aq sa siluetën e tij s'e dalloja më. Pas pak doli përsëri te guri dhe ma bëri me dorë të nisesha. U ngrita, u ktheva nga varri i Fatmirit, nderova me grusht dhe ika menjëherë se e dija që s'i mbaja dot lotët. Kishte dhënë jetën një jetim për të shpëtuar jetimin tjetër. Ndofta ky fëmijë do ta mësonte këtë ndonjëherë, mendova me vete, duke gëlltitur lotët me zor.

Kur dola te briri, u hap përpara rrafshnaltë e Shpatit me fshatrat të ngulura gjatë saj. Tani dukej tymi që dilte nga shtëpitë që digjeshin. Në të dyja anët ishin vargmale të mëdha që në verilindje mbylleshin, kurse tutje në horizont vendet vinin duke u zbutur. Shpati ku ishim ne, binte mbi rrafshnaltë, i mbuluar pothuaj gjer poshtë me dëborë. Përgjithësisht ai ishte i veshur me lisa të lartë, por jo të dendur. Rruga këmbësore zbriste në rrafshnaltë. Po ne nuk mund ta ndiqnim atë në asnjë mënyrë, do të prisnim monopateve. Duhej të kishte dhe dy orë ditë e në këto dy orë do të shtyheshim më tej duke iu ruajtur pritave dhe të gjenim një vend sa më të përshtatshëm për të kaluar natën. Shpati që kishim përpara, thyhej herë pas here nga përrenj e kurrize. Besari kishte një nuhatje të habitshme për të gjetur udhët e shtigjet që të nxirrnin më shkurt. Në një vend ai ndaloi. Këtu kanë kaluar gjurmë, tha dhe tregoi një gropëz në dëborë. Gjurmën e ka mbuluar dëborë e re. Ai vazhdoi më tej dhe ato gjurmë të shkëputura po i lidhte me një vilar të gjatë. Te një kreshtë

qëndroi përsëri. Ja, më tha mua, a e sheh? Tani gjurma duket fare mirë se era nuk e ka lënë dëborën që ta mbushë. Në fillim unë s'e kuptoja idenë e Besarit pse po i ndiqnim këto gjurmë. Por ai filloi të më shpjegohej vetë. Diku në këto pyje e buza duhej të ishin njerëzit e këtyre fshatrave. Dhe ajo që kishim përpara, ishte gjurma e një fshatari të këtyre anëve dhe ai, për të vërtetuar këtë, futi këmbën me llastikat që mbante veshur. Kurse gjurma e këpucëve të tua është krejt ndryshe, më tha duke më treguar njërrën prej atyre që kisha lënë unë mbi dëborë. Ne tani po u largoheshim fshatrave duke u ngjitur shpatit, duke hipur e zbritur kurrize, gërxhe. Arritëm te një burim. Aty dukeshin gjurmët e freskëta që duhej të kishin punuar edhe sot. U ulëm aty. Ujë s'na pihej, po qëndruam për t'u çlodhur. Ishim të bindur se ato gjurmë do të na shpinin te njerëzit. Besari vështroi vogëlushin që kishte hapur sytë dhe buzëqeshi nën mustaqe. Pas pak u dëgjuan zhurma hapash që gjithnjë po afroheshin. Një djalë e një grua u trembën, kur dolën menjëherë para nesh, ku të nxirrte rruga te burimi i fshehur rrëzë shkëmbit.

— Partizanë, — foli me zë të butë Besari, — mos kini frikë.

Fëmija dhe gruaja erdhën na takuan. Ajo shkarkoi bucelën, e vuri te burimi të mbushej dhe u ul pranë meje.

— Ti partizane je? — më tha e, duke shikuar me habi fëmijën, më pyeti: — Yti është?

— Imi.

— Çudi! Për herë të parë shoh se paska dhe partizane me fëmijë pas në mal.

— Është histori e gjatë, — i thashë. — Ju këtu jeni fshehur nga gjermanët?

— Po. Poshtë po zhuritet guri dhe druri. Ne jemi strehuar te një shpellë këtu afër.

Besari kishte vënë çibukun në gojë dhe tymoste. Ky ndoshta ishte duhani i fundit, s'duhej të kishte më. Them kështu se mua m'u duk sikur i mbaroi atje pas varrimit të Fatmirit. E pashë kur kruante qesen.

Bucela u mbush dhe gruaja u ngrit. Besari e mori bucelën peshë dhe ia vuri gruas në kurriz për t'ia ngarkuar. Përpëra shkante djali, pas tij Besari dhe para meje gruaja e ngarkuar me bucelë. Fëmija filloi të qante.

— I vjen uri. Që kur i ke dhënë të pijë? — pyeti gruaja.

— Që në drekë.

— A të kanë gjinjtë qumësht?

— Hiç fare.

— Po me se e ushqen?

— Me bollgur.

— Me bollgur? Sa muajsh është?

— Tremuajsh.

— Ushqehet fëmija tremuajsh me bollgur?

— S'e di, po kur s'ke ç'ti japësh tjetër...

— Si? Që në lindje s'ke pasur fare qumësht?

— Unë s'kam lindur.

Gruaja qëndroi, u kthye dhe më shikoi me habi.

— Po ti the që fëmija është yti!

U dëgjuan zëra: Vdekje fashizmit! Liri popullit! dhe tjetra s'arriti të merrte përgjigjen. Pas pak u ndodhëm midis njerëzve.

Shpella nuk u ngjante atyre që më kishte ndodhur të shikoja gjer tani. Ishte një bllok shkëmbi i prerë me një strehë të dalë. Kishin ngritur dhe dy çadra me rroba vendi, që këta u thoshin çatore. Rreth zjarrit, ku ishin mbledhur, në njërën anë qëndronte një plak, në anën tjetër

Besari dhe nën të unë, ndërsa fëmijën e mbante Rusha, që rrinte pranë meje, gruaja me të cilën kishim ardhur nga burimi. Kur mësuan historinë e fëmijës, e kaluan të gjithë dorë më dorë dhe plaka, nënë Dana, i fërkoji ballin. Nga faqet e rreshkura të nënë Danës rrodhën lot.

— Do t'i zërë mallkimi i fëmijëve, — tha plaka. — Kështu na kanë djegur dhe na kanë vrarë të gjithë shkelësit, por u është zhdukur fara. Mojt vajzë, — m'u drejtua mua, — keni ruajtur amanetin e një nëne. Mbi dhë s'ka amanet më të rëndë.

Ne ishim të lodhur e të uritur. Plaku porosi të na binin shpejt për të ngrënë. Vunë të thekej bukë misri dhe na nxorën përpara një tas me shëllirë.

— Me ç'na u ndodh, — tha nënë Dana. — Kushedi që kur jeni pa ngrënë. Po dhe ne kemi lënë shtëpitë dhe kemi ikur me ç'kemi veshur. Beshir, mor djalë, — iu drejtua nënë Dana me një ton që të shkonte të rrëqethur, — paçi bekimin e gjithë nënave për ato që keni bërë për këtë foshnjë!

Fëmija filloi të qante në duart e Rushës. Unë desha ta merrja.

— Lëre ti, vajzë e nënës, me fëmijën sonte do merremi ne. Ju e keni ushqyer me bollgur po ai do qumësht, se është ende kërthi. Sikur të kisha një nuse me gji, këtë fëmijë do ta kisha rritur vetë. Ai qan se do të hajë, Rushë! Kemi ca mollë, do t'i ziejmë t'i japim lëngun, është ushqim më i mirë se bollguri për foshnjën. Ma jep mua fëmijën. Ju filloni e hani, — na u drejtua neve. — Është tretur, i vogli i nënës. T'i bëjmë një banjë në çatore. Kushedi sa ditë ka pa u larë, — tha plaka dhe filloi ta nanuriste djalin, e tundte ngadalë në prehër me disa

lëvizje të lehta dhe fëmija u qetësua. Mua më bëri përshtypje se sa shpejt e pajtoi. Ajo plakë është djep i lashtë, mendova me vete.

Ne hanim me shumë uri. E dinim se e kishin ndarë atë copë bukë nga kafshata e tyre. Në këto kohë të egra të operacionit kështu ndaheshin kafshatat mes njerëzve dhe kjo ishte një shfaqje e zakonshme. Shëllira dhe buka e misrit në këto kohë ishin një sofër e zgjedhur. Por ajo ankesa e tyre kishte një kuptim tjetër. Unë e kisha dëgjuar kudo që më kishte takuar rasti të bujtja. Këta njerëz të thjeshtë nuk i thoshin ato fjalë për t'u shfajësuar. Jo. Kishte në ato fjalë diçka më tepër. Për ta, diçka i mungonte mikpritjes së tyre. Për miqtë duhej të kishin dhe atë që s'e hanin për vete. Por a nuk po bënim të njëjtën gjë!? Ne hëngrëm bukë të thekur misri e shëllirë, hëngrëm atë që u mungonte atyre, atë që s'do ta kishin nesër. Kur mbaruan së ngrëni, plaku i zgjati kutinë e duhanit Besarit. Ai mbushi çibukun. Edhe plaku pinte me çibuk.

— Sillmë duhanin, — foli plaku.

Rusha u ngrit dhe i pruri një torbë me duhan të grirë. Plaku ia zgjati Besarit.

— Merr, të kesh dhe me vete rrugës. Duhan, siç e provove, është i fortë. E bëj vetë. Është duhan nga arë zallishtë. Bëhet i paktë, por i rëndë, — tha plaku.

Besari nxori dhe mbushi qesen e tij prej lëkure.

— Do të ndërrojmë çibuqet, — tha partizani, — t'i kemi kujtim.

— Prishur mos qoftë, megjithëse imi është si çibuk plaku.

— E kam bërë vetë, — tha Besari, — është dru piksi.

Plaku po e shikonte nën dritën e flakës. Bishti ishte i qëndisur.

— Dru shumë i bukur. S'kam parë dru me ngjyrë kaq të kuqe e të lëmuar.

— E ka vetë piksi. Ne e futim pesëmbëdhjetë ditë në gjalpë të shkrirë dhe druri lëmohet e fekset më shumë dhe s'e humbet shkëlqimin kurrë.

— Ky është dru panje, — tha duke shikuar çibukun e tjetrit.

— Panja është dru i lehtë, po s'rron shumë, — tha plaku.

Në zjarr dëgjohej vala e kuisë së bakrit që ziente e mbushur me mollë.

— Ju nuk do të rrini dhe nesër për t'u çlodhur? — pyeti plaku.

— Jo, — tha Besari, — duhet të arrijmë sa më parë në Ndërfushëz. Atje do ta lëmë në një bazë. Koha s'na pret.

— Sikur t'ju vejë rruga mbarë, arrini gjer nesër në darkë. Vështirësia është sa të kaloni zonën tonë, që është nën operacion.

Në këtë kohë erdhi një burrë. Ai u takua më parë me Besarin dhe pastaj me mua.

— Djali ynë i madh, — tha nënë Dana.

Ky duhej të ishte i shoqi i Rushës.

— Ç'lajme të reja na more vesh? — e pyeti plaku.

— Shkova tek ata të Shpellës së Kaprollit dhe më thanë se në Jenish është bërë hataja.

— E kanë djegur? — pyeti plaku, i shqetësuar.

— Fshatin e kanë rrafshuar krejt, me të 300 shtëpitë e tij. Gjithë banorët që kishin gjetur, gra, pleq, fëmijë i kanë pushkatuar.

— Korba! — u dëgjua zëri i nënë Danës

dhe nën dritën e flakës u duk fytyra e saj e tronditur.

— Kanë masakruar mbi 130 shpirt, — foli përsëri ai që sapo kishte ardhur. — Thonë për shkak të një plaku.

— Ç'mund t'u bënte gjermanëve një plak! — foli përsëri nënë Dana me një ton dhembjeje dhe urrejtjeje.

— Kur gjermanët deshën të hynin në shtëpinë e tij, ai ishte ulur te pragu i derës dhe nuk lëvizte nga vendi. E kërcënuan, por ai nuk ua hapi udhën. Gjermani e qëlloi me pëllëmbë dhe atëherë plaku nxori një nagant dhe e vrau në vend. Gjermani, thonë, ishte një oficer i lartë.

U bë një heshtje, dëgjoheshin të kërciturat e druve në zjarr dhe luhatjet e flakëve.

— Korba, për gjakun që derdhet!

— Ai është dëshmor i lirisë. Të rrojë kujtimi i tij, — tha Besari e mblodhi dorën grusht gjysmë të ngritur.

— Gjermanët janë tërbuar dhe po i vënë flakën gjithë krahinës, — foli i ardhuri.

— Nuk janë gjermanët të parët që po na djegin, — tha plaku. — Kështu e mbaj mend unë, kështu më kanë treguar edhe më të parët.

— Është mall e gjë ky që priset, janë bij nënash të rritur me mund këta që ikin, është gjak dhe s'është ujë ky që derdhet, — dëgjohej si një kujë zëri i nënë Danës.

Ajo ishte kthyer e tëra në dhembje dhe urrejtje. Klithte zemra e një nëne. Kudo zjarr, kudo masakra. Ky ishte një dimër i përflakur e i gjakosur. Dhembja dhe qëndresa ishin kudo, siç ishin kudo dhe zjarri e thika e xhelatit.

— Do të vijë dhe dita jonë, — tha Besari. — Për të gjitha do të marrim hak.

— Me se mund të lahet ky gjak i pafajshëm, mor bir?! Po të na rroni ju, — tha nëna duke e mundur pikëllimin.

— Në Shqipërinë e lirë dhe mall e gjë do të kemi më shumë, dhe jetën do ta gëzojmë ne fukaraja që derdhim sot gjakun lumë.

— Gjakun gjithnjë ne fukaraja e kemi derdhur, — foli plaku pas një heshtjeje të gjatë.

— Ne e kemi derdhur vërtet, — tha Besari, — e ka pirë toka e përsëri kemi lindur prej tij ne fukaraja, me po ato halle, me po ato eshtra dhe mish. Këtë herë nga gjaku ynë do të çelë dhe lulja.

— Amin! — uroi nënë Dana. — Ju jeni djemtë e hairit të kësaj toke!

Nata kishte rënë e errët dhe e ftohtë. Flakët e zjarrit lëpinin muret e shpellës dhe në atë natë aq të errët dukeshin shumë të kuqe.

— Ju duhet të flini, — tha plaku. — Jeni shumë të lodhur e nesër përsëri ju pret rruga.

Mua më mori Rusha dhe shkuam në një nga ato çadrat.

Kishin ndezur një zjarr të vogël në mes të saj dhe mbi gur kishin vendosur një kandil.

Pas pak erdhi dhe nënë Dana me gjithë djalin.

— Do ta lajmë, — tha, — pastaj do t'i japim të hajë.

Ajo e futi në një kazan të madh bakri, na porositi të merrnim prush nga zjarri i shpellës. Zjarrit të vogël, që kishim në çadër, s'mund t'i vinim më dru, se bënte tym. Në kazan nënë Dana e fërkonte foshnjën nga të gjitha anët, ndërsa Rusha mbante kandilin në dorë pranë saj. Fëmija qau veç në fillim, pastaj trupi i gjeti prehje në ujin e ngrohtë dhe midis duarve të nënë Danës, që e fërkonin vazhdimisht. Ajo e nxori duke e



mbajtur në duar dhe ai ngjante si një top brumi i verdhë.

— Është tretur, — tha plaka, — shpirti i nënës. Shpejt çarçafin se mos më ftohet. — Pastaj e lidhën në pelenat e tij, që unë s'i kisha vënë re kur i kishin larë e tharë aq shpejt. Në fund e lidhi me povezgën e bukur larushe.

— E zeza nënë! Ia ka bërë të gjitha, — dhe plakës i shkuan pika loti. — Më sillni lëngun dhe një lugë të vogël kafeje.

Rusha erdhi me to në dorë. Vuri fëmijën në prehër me kokën lart, të mbështetur te krahu i saj, mbushi një lugë, e provoi vetë mos ishte i nxehtë dhe tha:

— E mjera unë, të kisha dhe pak sheqer.

Fëmija e pinte lëngun me dëshirë dhe unë e Rusha e ndiqnim me ndjenjë të thellë ngazëllimi.

— Tani do të flejë, — tha plaka, — do të çoheni dhe një herë t'i jepni natën.

Ajo e vuri fëmijën në krye të një rrobe të leshtë që ishte shtruar në njërën anë të çadrës.

— Tani flini dhe ju, po kujdes mos më shtypni fëmijën, — tha dhe qeshi duke dalë.

Në çadër kishim dhe djalin dyvjeçar të Rushës. Ai shkoi dhe qëndroi te fëmija i vogël dhe filloi ta shikonte me atë kureshtje që sheh fëmija fëmijën. U ulëm dhe ne pranë njëra-tjetrës. Në çadër gjithçka kishte marrë prarimin e verdhë të flakës së kandilit. Vetëm skutat e saj nxinin. Ajo flakë s'kishte fuqi të arrinte gjer atje.

— Ke shumë që ke dalë partizane? — tha Rusha.

— Një vit.

— Nga jeta e qytetit menjëherë në të keq, vështirë do ta kesh pasur.

— Lodhesha shpejt, s'duroja dot të ftohtët, s'haja dot çdo gjë. Dhe më flihej shumë.

Ajo kishte marrë kapelën time në dorë dhe shikonte yllin.

— Vetë e ke qëndisur?

— Jo, unë s'di të qëndis, një grua në një fshat erdhi dhe na solli yje të qëndisura.

— Sikur të kishe qëndruar dhe nesër, unë do të të kisha qëndisur një yll ta kishe kujtim prej meje.

— Unë dhe kështu s'do të të harroj kurrë. Ia mora kapelën nga dora dhe ia vendosa mbi kokë.

— Sa të shkon! — i thashë.

— Po në luftë është vështirë?

— Si të të them. Në fillim krismat e gjëmimet të hutojnë, pastaj mësohesh me to e s'të bëjnë asnjë përshtypje.

Fëmija lëvizi, tundi kokën dhe filloi të ksinjej.

— Mos e nga, — tha Rusha, — qanë në gjumë. Mbase shikon atë llahtarin në shpellë, krismat që ka dëgjuar rrugës. Si ke bërë kur të qante?

— I jepja gjirin tim.

— Në fillim ndien atë gudulisjen, po pastaj mësohesh. Ti u bërë nënë para kohe. Njëlloj është. S'i dhe qumështin, i dhe gjakun, se, thonë, kur gjinjtë s'kanë qumësht, fëmija thith gjak.

Heshtëm një copë herë, pastaj ajo pyeti:

— Të vesh në çetë, të pranojnë menjëherë?

— Të pranojnë.

— Të lodha me pyetje. Ti je e lodhur e nesër prapë do nisesh për rrugë.

Rusha u ngrit, mbuloi me hi prushin që skuqte në mes të çadrës, pastaj i vuri një saç sipër.

— Do të flemë, — tha.

Priti sa u shtriva unë, më hodhi dy velenxa leshi, pastaj vuri të birin në qoshen tjetër dhe fiku kandilin. Atëherë dëgjova zhurmën e rrobës që hodhi përsipër në errësirën që kishte sjellë heshtjen. Mua me siguri do të më ketë zënë gjumi të parën.

### *Lugina e mjegullës*

Na përcillte një qiell i mbushur me re. Ecnim shpatit të malit gjithmonë duke zbritur poshtë. Udhërrëfyes kishim burrin e Rushës, Lekën. Si vendas që ishte, ecte përpara për të na kaluar shtigjeve dhe rrugëve më të sigurta. Shkelnim mbi dëborën e ngrirë dhe dëgjonim kërcitjen e hapave. Herë pas here grykat e maleve i përcillnin gjer te ne jehonën e krismave dhe gjësimet e luftës. E lamë kufirin e dëborës dhe po zbritnim gjithmonë e më afër rrafshnaltës, ku ngriheshin qendrat e banuara. Leka qëndronte herë pas here. Dilte në ndonjë pikë të ngritur për të hetuar vendin dhe për të zgjedhur drejtimin më të përshtatshëm, për të mënjanuar çdo takim të papritur me gjermanët e ballistët. Ne gjithnjë e më shumë po i linim qendrat e banuara pas krahëve. Rrafshnaltës i shkuam për bri, pothuaj gjatë këmbëve të thepisura të malit. Leka tregonte se dëborë i pengonte gjermanët të ngjitnin malin. Ata ruanin shtigjet, monopatet, rrugët këmbësore që lidhnin qendrat e banuara me malin dhe zonat e tjera. Ata e dinin se partizanët manovronin duke kaluar nga një zonë në

tjetrën, herë duke u zhdukur në një drejtim e herë në një tjetër. Vetëm po të diktonin ndonjë repart partizan, gjermanët fillonin operacionin kundër tyre... Kurse ne tani po zbritnim në vende të buta, pranë qendrave të banuara. Kjo e bënte kalimin tonë më të vështirë. Njërit prej fshatrave të zonës, që s'ia mbaj mend emrin që na tha Leka, i kaluam fare pranë. Shtëpitë e tij i ngjiteshin një kodre në këmbë të malit. Që larg pamë gjermanët që lëviznin nëpër fshat, midis shtëpive që tymosnin nga çatitë e djegura. Leka na shkoi mbi shtegun që ruanin gjermanët. Qe një vend i thyer me pyll. Ngaqë kishte rrezik se mund të ndesheshim befas ballë për ballë me patrullat gjermane, Leka na la ne në një vend të fshehur dhe shkoi vetëm. U kthye pas dhjetë minutash e na tha se do t'u shkonim fare pranë gjermanëve, pasi mali në veriperëndim thyhej duke rënë thikë mbi luginë. Duhet që fëmija të mos qante, ndryshe gjithçka do të merrte fund. Besari po e dëgjonte i menduar. Do të shkojmë dhe një herë të dy bashkë, i tha ai. Kur u kthyen, puna e parë që bëme, ushqyem fëmijën me lëng molle. Pastaj pritëm sa atë e zuri gjumi. Tani ai kishte ditë që udhëtonte dhe ishte mësuar të flinte në krahët tonë, duke ecur. Kur u afruam pranë rojave, Besari tha: «Duhet të mendojmë çdo të papritur. Në qoftë se diktohem, ti me Lekën do të ikni me fëmijën». U futëm një përroi të vogël dhe ecëm nëpër ujën e ftohtë të tij. Do të mjaftonte vetëm e qara e fëmijës, ose një hap i gabuar, të rrokulliste qoftë dhe një gur dhe roja gjermane do të vihej në alarm. Unë e mbaja para duarve fëmijën dhe shikoja përherë nga ai, mos i hapëshin sytë, a lëvizte buzët e t'ia platitja kokën te gjiri. Ecëm këshu më shumë se dhjetë minuta, pastaj fillonin

disa kodrina njëra pas tjetrës, plotë bokërima e shkurre. Tani e ndiejmë veten të lehtësuar. Filluan pikat e para të shiut, ndërsa thellë maleve, që po i linim gjithnjë pas, po binte dëborë. Kodrat vinin duke u ulur, gjersa shuheshin krejt e para nesh shtrihej zona e Dranges. Poshtë ishte fusha e përshkuar mes për mes nga xhadeja. Këtu fillonin zonat fushore e kodrinore. Më saktë, ajo ishte një luginë midis dy vargjesh kodrash që herë uleshin e herë ngriheshin. Rrëzë tyre qenë fshatrat. Leka po na tregonte se ç'drejtim do të mbanim. Duke iu larguar xhadesë, do të ecnim gjatë luginës në krahun e djathtë të saj dhe do të përpiqeshim të mos takonim me njerëzit. Në mbrëmje do të arrinim në fshatin ku kishim marrë detyrën për të çuar fëmijën. Kur Leka u nda nga ne, puthi fëmijën. Tani ai qe bërë bashudhëtari ynë. Leka mua më kujtonte gjithnjë Rushën dhe natën që kaluam të dyja në çadrën pranë shpellës. M'u kujtuan ato pyetjet e saj për luftën dhe për partizanët. Nxora nga xhepi një ballë fishekë dhe ia dhashë Lekës. Për Rushën, i thashë. Ai më shikoi i përqendruar dhe s'foli. I futi fishekët në xhep dhe unë ndjeva shtrëngimin e dorës së tij. Ne zbritëm në luginë nën një shi të imët. Filloi të bjerë mjegull. Ajo na e bënte dhe më të vështirë orientimin. Shikoje vetëm tre-katër metra larg. U detyruam të ecnim pas një rruge këmbësorësh. E dinim që kjo të shpinte në drejtimin nga duhej të shkoni, po mund të na nxirrte kudo, te një stan, te një shtëpi, te një fshat apo dhe te njerëz që do t'i merrnim vesh kush qenë vetëm kur t'i kishim përballë. Fëmijën e mbanim me radhë. Kush kishte fëmijën, qëndronte përherë pas. U dëgjua një e lehur qeni. Mbajtëm këmbët. Të lehurat e qenit vazhdonin. Filluam të ecnim me kujdes.

Shiu i imët mezi dukej mes mjegullës. E lehura e qenit sa vinte e afrohej. Në të vërtetë shkonim ne drejt saj e prapë na dukej sikur ai qen, me të lehurat kafshuese, po na afrohej tinës, mes mjegullës. Ndalua përsëri. Jemi pranë një stani, tha Besari. Ai diku është para nesh. Po të mos ishte mjegulla, me siguri do të dukej. Sot është nëntë janar, tha përsëri Besari. Dhenë kanë pjellë dhe atje mund të gjejmë qumësht e kullosh tër.

Qeni vazhdonte të lehurat. Unë, duke qëndruar ashtu në këmbë, përfytyroja atë qen që pas çdo hapjeje dhe mbylljeje të gojës me të lehurën fuste dhe nxirrte dhe mjegull, e copëtonte nëpër dhëmbë. Kurse me siguri Besari mendonte krejt ndryshe. Ajo e lehur e lidhte atë me stanin, me barinjtë, me delet, me qengjat e me qumështin. Në të vërtetë ne i kishim përpara të dyja, qenin që kafshonte mjegullën dhe delet me qumështin e qengjat e bardhë. Vendosëm që të mos e vazhdonim udhën drejt stanit. Kjo mund të na conte në rreziqe të paniohura. Stani ishte tek e lehura dhe ne i largoheshim asai. Lamë rrugën dhe u kthyem në të djathtë. U desh të kalonim nëpër ara të mbjella me grurë, të kapërcenim hendekë e gjerdhe të shumta që i ndanin. Të lehurën e lamë në të majtë, pastaj pas giersa s'e dëguam më. Fëmija filloi të qante. Kishim disa orë që udhëtonim. Duhej të ishte drekë. Qëndruam rrëzë një gardhi dhe i dhëmë fëmijës lëng molle, me të cilin kishim mbushur pagurin. Ashtu në këmbë, hëngrëm dhe për vete bukë të misërt që na kishin dhënë në familjen e Lekës. Ishte një i ftohtë i lagësht që të hynte në palcë. Shiu i butë, që binte, na kishte lagur. Sado që e kishim mbrojtur, velenxa që mbësh-tillnim fëmijën pothuaj që njomur. Shiu për ne

qe armik aq i rrezikshëm, sa dhe gjermanët dhe ballistët. Në këtë vend të hapur, të mbuluar nga mjegulla, ku s'shikonim më larg se rreth vetes, po të na lagej fëmija, do të na mbaronte nga të ftohtët. Qielli ishte shumë i rënduar dhe nuk pritej asnjë përmirësim moti. Gjëmime të thella e të zgjatura zvarriteshin plot rënkime. Gjëmë dëbore, tha Besari. Për ne ishte më mirë të binte dëborë, sesa shi. Moti ishte një armik që s'kishim si t'i mbroheshim. Po tani ecnim në një zonë të ulët, ku barinj të kishin stanet dimërore. E kishim vështirë të ecnim kështu në mes të arave. Kudo do të hasje një gardh, një hendek. E dinim se në krahun tonë të majtë ishte xhadeja, në krahun e djathtë vargu i kodrave dhe fshatrat. Kështu përmes arave kishte më pak mundësi të hasnim njerëz. Vërtet ishim në një terren krejt të hapur, po gjer tani na mbronte mjegulla. Por ajo sa vinte e rrallohej. Era e lehtë, që filloi të frynte, tregonte se mund ta spastronte krejt luginën. Ne duhej të përfitonim nga kjo mjegull për ta kaluar luginën sa më shpejt. Po kështu, mes këtyre ngastrave të copëtuara, ecnim ngadalë. Shpesh duhej të ktheheshim dhe mbrapsht për të gjetur një shteg. Menduam njëherë të gjenim xhadenë dhe të ecnim gjatë saj duke përfituar nga mjegulla. Por u dëgjua zhurmë makinash dhe motoçikletash. Lugina e vogël po gjëmon prej tyre. Dritat e makinave shpojnë mjegullën. Ne i shohim fashat e dritës që herë zgjaten e herë shkurtohen dhe përmes tyre duken miliona kokrriza të vogla uji sa maja e gjilpërës që lëvrijnë si qeliza të gjalla. Atëherë vendosëm të prisnim djathtas, në drejtim të kodrave, ku patjetër do të gjenim rrugën këmbësore që kishim lënë. Ecim nëpër ca çaire. Bari sivjet është i bollshëm, më thotë Besari, bagëtia

do të jenë të mbara. Çudi. Unë kurrë ndonjëherë s'mendoj kështu për barin. Më pëlqen vetëm gjelbërimi i tij, kur gjithçka përreth është zhveshur e tulatur nën egërsinë e dimrit. E ky gjelbërim sikur të hyn në shpirt dhe ndien se jeta është e pranishme me gjithë gjallërinë e saj. E gjetëm rrugën. Besari shikon me kujdes disa gjurmë njerëzish e kafshësh. Janë të freskëta, më thotë, tani duhet të kenë kaluar. Kjo do të thotë se rruga punohet e ne duhet të jemi sa më të vëmendshëm. Nëpër verbërinë e mjegullës dëgjojmë tingullin e një zileje. E lëmë rrugën. Pas pak dy njerëz dhe tri mushka duken fare afër. Besari u del përpara.

— Vdekje fashizmit!

Të dy burrat mbetën të shastisur para kësaj së papriture. Nuk u përgjigj asnjëri.

— Ne jemi qiraxhinj, — tha me zë të frikësuar më i shkurtri.

— Po jeni shqiptarë, — u dëgjua zëri i Besarit.

— Ne s'jemi as me Ballin, as me partizanët.

— Po me kë jeni ju, me gjermanët?

— Jo, zoti partizan, ne shohim punën tonë.

— Unë nuk jam zotëri. Ti atë fjalë mbaje për vete! S'paska marrë vesh ti se për të përmbysur zotërinjtë është ngritur fukaraja në luftë?!

— Desha të them zoti...

— Mor lëre ti zotnillëkun. Ku paska qenë ky borgjez që të paska ngjitur atë fjalë për gjuhe?

Unë dëgjoja këtë dialog që zhvillohej në rrugë dhe më vinte për të qeshur. T'i thoshe zotëri Besarit? Dukej që ai e mbante me vështirësi veten, se për këtë fjalë ishte gati të të kthente grykën e pushkës.

— Dua t'ju bëj një pyetje.



— Lepe, zot...

Qiraxhiu këtë herë e përtypi fjalën zotëri nëpër dhëmbë.

— Sa larg mban që këtej Bregasi?

— Bregasi? Jo më shumë se tri orë.

Tjetri nxori një sahat xhepi dhe e pa.

— Ka akoma dhe tri orë e gjysmë ditë. Këtë zonë, sikur ta kalonit nëpër mjegull, do të qe më mirë.

— A ka lëvizje nga këto anë?

— Kudo po kalon operacioni. Urat ruhen, rrugët patrollohen. Në këtë zonë veprojnë sidomos forcat e Ballit.

— Ju, çudi si keni dalë këtu! — tha me një zë që shprehte frikë dhe habi ai më i shkurtri.

— Pse çuditesh ti! Mos dëgjo parullat e kolonës së pestë që thonë se u shuan partizanët? Partizanët janë dhe atje ku s'ia pret mendja armikut. Dhe tani kam një porosi: Me këdo që të takoheni rrugës, do ta qepni gojën. Vdekje fashizmit, — dhe Besari e -u liroi rrugën.

U dëgjuan përsëri tringëllima e ziles së mushkës dhe troku i potkonjve, që nëpër mjegull ngjanin disi misterioze, si në baladat që na bënte në gjimnaz profesori i letërsisë. Fëmija po fle. I është lagur vetëm velenxa.

Unë nxora shaminë që më kishte dhuruar Rusha. Ishte një copë trandafili, e prerë në formë trekëndëshi, e thurur anash, e qëndisur me ca motive të thjeshta, por shumë të bukura. E kishte nga të pajës së nusërisë. Tani me të mbulova fytyrën e fëmijës, që të mos mërddhinte dhe ta mbronte nga lagështia.

— Duhet të ecim shpejt, — tha Besari. — Kam frikë se mos shtrëngon shiu. Na duhet të udhëtojmë të paktën tri orë.

Fëmijën e mori ai dhe unë hiqja rrugën për-

para. Ende udhëtonim nëpër mjegull. Vende-ve-nde rruga kishte baltë, një baltë që të ngjitej për këmbë. Mjegulla sa vinte po rrallohej e para nesh shfaqeshin peizazhe që deri tani të ngjante se ishin fshehur pas një perdeje vigane. Nën qiellin e murrëtyer sendet ruanin zyrtësinë e ditës së dimrit dhe të dukeshin sikur ishin të lagështa e të squllura. Në relievin e shkallëzuar të kodrave, papritur, në një mënyrë krejt të panatyrshme, në fund të tyre, ngrihej një lartësi si për të përqeshur atë varg kodrash që ngjanin sikur dikush i kishte shtypur nga lart për të frenuar zgjatjen e tyre drejt qiellit. Ai është një mal, të paktën këtu, në këtë peizazh që na rrethon. Ai s'mund të quhet ndryshe. Më pëlqen të besoj se tej tij duhet të jetë Bregasi. Ne s'ia dimë emrin, si s'ia dimë dhe asnjë kodre dhe fshati përreth. Unë them «tej atij mali» dhe Besari «tej asaj kodre», po kjo nuk na prish shumë punë. Veç mua më vjen për të qeshur se asnjëri nuk heq dorë nga emërtimi i vet dhe as i kërkojnë shpjegim njëri-tjetrit pse unë e quaj mal dhe ai kodër.

Rruga herë na afron dhe herë na largon nga fshatrat që shtrihen djathtas. Ato diku u qepen kodrave e diku struken rrëzë tyre. Vetëm shtëpitë zbardhin në këtë ditë të hirtë. Ato janë e vetmja bardhësi në këtë zyrtësi monotone.

— Ky vend është lakuriq, — thotë Besari, — por i butë për dimërimin e bagëtisë e duhet të rritë grurin e misrin. Mua më kujton fshatrat rreth qytetit tonë. Ato ngrihen po mbi kodra, po kodrat atje janë të buta e të veshura nga ulliri dhe fiku, ndërsa fusha e gjerë. S'gjen si këtu toka të kuqe e zallishtë.

Ne ecim, ndërrojmë me njëri-tjetrin fëmijën dhe shikojmë përherë mos e lagura i shkon në

pelena. Mbi malin përtej, që ne po i afrohemi gjithmonë, u dyndën retë e maja e tij s'duket më. Era ka pushuar e bie ajo qetësi e pabesë kur nga çasti në çast pritet të çahet qielli. Shkrep një vetëtimë shurdhuese që bie diku në luginë. Fëmija zgjohet e qan. Unë provoj t'i jap ushqim, por ai s'do. Fillojnë përsëri pikat e shiut, në fillim të rralla, po të mëdha. Më në fund ai duket tej nesh si nxin e vjen me rrebesh. Shikojmë vendin përreth, por asgjekundi nuk mund të fshihemi. Vetëm shpejtojmë, shpejtojmë se përpara kushedi ku mund të na shfaqet ndonjë strehë. Fëmijën e ka marrë Besari. Unë mezi i ndjek hapat e tij të mëdhenj, që i hedh pak shtrembër. Për herë të parë gjatë udhëtimit tonë, ai, megjithëse ka fëmijën, ecën me të përpara. Më në fund na zë rrebeshi. Dëgjojmë si vjen drejt nesh duke kërcitur mbi tokë. Ecim pa folur, po shiu është shumë i madh. Në të djathtë duket një pemë. Shkojmë e strukemi te trungu i saj. Po ky lis i zhveshur, përveç trungut për t'u mbështetur, s'ka ç'na jep tjetër. Besari ka hequr pallton e tij prej shajaku dhe ka mbuluar me të fëmijën. Ai ka përkulur mbi të trupin e tij të madh. Po gjithçka kullon: degët e lisit, palltoja prej shajaku, trupat tanë. Fëmija qan, pastaj hesht. Unë e zbuloj. Shamia i është ngjitur në fytyrë, buzët i janë nxirë.

— Besar, — them e llahtarisur, — ky po na vdes nga të ftohtët!

Ai sheh fëmijën dhe s'flet. E tund, po fëmija s'përmendet. Besar i hap gojën dhe i fryn me frymën e tij. Rrebeshi vjen valë-valë. Sa kalon rrahu i parë, vjen një tjetër pas tij. Ne nuk duam të besojmë se te ky lis duhet t'ia dorëzojmë këtë fëmijë vdekjes. Kemi menduar çdo lloj rreziku, e kemi peshuar çdo gjë me jetën, kurse

këtij shiu s'mund t'i përballojmë dot me asgjë. Besari vazhdon t'i japë frymë fëmijës, por ai sa vjen e nxihet. Shkrepëtijnë rrufetë me një kërcëllimë shurdhuese. Flakët çajnë qiellin e murrëtyer dhe peizazhi përreth sakaq ndriçohet i tëri. Në të djathtë duken e zhduken me shpejtësinë e flakës së vetëtimës shtëpitë e një fshati.

— Të ikim, — thotë, dhe më tregon fshatin që shfaqet përmes vetëtimave.

Nisemi me vrap. Atje mund që na pret një rrezik tjetër, po s'mund të jetë më i madh se ky që na vjen prej shiut. Nuk duhet të na ndodhë kurrë që fëmija të na vdesë dhe ne të mbelemi gjallë. Ne e dimë ç'duhet të bëjmë, kur vjen çasti i fundit. Ai s'mund të vdesë, gjersa marrim frymë ne. Këto s'ia themi njëri-tjetrit. Gjërat që dihen, s'ka nevojë të thuhën kurrë.

Ne iu drejtua shtëpisë së parë. Ajo ishte në hyrje të fshatit, rrezë kodrës. Mes atij rrebeshi, që vazhdonte të binte rrugës, s'takuam asnjëri. Ishte një duman që të zinte frymën. Hymë nën çardakun e shtëpisë njëkatëshe dhe trokitëm. Na e hapi derën një fëmijë dhe ne u futëm duke kulluar ujë. Fëmija mbeti i shtangur dhe pas pak te pragu i dhomës së zjarrit u duk një burrë.

— Vdekje fashizmit! — përshëndeti me grusht Besari.

Burri s'iu përgjigj dhe qëndroi te pragu i derës pa hapur rrugën. Ndofta ai u habit më shumë se fëmija. Na shikoi dhe një herë për t'u siguruar, nëse ishte e vërtetë ajo që kishte para syve. Kapelat me yllin e kuq, ku ai përqendroi vështrimin, dukej se i hoqën çdo dyshim, po fytyra e tij vazhdonte të shprehte habinë nga kjo e papritur.

— Ju ndjekin gjermanët dhe forcat balliste, ë, — tha me një ton ironik e përbuzës. — A e dini se ku keni trokitur?

— Hap rrugën, — tha prerë Besari, — pastaj merremi vesh.

— Ju s'mund të hyni në shtëpinë time me zor.

— Shqiptari të thotë më parë urdhëro, pastaj të pyet kush je, — tha Besari dhe e shtyu.

Erdhën e shoqja, fëmijët, veç një plakë rrinte pa luajtur nga vendi. Hyri Besari dhe pas tij unë. Në oxhak ishte ndezur zjarri. Një kusi e varur ziente duke nxjerrë avull.

— Kemi ardhur për këtë foshnjë që po vdes nga të ftohtët, — tha Besari duke kthyer kokën nga unë e fëmija.

— Kush jua ka fajin, në qoftë se ju pillni maleve kulishër, zoti partizan?! — tha plot helm i zoti i shtëpisë.

— Hiqe atë fjalë mbrapsht, pusht! — klithi Besari dhe nxori revolverin e ia drejtoi burrit.

Ai ngriu në këmbë me fytyrën krejt të zverdhur. U dëgjuan ulërime e gruas dhe të qarat e fëmijëve. Plaka përpiquej të ngrihej nga qoshja. Nga koka e zbardhur shamia i ra mënjanë.

— Partizanët nuk kanë dalë maleve për kurvëri, po për lirinë e Shqipërisë, — tha me ton të rreptë Besari. — Ky fëmijë është një jetim që ia vranë gjithë të afërmit gjermanët. Po na vdes nga të ftohtët dhe duhet t'i shpëtojmë jetën.

— Ju kërkojmë vetëm zjarrin, — iu drejtova unë, kur pashë që Besari e futi revolen në brez.

— Ti më kërkon zjarrin që djeg shtëpinë, time, tha burri.

— Po të duhet, le të digjet dhe shtëpia jote si e gjithë shqiptarëve, shpejt, — më foli mua

Besari, — ndërro fëmijën! Mos e ngroh menjëherë, po pak nga pak.

Unë e ula pranë vatrës dhe fillova ta zgjidhja. I kërkova gruas një linjë çfarëdo. Ajo më pruri një çarçaf me duart që i dridheshin.

— Ngrohe pak në zjarr, — i thashë. — Ti je nënë dhe e di më mirë se ç'është fëmija.

E zgjidha. Fëmija ishte lagur gjer në mish dhe s'jepte asnjë shenjë jete.

— A ke lesh të palarë? — i tha Besari gruas. — Leshi do të mbetet prapë juaji, vetëm sa për ta ngrohur që ta sjellim në jetë.

Tani toni i Besarit që i zbutur dhe i dhembshur. Gruaja qëndronte pa folur. Ajo shikoi të shoqin dhe priste.

— Sille! Është fjala për një fëmijë jetim, — përsërita unë.

Gruaja solli një bashkë lesh deleje. Kishte një ngjyrë pak të zverdhur, ndërsa nga brenda që i butë e i lëmuar. E ngrohëm pak në zjarr dhe pastaj e futëm fëmijën brenda në bashkën e leshit. I dukej vetëm fytyra. Ai ende s'jepte jetë. Dhoma e zjarrit ishte me dysHEME dërrase, po pa tavan. Lart nxinin trarët. Më kishte takuar të shihja shumë shtëpi të tilla gjatë jetës partizane. Të gjithë rrinim në këmbë, me përjashtim të plakës, që ishte ulur te qoshja. Besari qëndronte te dera me maliherin në sup e me trupin që ende kullonte. Rreth llastikave të tij vendi ishte lagur. I zoti i shtëpisë qëndronte po në këmbë, ndërsa fëmijët ishin mbledhur rreth nënës dhe na shikonin me frikë e habi.

Të parit Besarit, pastaj mua na shkoi syri te një qylaf i bardhë me një shkabë që ishte varur në një gozhdë. Shikuam njëri-tjetrin. Rrethanat na kishin detyruar të hynim te një ballist. Shtrëngova automatikun që kisha hedhur në sup

dhe tani e kuptova më mirë se pritja armiqësore nuk kishte të bënte vetëm me frikën se mos na diktonin gjermanët, po me një ballist që na urrente.

— Më duket e varfër shtëpia jote dhe s'e kuptoj se ç'të ka lidhur ty me larot e Ballit, — i tha Besari të zotit të shtëpisë duke i treguar me gisht qylafin me shkabë.

— Të lidhesh me morracakët nuk është ndo një nder më i madh.

— Ne mund të kemi morra, por s'kemi mbi trup njollën e tradhtisë, — tha Besari dhe te cepi i mustaqeve të zeza unë i vura re si i lëvizi muskuli i buzës.

Jashtë strehët kullonin dhe shiu vazhdonte të binte me furi. Dhoma që kredhur në gjysmerrë-sirë dhe flakët e zjarrit tek oxhaku përhapnin përreth një dritë të zbehtë. U dëgjuan zile e këmborë bagëtish që po ktheheshin në fshat. Kjo tregonte se kishte ardhur mbrëmja. I zoti i shtëpisë u mat të dilte, po Besari i nguli vështrimin dhe ia bëri me shenjë të mos lëvizte.

— Do të mbyllim bagëtinë.

— Ka të tjerë për këtë punë.

— Nuk komandon ti në shtëpinë time.

— Këtu do të bëhet siç them unë. Në këtë shtëpi që këtë çast vepron ligji partizan i luftës. E para: Në qoftë se për shkakun tuaj cenohet jeta e njërit nga tre partizanët që ndodhen këtu (Besari e quante partizan Luftëtarin e vogël), ju ekzekutoheni, shtëpia të digjet dhe malli të sekuestrohet. Këtë vendim do ta zbatojë çdo çetë partizane. Besoj se e kupton që këtej s'mund të dalë njeri i gjallë, në qoftë se ti lëviz bishtin. E dyta: Pa lejen tonë s'do dalë asnjëri nga shtëpia. E treta: Çdo të jashtëmi që mund të vijë dhe dikton rastësisht se këtu ka njerëz, do t'i thoni se jemi mysafirët tuaj.

— Unë s'i njoh ligjet partizane, — tha i zoti i shtëpisë, — prandaj dhe s'jam i detyruar t'i zbatoj, aq më tepër kur jam në shtëpinë time.

— Partizanët veprojnë në emër të popullit. Në qoftë se ti kundërshton, urdhëroj arrestimin tënd që këtë çast. Teuta!

— Urdhëro, shoku komandant! — dhe unë vura gati dorën mbi automatik.

— Si mund të veprohet kështu në shtëpinë e tjetrit, — filloi të fliste i trembur ballisti.

— Me ty s'mund të veprohet ndryshe. Ju them dhe një herë: nuk do të cenojmë asgjë në këtë shtëpi. Do të rrimë sa ta shikojmë të nevojshme. Mund të shkojë të mbyllë bagëtinë djali ose gruaja, — thëa Besari, kur e pa se e kishte zotëruar gjendjen plotësisht. — Besoj se për ato që thashë u morëm vesh.

Plaka, që as shikonte dhe as dëgjonte mirë, kishte vënë re më në fund se prania jonë kishte shkaktuar shqetësim në shtëpi.

— Njeriu me njeriun janë vëllezër, thotë përrëndia, — përsëriste plaka. — Ç'ka ai fëmijë? Është i nuses? Hidhini dru zjarrit. Ky kiameti i sotëm është mallkimi i qiellit, se njerëzit bëjnë të këqija. Falua, o zot, mëkatet! — dhe plaka ngrinte dy duart lart në mënyrë lutëse.

— Komunistët janë pa fe, nuk besojnë tek asnjë zot, — tha i zoti i shtëpisë, që tani ishte ulur dhe ai, — prandaj lutja jote s'i ndihmon.

Po plaka me siguri nuk e dëgjoi. Ajo diçka po nomatiste duke puthitur dy pëllëmbët e duarve që i lëvizte herë anash, herë lart e herë gati përpara fytyrës, sigurisht në bazë të një riti fetar që unë s'e kisha parë kurrë.

— Ç'fituam nga besimi, — foli Besari, se në të vërtetë ato fjalë ishin për ne. — Besuam te zoti dhe të varfër mbetëm. S'i ramë më qafë



njeriu e prapë Shqipërinë armiqtë s'e kursyen asnjëherë.

I zoti i shtëpisë s'liste. Kishte nxjerrë kutinë e dridhte një cigare. Kishte një fytyrë të imët, flokë të rënë dhe duar të shkurtra me gishtërinj gati të rrumbullakosur, të trashë në fund. Mundohej ta fshihte nervozizmin dhe poshtërimin. Kur po lagte me majën e gjuhës fletën e cigares, unë vura re se si i dridhej. Mbylli kutinë, që bëri një krismë karakteristike, dhe filloi të thithte një cigare të trashë që e ndezi me një urë zjarri. Erdhi e shoqja nga jashtë me një krah dru. Mbi oxhak ndezi kandilin. Edhe Besari mbushi çibukun, hodhi një thëngjill në mes të duhanit dhe filloi ta thithte duke mbledhur bulçitë, që i formonin dy gropa në të dyja anët, gjersa nxori tymin nga hunda dhe goja. Gruaja i vuri dru zjarrit dhe me një mashë hapi prushin.

Besari, që gjer tani kishte qëndruar te dera në këmbë, e mbylli atë me një shul, mori një fron, u afrua pas fëmijëve, që rrinin rreth vatrës dhe u ul. E hoqi maliherin nga supet dhe e vuri në mes të dy këmbëve. Filloi të dallohej frymëmarrja e fëmijës që nganjëherë hapte sytë.

— Tani afroje më pranë zjarrit, — tha Besari.

Sytë e të gjithëve ishin drejtuar nga fëmija. I dukej vetëm fytyra e vogël mes leshit.

— Ku do ta shpini këtë fëmijë? — më tha gruaja e shtëpisë.

— Te një nënë, — thashë unë.

— Jepi gji, — më drejtohej plaka që nga qoshja. — Mos do të pijë.

I zoti i shtëpisë shikoi plakën me inat. Vetëm e shoqja buzëqeshi. Kjo që buzëqeshja e

parë në këtë shtëpi; por ajo u shua menjëherë, kur burri, i ngrysur, urdhëroi t'u jepnin darkë fëmijëve.

Gruaja shtroi një sofër nën vatër, vuri shëllirë, një tas qumësht dhe bukë misri. Plakës i dha një tas të vogël me përshesh. I zoti i shtëpisë nuk hëngri. Gruaja e ndau tasin me qumësht në dy pjesë dhe njërin ma zgjati mua bashkë me një copë bukë misri. Bukën ia ktheva. I thashë se do të mbanim vetëm qumështin për fëmijën. Ne nxorëm nga çanta bukën që na kishte vënë familja e Lekës. Ajo ishte lagur, Besari e ndau në dy-tri pjesë dhe e vuri të ngrohej pranë zjarrit. Ne hëngrëm duke e ngjyer bukën në kupën e drunjte me shëllirë që e kishim marrë në shpellë, ku kishim fjetur një natë më parë. Asnjeri nuk fliste. Dëgjoheshin vetëm brambullima e zjarrit dhe regëtimat e kandilit. Të parët zuri gjumi tre fëmijët e vegjël që i vunë të flinin në qoshen përballë plakës, pastaj vetë plakën.

Rrinim zgjuar, Besari, unë, i zoti i shtëpisë, që s'ia mësuam kurrë emrin, e shoqja, dhe djali i tyre i madh trembëdhjetë-katërmbëdhjetëvjeçar. Luftëtari rrallëherë përpëlitej dhe binte prapë në gjumë. Kjo letargji e tij na dukej shumë e gjatë. Besari dhe unë ruanim çdo lëvizje të tij. Ishim tepër të shqetësuar dhe pothuaj i kishim harruar të zotët e shtëpisë fare, natën e pabesë dhe çdo rrezik që mund të na kanosej nga çasti në çast. Ai fëmijë atje ndanë vatrës ishte jeta dhe vdekja jonë.

Po sikur... Jo, ky mendim më tmerronte dhe s'doja ta pranoja. S'ishte e mundur. S'na e kishte rrëmbyer dot gjermani dhe të na e rrëmbente shiu... Me këtë shqetësim e vërente fëmijën dhe Besari. Fytyra e tij me tipare tepër burrërore

qe e menduar. Herë pas here i hidhte ndonjë vështrim tinëzar dhe i zoti i shtëpisë, dhe te buzët e tij të holla, të puthitura fort, dukej urrejtja që i zinte përbrenda.

— Ta lëvizim, — thashë unë me një ndjenjë padurimi e frike dhe iu afrova fëmijës.

— Jo, — tha Besari. — Ashtu siç i shkoi e ftohta, ashtu duhet t'i shkojë dhe e ngrohta gjer në palcë që të përmendet.

E shikoja me admirim herë pas here shokun tim partizan, që s'e humbiste toruan në asnjë rrethanë. Nga rrobat e tij të leshta dilte avull. Pallton prej shajaku e kishim vënë pranë zjarrit. Avulli që dilte prej saj, mua më kujtonte fjollat e mjegullës mbi luginë, kur e davariste era.

— Shtrati është gati, — i tha e shoqja të zotit të shtëpisë. Ajo hyri nga dera e dhomës tjetër, andej nga kishte dalë dhe hyrë më parë. Të dyja dhomat e kësaj shtëpie komunikonin me një derë të brendshme. Burri u bë gati të ngrihej.

— Burri fle me burrin, — u dëgjua zëri i Besarit. — Ti do të flesh sonte këtu, në këtë dhomë, me ne.

Dukej që të zotin e shtëpisë urdhrat e Besarit e tërbonin, çdo fjalë e dëgjonte duke u gëlltitur dhe e kuptonte se s'kishte si të dilte nga kjo pozitë shumë poshtëruese. As ai e as ne nuk e fshihnim armiqtë për njëri-tjetrin. Ne kishim forcën, dhe ai ishte i detyruar të na nënshtrohej.

— Ju partizanët e hiqni veten si djem të popullit, të urtë e të butë, që s'prekni as majën e gjilpërës, kurse këtu veproni allahu na ruajtë, na caktoni dhe vendin se ku duhet të flemë.

— Ne jemi të urtë e të dashur me popullin, por jo me armiqtë, — i tha prerë Besari.

— Ne ju quajmë ju armiq.

— Aq na bën ç'na quani ju. Ju ballistët hëngrët në një çanak me italianët, kurse gjermani ju ka në vend të çirakut.

— Dhe ju jeni shitur te rusi.

— Kot llomotitni, për të ngatërruar gjurmët. Populli e sheh me sytë e tij se në Shqipëri nuk ka asnjë rus.

— Sot s'janë, po nesër do t'i thërritni të vijnë.

— Boll na përrallise. Të ishit atdhetarë ti dhe shokët e tu ballistë, nuk do të na prisje këshu me këmbët e para, kurse je gati t'i presësh me gosti gjermanët, që lyejnë duart me gjakun e shqiptarit. Ky fëmijë, që ia vranë nënën dhe babané nazistët, do të jetojë, do të rritet e do t'i marrë vesh të gjitha dhe për ty, që në një natë dimri s'deshe t'ia hapje derën dhe, po të mundje, do t'ua dorëzoje gjermanëve. Të mallkuar! Unë e di ç'do ti, — dhe i tregoi grykën e maliherit. — Po dije se e ke jetën nga ky fëmijë, se, të mos ishte ky, do të të rripja lëkurën, more vesh! Do të ta rripja me majë të thoit.

S'e kisha parë ndonjëherë Besarin aq të egërsuar. Ai fliste fort dhe trupi i tij i madh ishte lëshuar drejt ballistit, që ishte tutur nga ky shpërthim i papritur. Erdhi dhe e shoqja që nga dhoma tjetër. Me një ndjenjë frike, ajo pa të shoqin dhe ne, qëndroi një copë herë në këmbë, pa thënë asnjë fjalë. Duhej të ishte afruar mesnata. Po në këtë shtëpi ajo s'mund të qetësonte asnjërën palë.

Luftëtari hapi sytë dhe filloi të qante. Unë e mora në duar me një ndjenjë të papërmbajtur gëzimi.

— Besar! Po qan! Gjallë! Shpëtoi! Besar!

Fëmija qante, unë e mbaja në duar. Qante dhe e qara ishte jeta. Ai kishte ndofta uri dhe, kur uria të bën të qash, kjo do të thotë se kërkon të jetosh. Besari nxori lugën prej druri, mori tasin me qumësht, mbushi lugën dhe filloi t'ia jepte. Unë e mbaja. Fëmija pinte. Që kur ishte ndarë nga gjiri i nënës, ai po pinte për herë të parë qumësht. Rrufiste fare pak. Unë pashë gruan që u përlot. Nënë, mendova me vete, dhe nëna, që krijon jetën, e çmon atë më shumë se kushdo tjetër.

Dhe kjo grua duhej të kishte dëgjuar për ne partizanët shumë gjëra të tmerrshme, ndofta na shikonte për herë të parë. Sytë e Besarit, që i kisha parë ashtu të egërsuar, tani ishin mbushur plot dritë dhe, tek buzëqeshte, dhëmbët, nën mustaqet e zeza, i dukeshin dhe më të bardhë se ç'i kishte në të vërtetë.

Kishte katër gjer më pesë orë rresht që e ndiqnim fëmijën tërë frikë dhe ankth. Ai hapte ndonjëherë sytë dhe binte prapë në gjumë. Tani po pinte nga pak qumësht. Sidoqoftë po pinte. Çdo rrezik kishte kaluar dhe unë e Besari provonim lumturinë më të madhe.

— Tani mund ta nxjerrësh nga leshi, — tha Besari.

Unë mora pelenat, që ia kisha tharë, dhe fillova t'ia shtroja që ta lidhja. Gruaja mori dy kopaçe dru nga fundi i dhomës dhe ia vuri zjarrit. Ajo, kur unë bëhesha gati ta lidhja fëmijën, m'u afrua e më tha me një zë të butë:

— Ma lër mua.

Dhe unë ia lashë ta lidhte. Ballisti kishte ndezur një cigare tjetër dhe po i thithte me ashk.

— Shko fli, — i foli ai së shoqes gjithë inat. Ajo vazhdoi ta lidhte, e mori në duar, ma

dha mua, pastaj iku në dhomën tjetër, e hesh-  
tur, pa folur!

— Do t'ju mallkojnë dhe të afërmit tuaj, me siguri do t'ju mallkojnë, por do të jetë vonë, —  
i tha Besari ballistit.

Luftëtarin e morëm me radhë në duar, herë unë, herë Besari, duke e mbajtur gjithmonë pranë zjarrit. Ai na bëri të harronim krejt se në këtë shtëpi, si kjo natë e zezë, tej dritares, na rrethonin ballistët, rreziku i përhershëm i vdekjes dhe se një nga ata na rrinte këtu, fare pranë, i heshtur e ogurzi, si gur varri.

Fëmija ra përsëri në gjumë. Zjarri digjej i ushqyer përherë me dru. Jashtë dëgjohej e lehtë e një qeni dhe te të dyja dritaret e vogla të shtëpisë era trokiste mbi xhama.

— Po fryn lindja, — tha Besari, — mbase koha do të hapet, po do të bëjë shumë ftohtë.

Në dhomë rrinin zgjuar tre veta: unë, Besari dhe i zoti i shtëpisë. Ne flisnim me njëri-tjetrin pa ia ndarë sytë të tretit, i cili shuante dhe ndizte cigaret njëren pas tjetrës. Ne ngroheshim dhe tereshim njëkohësisht me rrobat veshur. Pranë zjarrit kishim vënë vetëm pallton prej shajaku të Besarit dhe xhakaventon time italiane. Luftëtarin e kishte zënë gjumi. Fytyrën e vogël ia kisha mbuluar me shaminë ngjyrërozë që më kishte dhënë Rusha. Nga kjo shtëpi duhej të iknim pa aguar. Duhej të kishte vajtur mesnatë. Besari më tha të merrja një sy gjumë. Unë fjeta pranë fëmijës. Pastaj u zgjova që të flinte Besari. Kur u zgjova, të zotin e shtëpisë e kishte zënë gjumi, ashtu pa u mbuluar, pranë plakës. Ai gërhiste. Tulla me lesh të bardhë e pushatak vende- vende reflektonte nën dritën e flakëve si një sini e vogël e ndryshkur.

Besarit, kur flinte, i lëvizte një anë e musta-

qes. Maliherin e kishte mbështetur në gjoksin e tij të gjerë, kurse rripin e kishte mbështjellë pas qafës së dorës. Vetëm ai, megjithëse kishte pasur raste, nuk e kishte ndërruar armën. Thoshte se e kishte të gjyshit, i kishte marrë syrin dhe me të godiste fletën e cigares njëqind metra larg. E kisha parë dhe me sytë e mi, kur merrte shenjë në ditë të qeta në ndonjë zonë të lirë.

Kur u zgjua, u dëgjuan gjelat. Besari mbante vesh dhe unë kujtova se ai kishte qejf të dëgjonte këngën e tyre.

— Ky është këtu pranë, i të zotit të shtëpisë, ata të tjerët janë të fqinjëve. Fqinjët s'qenkan aq afër, se gjelat mezi dëgjohen, — pëshpëriti Besari.

E lehura e qenit, herë në oborr, herë pranë dritareve, i mbyste kirikitë e këndesave. Duhej bërë gati të iknim. Futëm ato pak gjëra në çantë. Fëmijën menduam të mos e zgjonim. Ushqim do t'i jepnim rrugës. Bregasi që këtej nuk duhej të ishte shumë larg. Nga fshati duhej të largoheshim pa u diktuar, në errësirë. Kjo ndofta ishte më e vështirë se hyrja në këtë shtëpi. Ai njeri, që tani flinte duke gërhitur, kishte mbledhur dhe më shumë mllef dhe, po t'i jepej rasti, do na brente edhe eshtrat. U zgjua dhe plaka. Ajo filloi të kollitej, nxori gëlbasën dhe e hodhi në hi. I foli nuses. Ndofta nusja flinte këtu pranë me fëmijët, po në vend të saj këtë mëngjes u ngrit i zoti i shtëpisë. Ai as iu përgjigj plakës, po hapi kutinë dhe drodhi një cigare. Pas pak erdhi dhe Ruza, e thirri më në fund plaku në emër.

— Avdesin, — tha plaka dhe përsëri unë pashë një rit të mërzitshëm.

— A ka në fshat ballistë? — pyeti pas një heshtjeje të gjatë Besari.

— Ka, — tha shkurt i zoti i shtëpisë.

— Po gjermanë?

— Ku ta dish. Ata vijnë dhe ikin pa pyetur njeri.

— Ne duam të ikim në drejtim të zonës së Shpatit dhe dikush duhet të na tregojë rrugën.

— Ju, ashtu si erdhët, mund të ikni, pa marrë lejen tonë.

— E di se ç'bluan në kokë, po mos harro se, sido që të bësh, po veproje me të pabesë, ty do të të rrjepim të parin. Ne dikush do të na shoqërojë dhe ky do të jetë djali yt i madh.

Ballisti u trondit. Siç dukej, këtë s'e priste.

— Pyeteni. Po t'ju vijë...

— Ai do të vijë, — dhe Besari shkoi e i hodhi dorën në sup. — Mbase ky fëmijë s'vazhdon rrugën tënde.

— Ju do ta merrni si peng?

— Ne do ta marrim të na tregojë rrugën deri në njëfarë vendi dhe do ta lëmë të kthehet prapë.

— Korba unë! — klithi Ruza. — Përse fajet e babait duhet t'i lajë i biri? Mezi e kam rritur.

— Ruzë! Dëgjo një shoqen tënde! Mos të të shkojë mendja për asgjë të keqe. Ne kemi marrë një rrugë të gjatë e plot rreziqe për të shpëtuar këtë foshnjë. Partizanët vrasin vetëm armiqtë. Ne bëjmë fajtor burrin tënd, po s'kemi asgjë me të birin. Mos ki frikë, Ruzë!

— Po kurdisi ndonjë pabesi yt shoq, — tha Besari, — ky do të jetë dhe vrasësi i tët biri. Nisemi, Teuta.

Unë mora djalin dhe përkrah meje ecte Nisemi 14-vjeçar, që Ruza, e shqetësuar, e mbante për dore.

— Prina, Ruzë, — i thashë, — shpejto të lidhësh qenin. Nuk duhet të ngjallim asnjë dyshim. Kjo na rrezikon të katër.



Ne dolëm, ndërsa Besari qëndroi te pragu i derës. Ai duhej të paralizonte çdo veprim të ballistit. Ruza më shtrëngonte dorën fort dhe unë e kuptova se ç'donte të thoshte ai shtrëngim. Si nënë, më linte porosi të birin. Besari na arriti kur kishim dalë tutje fshatit, në luginën e vogël. Ishte ende pa zbardhur. Të lehurat e qenve na kujtonin se fshatin po e linim pas. Në ballë ecte Besari, pas unë me fëmijën në duar dhe në mes Nimeti. E lamë rrugën këmbësore dhe po ecnim arave. Mund të ishte grurë ose bar ai që shkelnim, s'mund ta dalloje, por ishte i lagur dhe vende-vende këmba na hynte në baltë. Shi s'bin-te më, po qielli ishte i vrenjtur sa s'dukej asnjë yll. Ne duhej të shpejtonim sa më shumë. Gjurmët tona kishin mbetur në shtëpinë e një ballisti... Qëndruam për një çast dhe mbajtëm vesh për ndonjë lëvizje. Ende s'ishte hapur mëngjesi. Gjithçka mezi dallohej, errësira ua fshihte format gjithë sendeve përreth. Fshatin duhej ta kishim lënë larg.

— Ma jep ta marr dhe unë fëmijën, — tha Nimeti.

— Falemnderit, Nimet, s'jam lodhur, — i thashë, — ti, dhe kështu, diçka ke bërë për këtë jetim që ia vranë prindërit gjermanët.

— Dhe unë i urrej gjermanët.

— Po s'i urren yt atë, se!

— Ku ta di unë, në fshat, kur vijnë gjermanët, të gjithë tremben, mua më duket se dhe babai, — tha Nimeti.

Kur zbardhi, qëndruam. Ishim pikërisht tek ai vend që unë e quaja mal dhe Besari kodër.

— Si e quajnë këtë mal? — e pyeti Nimetin.

— Mali i Komitit. Po këtej nuk shkohet për në Shpat.

— As ne nuk do të shkojmë në Shpat, — i tha

Besari. — Tani, ti, trim, do të kthehesh. Besoj e di rrugën për në shtëpi, ë?

— E di, — tha Nimeti, — si nuk e di.

— Dhe mos e harro këtë natë, as këtë copë rrugë që bëmë bashkë.

— Kështu janë të gjithë partizanët? — pyeti djali.

— Kështu dhe mbase më të mirë, — i tha Besari.

— Sikur të mos ishit zënë me babanë, do të kishit qëndruar akoma në shtëpinë tonë.

— Jo, në shtëpinë tuaj s'mund të qëndronim më shumë. Ne, ty, Nimet, këtë të urojmë, të mos i vesh pas babait tënd. Ai kërkon të të lërë njo llë që është vështirë ta heqësh tërë jetën. Vdekje fashizmit! — përshëndeti Besari me grushtin lart.

Edhe fëmija ngriti grushtin lart dhe na shikonte i heshtur, pa ditur ç'të bënte.

— Tani nisu, Nimet! Ruza të pret e merakosur, shpejto, — i thashë unë.

Ai iku duke tundur dorën. Edhe ne u nisëm. Ktheva dhe një herë kokën pas. Silueta e djalit ishte shkrirë në mugullirën e mëngjesit. Ne po linim pas dhe Malin e Komitit dhe ndofta Bregasi na priste përpara pa ndonjë të papritur.

— Në atë kodër ka pasur jafakun një komit dhe ka marrë emrin e tij, — tha Besari duke treguar konturet e tij që nxinin.

— Mal me emër të bukur, — thashë dhe ia vura fëmijën në duart e mëdha Besarit, që i mbante të hapura, ndërsa vetë eca përpara me mendimin se na priste një mëngjes pa rreziqe.

## «Binjakët e nënës»

Pas katër ditësh jetimi buzëqesh në duart e njerëzve. Sytë e kaltër picërrojnë në fytyrën e vogël dhe të hequr. E marrin me radhë të gjithë në duar, plaku Bato dhe nënë Bekoja, e reja e tyre, Rasimeja, Besari, unë, Lina, mbesa e tyre e madhe. Qesh dhe çuçurit në gjuhën e pakuptuar të fëmijës.

— Luftëtar, eja te babagjyshi!

Plaku Bato e pëlqeu këtë emër dhe e thërret me të sa herë i drejtohet fëmijës. Zgjat duart, e merr, e gudulis me gishtërinjtë e rreshkur. Në shtëpi kemi dy të vegjël. Tjetra është vajzë e Rasimesë, mbesa e të dy pleqve. Ajo është tremuajshe, ndofta kaq është dhe Luftëtari, por ai vjen më i paktë. Neve na duket sikur e kanë zvogëluar e mplakur këto katër ditë udhëtimi. Burrin Rasimeja e ka partizan. Na thonë se ka gjashitë muaj që s'kanë asnjë lajm për të dhe në këto ditë operacioni nuk mund të mos vihet re shqetësimi te pleqtë, tek e shoqja, megjithëse përpiqen që të mos e tregojnë. Luftëtari sot ka pirë qumësht gjiri. Ky fëmijë është me fat. Ai u shpëtoi plumbave të gjermanit në masakrën e shpellës, u shpëtoi rreziqeve në këto katër ditë shtegëtimesh dhe ja tani, në këtë shtëpi, gjejmë dhe një lehonë, sikur ajo të mos kishte lindur vetëm për fëmijën e vet, po dhe për këtë jetim. Unë e marr në duar dhe i tregoj Besarit të qeshurën e fëmijës, që duhet ta dëgjojnë njerëzit. Me atë të qeshur fëmija flet, flet dhe e ëma e kësaj foshnje, Fatmiri i rënë, fshatrat që digjen nën tymin e zi. Vallë përse digjemi, përse vritemi? Për këtë të qeshur?

Dhe kjo e qeshur fëmije është e çiltër, e që-

ruar, e pastër si vetë dielli, pa njolla, pa tym të zi. Mua më duket se kështu mendojnë dhe Besari, dy pleqtë, Rasimeja, fëmijët e mbledhur rreth vatrës. Qeshin dhe ata me të bashkë, qeshin dhe e ngrënë lart duke e hedhur hopa.

Nënë Bekoja i mori të dy foshnjat në pëqinjtë e saj, pranë e pranë. Ajo i quan «binjakët e nënës». Ndofta tani mund që dhe vajza s'e ka babanë. Po rron buzëqeshja e «binjakëve të nënës». E mua më kujtohen fjalët e një profesori të gjimnazit: «Nuk vdesin vetëm ata që lindin jetën». Dhe ne partizanët hyjmë në të tillë njerëz.

Është koha që të dy foshnjat të lidhen dhe të flenë. Më përpara Rasimeja u jep të pinë. Kokat e tyre të vogla e të rrumbullakëta janë pranë e pranë.

Fëmijët i lidhën të dy në djepe. Pranë tyre është vajza e madhe, ajo i tund dhe i përcjell me ninananën shekullore të gjumi i ëmbël.

Pak nga pak njerëzit rreth vatrës rrallohen.

Është vonë. Fëmijët kanë fjetur. Kemi mbetur vetëm ne të rriturit. Në një sini plaku Bato dhe Besari kanë vënë përpara gjizë, pak djathë, turshi domatesh dhe pinë raki me filxhanë. Filxhani im qëndron gjithmonë plot e, megjithë që më ftojnë të pi, unë, sa e ngre të uroj, e vë të buza dhe pothuaj e lë ashtu të pacenuar.

— Këtu je si në shtëpinë tënde, — më thotë plaka. — Hajde të pimë bashkë, — dhe më nxit të ngre filxhanin.

Ajo do që edhe unë të marr pjesë në muhabet, të më nxjerrë atë druajtje që na karakterizon në përgjithësi ne femrat. Po rakia, që të zgjidh gjuhën, neve femrave na djeg buzën. Ndryshe qëndron puna me plakun Bato dhe Besarin.

— Ky është shëndeti i Zigurit, — dhe plaku

ngre filxhanin. — T'i thoni për Luftëtarin të mos ketë merak, do ta rritim si fëmijën tonë, se është një amanet që s'e tret dheu. T'i jepni të fala. Sikur dhe Batos të mos ia kishte brejtur kyçet përdhesi, — dhe ai me dorën tjetër rrahu gjurin, — nuk do të kisha qëndruar pranë hirit, me plakën. E kam zili, se nuk është vetëm trim, por edhe i fortë, Ziguri, — thotë plaku duke ngritur filxhanin lart.

Ziguri është komandanti i batalionit tonë, me flokë të thinjur, po mustaqet i ka pis të zeza. Ai mban gunë dhe një feste të bardhë të thurur me grep. Përveç një palë çizmesh gjermane, asgjë tjetër s'ka të huaj mbi vete. Mban rroba vendi të leshta dhe në këtë pikë është dhe më fanatik se Besari.

Plaku e përplas filxhanin me Besarin, pastaj më drejtohet mua:

— Ngreje dhe ti, moj çupë! Njëherë e një kohë gratë s'qaseshin në sofër me burrat e s'pinin raki. As shëndete s'ngrinin për gratë. E ne këtej akoma nuk i qasim. Po për ty ngrita një shëndet, se ju partizanët morët malet e s'u latë gjë mangët burrave. Pije! — tha plaku me një ton të prerë. — Pije! Për Zigurin!

Ai ka ngritur me radhë disa shëndete për partizanët, për Luftëtarin, për Besarin, për mua. Vetë të gjitha i pi me fund, këtë e kërkon dhe nga Besari. Nga ky rregull jam përjashtuar unë, e megjithatë plaku do të më futë dhe mua në vallen e filxhanëve. Kjo bomb me dolli është në këto anë triumfi i muhabetit, ose, siç kam dëgjuar të thonë, «lezeti i trapezit». Besari i qëndron plakut filxhan për filxhan, ai është «usta i dollisë». Në një çast plaku Bato u bë në qejf dhe thirri:

— Ah, ta kishim këtu dhe Zigurin!

Afshi i zjarrit nga oxhaku përhapej i ngrohtë e i këndshëm. Unë jam veshur me një palë rroba të Rasimesë. Edhe Besari është ndërruar krejt. Teshat tona i kanë larë dhe i kanë vënë rreth zjarrit të teren. Mendoj për këto ditë që udhëtuam mes rreziqesh e vështirësish. Më duket se dita e katërt s'ka asgjë të saj, përveç çastit të largimit nga shtëpia e ballistit, të fytyrës gjithnjë të menduar, plot pikëllim, të Ruzës dhe të Nimetit, që ende i vogël jeton tragjedinë që ka kurdisur i ati, në atë shtëpi që nesër do të jetë vetëm e tij. Po ai çast ndarjeje në atë mëngjes të errët i takonte thjesht trokitjes sonë në derë mes atij rrebeshi të madh që e nxiu ditën më shumë se mjegulla që kishte rënë mbi luginë. Rruga gjer në Bregas s'pati asgjë të veçantë. Kur kujtoj udhëtimin tonë në tri ditët e tjera, kjo rrugë e atij mëngjesi më ngjan si një udhëtim i zakonshëm, që s'pati gjë shqetësuese.

Në të lindur të diellit arritëm në Bregas. Fshati shtrihet në faqet e një kodre me gji nga dielli. Në fushën e vogël, nën këmbët e saj, takuam lopçarin e fshatit. Ai na tha se fshati që kishin përpara qe Bregasi. Na tregoi dhe ku ishte shtëpia e Bato Shkëmbit. Kur na pa me yjet e kuqe në ballë, sigurisht na njohu që ishim partizanë dhe, si m'u duk mua, kio jo vetëm ishte e papritur për të, po dhe s'i pëlqeu. Fjalët i përtyppte dhe na dha përshtypjen se më shumë donte të mësonte, sesa të na jepte. Ndofta deshi të pyeste dhe diçka për foshniën, po nuk guxoi të fliste, se dhe ne patëm për të atë përshtypje pakënaqësie. Kur ia treguam këtë plakut Bato, ai prishi buzët. Porositi të lëshonin qenin më shpejt se herët e tjera. Kjo natë më dukej sikur s'kishte të bënte me të sotmen, ajo i takonte së nesërmes. Unë e Besari e ndienim veten të leh-

tësuar. Luftëtari do të jetonte. Gjumin e përjetshëm do ta kishin më të lehtë prindërit e tij të masakruar te shpella, Fatmiri te lisi me rrënjët e thella. Unë përfytyroj çastin kur do të shkojmë te komandanti, kur t'i tregojmë për mikun e tij Bato Shkëmbin, e mbi të gjitha për jetën e një foshnjëje, që nuk u ndërpre në këto ditë dramash, kur vdekja korr me kosë të gjatë e jeta vazhdon e kalitet mes luftës.

Plaku ka qejf të rrimë dhe nesër, po, kur mendon për ndonjë të papritur, nuk ngul këmbë. Nesër do të nisemi dhe shtegtimi ynë për të shkuar në zonat ku vepron batalioni është më i lehtë. Ne jemi dy partizanë e veç kësaj do të kthehemi mbase nga ato vende që erdhëm, dhe shtigjet e rrugët s'janë më të panjohura për ne. Plaku Bato del herë pas here dhe përgjon. Atë e bren shqetësimi për ne. Përgatitemi për të fjetur. Është vonë, po kemi natën e gjatë të janarit përpara. Plaku Bato dhe Besari shkuan të flenë në dhomën e miqve, kurse ne gratë e fëmijët qëndruan këtu në dhomën e zjarrit. Na kanë shtruar në dysHEME dyshek leshi. Pranë meje është Rasimeja. Në njërin krah është djepi i Luftëtarit dhe në tjetrin ai i vajzës së Rasimesë. Jemi mbuluar me rroba të leshta. S'di pse më është larguar gjumi. Nga zjarri i mbuluar me hi në vatër, përmes errësirës, një thëngjill i ndezur feks si një pikë e kuqe e ndritshme. Kthehem me fytyrë nga tavani. Dhoma është e mbushur me errësirë dhe s'duket asgjë, as muret e bardha, të lyera me gëlqere. Po ja, këtu mbi kokën time, në tavanin me dërrasë pishe, në mes me një rreth të madh, në qendër të rrethit është gdhendur një shqiponjë. Një shqiponjë me dy krerë, me krahët hapur. Në errësirë s'dallohej asgjë, po me sytë e mendjes e përfytyroj, ashtu

siç e kam parë. Me hamendje përpiqem të gjegjë se ku është qendra e tavanit këtu diku mbi kokën time. Çudi, mendoj me vete, pse ne shqiptarët e kemi shqiptonjën me dy kokë? Kam dëgjuar dhe lexuar se shqiptonjën e kanë dhe kombe të tjera, e kanë pasur në emblemat e tyre dhe shumë princër e mbretër. Por ata të gjithë e kanë me një kokë. Ne shqiptarët e kemi thyer përftyrimin real të zogut. Kjo s'mund të ketë ardhur nga padija. Është me të vërtetë për t'u çuditur, se nëpër çezma e sofate, në monumentet e lashtësisë gjen një kafshë si luanin me një përftyrim të saktë, megjithëse nuk jeton në viset tona, kurse shqiptonja është zogu i këtij trualli dhe shqiptari i njeh me imtësi edhe çdo fije puple e duhet të ketë pasur një shkak që të parët tanë t'i kenë shtuar edhe një kokë tjetër. Ç'mo solli te ky mendim? E kam parë mijëra herë shqiptonjën dykrenare të flamurit dhe kjo më është dukur një gjë e zakonshme. Veç ajo nuk është vetëm në flamur. Në këtë shtëpi e kam parë në dy vende: në mes të lules së një qilimi dhe te ky tavan që kam mbi krye. E kam parë të gdhendur në musëndra, mbi oxhakë, në fletët e xhamadanëve, në shamitë e kokës. Në këto zona ajo është e pranishme pothuaj në çdo shtëpi. Ajo s'është vetëm një simbol. Përderisa është e pranishme dhe në sendet më intime të njerëzve, është shumë më tepër. Po pse me dy kokë?! Të jetë një dyfishim force dhe fluturimi? Ka mundësi. Për sende që më rrethojnë, e kam zakon t'u vë përpara atë pse-në e gjimnazistes.

Mbase shpjegimi që jap unë për shqiptonjën me dy krerë nuk është i saktë, mbase do të ketë një shkak tjetër të rëndësishëm ose të parëndësishëm, siç ndodh shpeshherë me shumë gjëra që na kanë lënë kohët dhe njerëzit. Kështu me



dy krerë ka ardhur që nga koha e Skënderbeut. Mundet dhe më larg akoma. Skënderbeu duhet ta ketë gjetur në këtë truall, atij i ka pëlqyer dhe e vuri në emblemën e tij si simbol të krejt Arbërisë. Dhe nga një kohë kaq e largët, ajo mund të arrinte gjer te ne vetëm duke qenë në dy kokë.

Që kur kam dalë partizane, është hera e parë që filozofoj kaq gjatë me veten time. Në fillim doja të mendoja për ato që hasja në rrjedhën e kësaj jete, krejt tjetër nga ajo e gjimnazit, të mendoja për komandantin që mbante gunën e hedhur mbi një sup, për fshatarët e këtyre zonave, për malet. Po pastaj këto u shuan dalëngadalë dhe u shkruiva me gjithçka ashtu pakuptuar, ditë pas dite, muaj pas muaji. Tani më ka ikur ajo prirje për të filozofuar. Më kujtohet një pjesë që na përthente mësuesi i letërsisë nga gjermanishtja prej Faustit të Gëtes, kur niste ta komentonte.

— E para fjala. Jo, e para vepra.

Dhe këtu veprohet, më tepër sesa flitet, vendimet janë të shpejta e të shkurtra. A nuk ndodhi kështu edhe me ne këto katër ditë udhëtimi? Në fillim mua më bënte përshtypje gjithçka, isha shumë sentimentale. Më kujtohet kur pashë njeriun e parë të vrarë. Atë e goditi plumbi pranë meje dhe i çau ballin mes për mes. Partizani arriti të nxirrte vetëm një psherëtimë dhe heshti. Po gjaku nuk i pushonte. Ai i mbuloi fytyrën. U dha sinjali për sulm. Unë isha shumë e tronditur, gati e ngrirë në vend. Ndjeva të më mpiheshin gjymtyrët dhe automatiku më ngriu në duar. Të gjithë u hodhën përpara. Krismat dhe zërat trazoheshin, njerëzit binin dhe ngriheshin, por ecnin, ecnin përpara. S'ecnin vetëm ata që s'ngriheshin dot më. Në atë betejë gjermanët

u thyen. Unë i gjeta shokët rrëzë një shpati. Ose më mirë ata erdhën dhe më gjetën mua. Tre partizanë vinin te kodrinat ku ishte zhvilluar luftimi. Unë kisha qëndruar mbi trupin e shokut të vrarë. Binte shi. Gjaku dhe shiu i përziheshin mbi flokë, mbi ballë. E çara e plumbit erdhi një çast që mbeti si një zambak i madh i kuq. Gjak s'rridhte më. Pikat e shiut po ia lanin gjithmonë e më shumë vilarët e kuq dhe tani fytyra e shokut dukej më mirë. Mua më erdhi për të qarë dhe qava. Po këmbët nuk më bënë të ikja. Isha si një njeri i zënë nga cerma, që s'mund të lëvizë asgjë.

— Kujtuam se dhe ti ishe vrarë! — tha njëri nga të tre partizanët që erdhën. — I shkreti Adil! E paska marrë plumbi mu në ballë.

— Këtë e ka zënë gjaku, — tha tjetri për mua, që s'lëvizja nga vendi dhe lotët më rridhnin vetiu.

E varrosëm aty bri pozicionit ku kishte rënë. E varrosën ata, se unë s'isha e zonja të lëvizja as këmbët, as duart. Kur do të iknim, ngritën grushtet dhe shkrepën një batare pushkësh. Kjo ceremoni e thjeshtë varrimi ndryshonte nga të gjitha ato që kisha parë unë. Qe e shkurtër, pa lot, me grushte të shtrënguara e batare pushkësh, po jo pa dhembje.

Ajo batare mbi atë varr më flaku tej mpirjen e gjymtyrëve, fashitjen e shpirtit. Ishte një zgjuarje e menjëhershme, gati magjike. Iku ajo shastisja që më kishte kërdhur në një limonti dremitëse dhe trupi im u ngreh si një sustë, me të gjitha forcat që kishte. S'më kishin zgjuar krismat e një beteje që zhvillohej para syve të mi, që gjëmonte në veshë plot oshëtima shurdhuese dhe ja, krismat e një batareje në një

hapësirë të ngrirë, boshe, kishin forcën e një trandje të tillë.

U ngritëm, nderova me grusht te varri i të rënit dhe shkropa automatikun tim. Ata të tre shikuan njëri-tjetrin pa folur. Dhe ashtu, të heshur, u nisëm drejt batalionit.

Tani më duket se jam një tjetër. Në të vërtetë jam po ajo vajza ëndërrimtare, e ndjeshme, kureshtarë, veç më pranë njerëzve. Edhe në qytet e në gjimnaz isha midis njerëzve. Duket që s'i gjej dot fjalët për të shprehur ato ndryshime që kanë ndodhur tek unë gjatë jetës partizane. Si të them, kam thyer një lloj lëvozhge e kam dalë nga vetja duke qenë më e sigurt midis njerëzve dhe duke jetuar më shumë për ta.

Unë kam marrë pranë Luftëtarin. Do të fle me të për herë të fundit. Që tani ndiej një mall tronditës. Unë jam vajzë, po dua të quhem dhe unë nëna e dytë e tij. Këtë s'mund t'ia them dot këtij fëmije, që është ende pa gojë, por një ditë, kur të rritet. Unë s'kam për ta harruar kurrë. Me siguri do të vij në ditët e lira, e, po i shpëtova plumbit, do ta kërkoj e do ta gjej. Po ta pranojnë lutjen time Besari, plaku Bato e nënë Bekoja, Luftëtari do të jetë fëmija im i parë, se ai ka shumë nëna dhe baballarë, sa s'ka asnjë në Shqipëri. Nesër do të ndahemi, i them Luftëtarit me zë. Më dëgjon Rasimeja, që duket se edhe atë s'e ka zënë gjumi.

— Fli, — më thotë, — se ka vajtur shumë vonë.

Dhe mua gjumi më zë me këto emocione. U zgjova, kur mbi sup ndjeva dorën e një njeriu. Në errësirën e dhomës njoha Besarin që më thëriste të çohesha shpejt. Duhej të kishte ardhur mëngjesi dhe do të niseshim. Plaka ndezi kan-

dilin dhe pashë se qëndronin në këmbë dhe plaku Bato e Rasimeja.

— Do nisemi? — thashë unë.

— Po, — tha Besari.

Shkova në dhomën tjetër dhe veshja rrobat partizane. Qeni lehte i egërsuar, sa nga një anë nga ana tjetër. Plaku Bato dhe Besari po bisedonin me zë të ulët.

— Mund të jemi të rrethuar, — tha Besari. E kuptova menjëherë se atë «mund» Besari e shtonte për ta zbutur para meje të vërtetën. Plaku Bato shkonte nga një dritare në tjetrën. Qeni vazhdonte të egërsohej dhe më shumë. Dikush e qëlloi me një gur. Qeni u hakërrye.

— Lopçari, — tha plaku Bato.

— Sa orë natë do të ketë akoma? — pyeti Besari.

Plaku Bato nxori sahatin nga xhepi.

— Dhe për një orë gdhin.

Ne morëm vendim të vepronim sa që natë, për të përfituar nga errësira dhe për të çarë rrethimin. Fikëm kandilin. U përshëndetëm me të gjithë. Përpara do të dilte Besari dhe menjëherë pas tij unë. Te dera qëndronim të tre. Ishte i vetmi vend nga mund të dilnim. Dritaret, në ballin e shtëpisë, nga mund të manovronim, ishin me hekura. A duhej ta dinin një hollësi të tillë ata që na kishin rrethuar? Sidoqoftë derën duhej ta ruanin dhe për ne ajo ishte e vetmja dalje. Duhej të dilnim patjetër, dhe sikur të vriteshim. E kishim kryer misionin tonë e vdekja nuk mund të peshonte për ne më e lehtë se në këtë mëngjes. Unë këtë e ndieja te vetja, te shoku. E kuptonim se, të çanim rrethimin, nuk do të ishte e lehtë. Na kishte takuar të binim disa herë në rrethim, sidomos në këto ditë operacioni, po ky rrethim ndryshonte nga të tjerët. Ne ishim në

një shtëpi dhe mund të dilnim vetëm nga një derë. Me siguri tani të gjitha tytat e pushkëve dhe të mitralozave ishin drejtuar drejt saj. Dhe ne duhej të dilnim pikërisht të ky shteg i gushtë, që nuk e kishte atë hapësirë të rrethimeve në terren. Po në këtë rast bëhej fjalë për dy veta, për mua dhe Besarin. Natyrisht as ne nuk donim të vdisnim dhe s'do të vdisnim pa i harxhuar fishekët që kishim. U afruam te dera, Besari, unë dhe plaku Bato. Qeni vazhdohte të lehte i hakërryer. Njëherë menduam që plaku Bato të shtinte nga dritaret për t'u tërhequr vëmendjen dhe ne të çanim përpara nga dera. Po hoqëm dorë nga ky plan. Ndofta ata që na mbanin në rrethim, mund të pandehnin se ne nuk i kishim diktuar. Ky do të ishte rasti më i mirë për të përfituar nga befasia. Dhe kështu vendosëm. U bë gati të dilte Besari dhe pas tij unë. Plaku Bato e përqafoi partizanin, pastaj i mbajti fort të shtrënguar dorën duke e shikuar në sy. Ishte një vështrim kuptimplotë, kur çdo fjalë është e tepërt. Sa hapi derën Besari, shpërthyen breshëri të shtënash. Ai ra përpara nesh. Unë dhe plaku Bato e kapëm trupin e tij të plagosur dhe e futëm brenda. Tani çdo gjë ishte e qartë. U dëgjua një e folur në shqip, e egër, kërcënuese:

— Hej! Të mos lëvizë asnjëri nga shtëpia! Jeni të zënë si miu në çark.

Ishin çuar dhe fëmijët. Dikush qante. Nënë Bekoja mundohej t'i qetësonte. I vuri të gjithë pas një dengu me rroba, anash dritareve, ku s'mund t'i zinte plumbi. Besari ishte i plagosur në të dyja këmbët, po plagën më të rëndë e kishte marrë në këmbën e djathtë. Plumba të tjerë i kishin shpuar rrobat, po s'e kishin zënë. Plaku Bato ia preu gjakun me duhan dhe ia lidhi me një be-

ze të kuqe. Tani e kishim të qartë se s'mund të dilnim, aq më tepër kur njëri nga ne ishte i plagosur e s'mund të ecte. E dinim që ata do të na mbanin në darën e rrethimit dhe, kur të binte drita, do të na sulmonin. Kishim armë unë e Besari, plaku s'kishte. Besari i dha revolverin e tij dhe të tre zumë nga një dritare dhe përgjonim. Dëgjonim nëpër errësirë të shara dhe thirrje që të dorëzoheshim, duke na premtuar se do të na falnin jetën. Pak nga pak po zbardhte. Tani dukeshin ushtarët gjermanë dhe ballistët në pozicione rreth shtëpisë. Besari na dërgoi nënë Bekon dhe unë e plaku Bato që kishim zënë pozicione në të dyja dritaret e dhomës tjetër, shkuam tek ai. Besari e la grykën e maliherit në dritare që të dukej nga jashtë ashtu në përgjim. Kur u afruam, tha ngadalë:

— Këtë shtëpi na e ke falur neve, o plaku Bato, që kur trokitëm te dera.

— Jo vetëm shtëpinë, po dhe veten tonë.

— Këtu do të rri vetëm unë.

— Ne jemi dy, — thashë unë.

— Ne s'jemi dy, jemi 9 veta në këtë shtëni, po njëri nga ne të dy duhet të shkojë gjallë vdekur në batalion. Unë s'mund ta bëj dot këtë, — tha Besari e tregoi këmbën e plagosur. — Ti, Teuta, e ke detyrën më të vështirë se unë.

— Jo, kurrë! — thashë unë. — Ne do të luftojmë të dy bashkë dhe, po të duhet, do të vdesim po së bashku.

— Do rrimë bashkë, — tha plaku Bato. — Nga kjo shtëpi mua nuk më shkul dot as vdekja.

— Atëherë u vendos, — tha Besari. — Ti, Teuta, do t'u tregosh shokëve për të gjitha, kurse ti, nënë Beko, do të dalësh me gjithë fëmijët.

Teutës jepi një palë rroba të Rasimesë. Do jetë vajza jote e madhe. Dhe na e bëj hallall!

— Biri i nënës! Mos u ligështo hiç për ne! Po ti pse qan? — m'u drejtua mua. — Kush do t'ua marrë hakun këtyre? Kush do t'u tregojë binjakëve për këtë ditë? Unë e ti. Shpejto e vishu!

Ajo më shoqëroi në dhomën tjetër.

Ndihesha e mpirë dhe e tronditur. Ka çaste kur njeriut jeta i duket më e vështirë se vdekja. Unë po jetoja një nga këto çaste. Pothuaj më ishin paralizuar duart dhe këmbët. Ndjeva dorën e nënë Bekos të më zbërthente pullat e xhakaventos. Ajo më zhveshi dhe më veshi si një fëmijë. Pas pak u ktheva në dhomën tjetër, e veshur fshatarçe, po kapën me yllin e kuq s'e kisha hequr. Besari e mori atë nga koka ime, vështroi yllin, uli buzët dhe e puthi e duke e zgjatur më tha:

— Këtë fute në gji, atje e ke më afër zemrës.

Unë iu hodha në qafë e ngashëryer. Ai më shkëputi nga krahët dhe më zgjati revolverin e tij, një nagant shtatësh.

— Këtë do ta marrësh ti,— më tha. — Automatikun tënd do ta mbajë plaku Bato. Tani më bjer këtu Luftëtarin.

Ai e mori me të dyja duart, i hoqi shaminë rozë që i mbulonte fytyrën, uli trupin dhe e puthi në ballë.

Nga jashtë dëgjoheshin zëra:

— Dorëzohuni, s'keni nga dilni!

— Bato Shkëmbi! Dorëzo dy partizanët dhe ty s'të bëjmë asgjë. S'keni asnjë shpresë shpëtimi!

— Po me fëmijët s'do luftoni! Burrat luftojnë

me burrat! — bërtiti plaku. — Ne këtu ju presim.

— Atëherë le të dalin gratë dhe fëmijët, — u dëgjua një zë nga jashtë.

Dera u hap. Me Luftëtarin në duar, e para doli nënë Bekoja

— Ku shkon, plakë matufe? — u dëgjua po ai zë. — Me kë je tjetër?

— Jam me fëmijët e nusen, po ju mos u trembni nga gratë. Ata që kërkoni ju, janë atje brenda.

Kur arritëm në fund të oborrit, na lanë sa ecëm dhe pak më tej dhe na dolën para një ballist dhe dy gjermanë. Të tjerët qëndronin në pozicione. Ata rrinin pas nesh që të mos kishin mundësi t'i qëllonin që nga shtëpia.

— Plaku s'doli. Qysh do të të lërë kështu të ve, — tha ballisti gjithë mllef e ironi.

— Unë jam plakë, po si do të bëjë jot shoqe që do të mbetet e ve grua e re.

— Qenke dhe brisk zotrote nga goja, po unë nuk i kursej plumbat. Po këta dy fëmijë ç'i ke?

— Janë të nuses, binjakë.

— Paska pjellë sa një bushtër! Do t'i rritë të shkojnë partizanë! Ha! Ha! Ha!

— Bushtrat rritin qen. Dhe qentë lehin rreth shtëpive, kurse këta, — tha plaka dhe i tregoi Luftëtarin, — këta do të rriten trima që të marrin hak.

— Ik, plakë shtrigë! — klithi ballisti dhe e shtyu me qytë të dyfekut, — ik, mos më ndiz gjakun, se të dhashë gjysmën e lekut!

Karvani ynë i vogël ecte i heshtur. Mua më kishte kapur fort për dore nënë Bekoja, më kishte kapur aq fort, sa kyçi i dorës më dhimhte. U dëgjuan krismat e para. Gjermanët dhe ballis-



tët shkrepnin me batare. Herë pas here dëgjoeshin dhe të shtënat e maliherit të Besarit dhe të automatikut tim. Ballistët shanin. Dhe një zë, duke sharë, papritur u kthye në një britmë dhembjeje të zgjatur. Krisma e thatë e maliherit të Besarit nuk kishte gabuar. Unë ktheja kokën mprapa dhe doja të mbaja hapat, po dora e fortë e nënës vazhdonte të më mbërthente si një darë, pa më lëshuar.

Ishte një shtëpi njëkatëshe me çardak përpara, me dy dhoma. Në ballë secila kishte nga dy dritare të vogla. Nga ato dritare luftohej. Sa t'u mbaroheshin fishekët Besarit dhe plakut Bato, nuk do t'u afroheshin dot. Për këtë isha e sigurt. Ata do të vetëflijoeshin, si Fatmiri te gërxi. Po unë?! Ku shkoja?! S'ecja mbi këmbët e mia. Vetëm shtrëngimi i dorës së nënë Bekos më përmentte ku isha. Na rrethuan fshatarët, ndofta të afërm të nënë Bekos, dhe na futën në një shtëpi. Lufta vazhdonte. Unë kisha dalë në dritare dhe përgjoja. Po shtëpia ku luftohej s'dukej. Fshati ishte mbushur me gjermanë dhe ballistë. Sa dëgjoja maliherin e Besarit dhe automatikun e plakut, kjo tregonte se ata ishin gjallë. Dikush tha se dy gjermanë kishin hipur nga muri i pasmë mbi çati për t'i qëlluar nga sipër, po që të dy gjermanët ishin rrokullisur të vdekur. Mezi e mbaja veten. Kisha një bombë italiane dhe naganin shtatësh. Të shkoja t'ua hidhja, t'i qëlloja dhe unë, sa të vritesha. Nuk e kisha menduar veten në çast kaq të vështirë. Këto mendime të miat sikur m'i merrte vesh dhe nënë Bekoja.

Ajo më rrinte pranë dhe më thoshte:

— Bija e nënës! Më vështirë e kemi ne, ata nuk vdesin pa e marrë hakun.

Shkoi dhe dreka e shtëpia s'po epej. Maliheri dhe automatiku rrallë, po qëllonin. Njerëzit e

ndiqnin këtë dyluftim të pabarabartë me ankth, po më një ndjenjë krenarie. Dikush tha: Në fshatin tonë u ngrit një kala. Dhe ndaj të varur të diellit të ftohtë të janarit mbi shtëpi u ngritën flakët.

— Po e djegin, — tha dikush.

Ne dolëm të gjithë në oborrin e shtëpisë së vogël. Krismat vazhduan dhe për një kohë, pastaj pushuan, ndërsa flakët ngriheshin më lart.

— Hyni brenda, — tha nënë Bekoja dhe mua më vuri përpara.

Në dhomë, rreth nënë Bekos u mblodhën gra të veshura me të zeza, secila prej tyre përshëndoshej me nënë Bekon, pastaj me mua, me Räsimenë.

Një grua e moshuar nisi vajin, e pasuan dhe të tjerat. Vinin gjithnjë gra të veshura me të zeza, uleshin dhe secila qante me ligje. Ishte një kor i vërtetë vaji që mbushte krejt dhomën. Mbi shamitë e tyre të zeza, të rëna mbi vetulla, duke sikur qenë ulur dhembja dhe urrejtja dhe merrnin zërin e secilës. Mua më rridhnin lotët në heshtje. Në ndryshim nga ato gra, lotëve të mi u mungonte goja, ishin memecë e ndofta kjo më bënte që të ndieja një gulç në kraharor. Vajet e grave nisën të rralloheshin. Erdhi një çast që zëri i nënë Bekos, që herë ngrihej e herë ulej, diku i mbushur me ngashërime, diku i kthjellët si një këngë, zotëroi në të gjithë dhomën. Përse e kishin lënë të vajtonte kështu e vetme? Tani dhe heshtja ishte tepër solemne, dhe ky vajtim ishte më tepër se një përmortje. Çdo fjalë përshkonte veshët dhe zemrat tona me një peshë të veçantë. Pse e kishin lënë të vajtonte kështu e vetme? — mendova përsëri. Mos thoshte amanetet e fundit të të rënëve në këtë vaj? Mua më ishin shterrur lotët. Gjatë këtyre pesë ditëve më

kishte takuar t'i provoja disa herë. Po tani nuk mund të qaja, as ajo s'qante. Jo. Ky s'mund të ishte vaj, megjithëse kishte brenda dhe lotin e nxehtë. Çdo fjalë e saj ishte një kujtesë që nuk e njuh harrimin.

Me siguri që dëgjohej deri jashtë në oborr, ku qëndronin njerëz në këmbë e mbanin vesh. Dhe ajo e vazhdonte vajin:

*Mirë e bëtë, zoti ynë,  
n'istikam kthyet shtëpinë,  
djem, o derëzeza,  
zot, o zot, e zeza!  
Fshatin na e trimëruat,  
u dogjët e s'u dorëzuat,  
djem, o derëzeza,  
zot, o zot, e zeza!*

Ky ishte vaj apo këngë?! S'mund të vija dot kufi midis tyre. Më dukej se ishin të dyja: edhe vaj, edhe këngë. Ishte vaj që të rrëqethte shtatin, ishte edhe këngë për trimat, dhe më frikacakut i jepte zemrën që s'e kishte. Mua sikur m'u largua ai ngërçi që më ishte mbledhur në kraharor dhe s'më linte të merrja frymë lirisht. Ajo i thoshte të gjitha. Kishin vrarë Fatmirin, Besarin dhe plakun Bato, po s'mund të vrisni dot këtë këngë që nënë Bekoja ia linte Luftëtarit, Luftëtari ua linte të tjerëve dhe kështu jeta s'do të kishte kurrë fund.

— Më bini djalin! — tha plaka, kur në dhomë kishte rënë heshtja.

Rasimeja i solli fëmijën të lidhur në pelena. Plaka e mori dhe ashtu të lidhur e vuri në prehër, me kokën të mbështetur lart, që mund ta shihnin të gjithë.

— Ky është Luftëtari, — tha si për një njeri

që tanimë emrin e tij e njihnin dhe e kishin dëgjuar të gjithë.

Gjithë sytë e grave ishin drejtuar te fëmija që plaka e mbante në pëqinjtë e rreshkur si një dëshmi se ne ishim më të fortë se gjermanët e ballistët që kishin mbushur fshatin e nuk mund ta merrnin me mend se partizani më i ri i Shqipërisë ishte këtu midis tyre, te kjo shtëpi, dhe ata as mund ta zbulonin dot dhe as mund t'ia zhduknin rrënjët kurrë. Ai ishte te të gjitha këto nëna veshur me të zeza.

— Të na rrojë e të na bëhet trim! — u dëgjua një zë.

— Ata që luftuan e u dogjën mes flakëve, — tha nënë Bekoja, — nuk na lanë pas vetëm krismat e hirin, po dhe shumë amanete. — Hasmi, që na ka zënë vendin, s'dihet sa do të rrijë, — tha plaka. — Vetë, e dimë që s'ikën.

Fëmija picërronte sytë, dy sy të kaltër si dy drita të vogla me një shkëlqim të thellë e të gjallë, të ndezur nga zjarri i pashuar i jetës. Dikush kërkoi ta merrte fëmijën në duar. Ajo ishte një grua e re.

— Do t'i japim gji me radhë, — tha ajo.

— Ka gji Rasimeja, — u dëgjua zëri i nënë Bekos.

— Do t'i jap edhe unë...

— Ashtu u bëftë! — tha nënë Bekoja. — Ky fëmijë duhet të kalojë gjithë pragjet tona dhe të pijë gji nga të gjitha nënat. Kështu do të rritet më shpejt, se ka shumë hak për të marrë.

Tani ajo dhomë sikur ishte çliruar nga ngjyra e zezë e veshjeve karakteristike që mbanin ato gra të mbledhura njëra pranë tjetrës. Vaji ishte harruar e dukej sikur i takonte një ngjarjeje tepër të largët. Gratë filluan ta kalonin fëmijën dorë më dorë. Kur më erdhi radha

mua, e mora me duart që më dridheshin, sikur ta mbaja për herë të parë. Pesha e tij m'u duk më e rëndë se në ato katër ditë udhëtimi mes rreziqesh të pandërprera.

— Mirupafshim në liri, Luftëtar!

Në zërin tim ndihej tronditja.

U dëgjua një zë që po qante. Nënë Bekoja e mori djalin, e vuri përsëri në prehër dhe tha:

— Them, vaj të mos ketë më! Kur ke hasmin në prag, s'ke kohë të qash. Nesër në mëngjes këtë vajzë s'do ta nisim vetëm. Tani të ndahemi secila nëpër shtëpi, të përgatitim djemtë e vajzat, se na i kërkon mali. Radhët e atyre që bien nuk i kemi lënë kurrë bosh.

I vështroja flokët e thinjur që i dilnin jashtë shamisë, ballin plot rrudha si të gdhendur me daltë si të një statuje madhështore.

I hodha duart në qafë dhe për një çast qëndrova në kraharorin e saj pa marrë frymë, si e mbështetur mbi një copë truall ku i ndien të gjitha: dhembjen dhe qëndresën e tokës nga kishte mbirë dhe ishte rritur kjo nënë. Mbase ajo ishte sinonimi i saj.

Ishim nisur katër dhe kishim mbetur dy. Po këtu midis këtyre njerzëve nuk e ndienim veten të pakësuar. Na ngjante se të rënë nuk mungonin.

Vërtet vdekja diçka na kishte rrëmbyer, po s'na kishte ndarë dot prej tyre. Unë e ndieja se ishin këtu, në këtë dhomë, Fatmiri, Besari, plaku Bato. Prania e tyre shfaqej në shumë mënyra, po dëshmia më e fortë për këtë ishte ajo foshnjë që mbante nënë Bekoja. Ai ishte shumëfishimi i atyre që binin.

Me këto mendime prita të nesërmen, e sigurt se nuk do të nisesha e vetme.

1983

## Partizani në shtëpi

Ai kishte ecur ngadalë që të arrinte në fshat sa më vonë. Qëndroi te Guri i Lotit dhe pa peizazhin e mjegulluar të fshatit të tij, që kridhej në të mugëtit e mbremjes që sapo kishte rënë. Ja tek ishte ai, atje poshtë në fushën e vogël, mes maleve. Gjithçka dukej e turbullt. Përreth malet, qenë mbuluar me dëborë që e shkundnin terrin nga supet e bardha dhe e lëshonin poshtë në luginë. Ai kishte udhëtuar gjatë gjithë ditës nën retë që kishin veshur qiellin si një shtresë e murrme metalike e palëvizshme. Bënte ftohtë. Ndjeu thëllimin e natës së janarit, megjithëse erë nuk frynte. E dinte se në net të tilla pritet të bjerë dëborë. Me një qetësi të pabesë, nga qielli lëshohen mijëra flokë të bardhë që tinëzisht bien mbi tokën e ngrirë dhe mbi çatitë e shtëpive, pa u ndier, duke ngritur befasisht një rrethim të bardhë nga të gjitha anët. Errësira që dëndësuar dhe më, dhe ai tani s'ishihte asgjë përpara, po kishte përfytyrimin e saktë të gjithçkaje. Poshtë tij zbriste rruga plot dredha, pastaj ecte fushës së vogël, kalonte një përrua, bënte dhe disa gjarpërime dhe të çonte drejt e në hyrje të fshatit. Vendet përreth i njihte aq mirë, sa s'mund t'ia fshihte dot as nata e zezë që kishte rënë dhe ai mund ta bënte atë copë

rrugë edhe symbyllur. Kur kaloi përroin, preu nga e djathta duke ecur arave të mbjella me grurë. Toka ishte e ngrirë dhe dëgjonte grupet e këpucëve të tij ushtarake. Gjeti shtigjet e arave, kaloi disa ledhe që të zotët i kishin bërë për të mbajtur tokën dhe u ndodh mbi fshat. Tani eci vijës së ujit që kalonte gjatë gjithë rrëzës së malit dhe dilte tej në fushë. Ajo ishte pa ujë dhe vende-vende e mbushur nga dheu dhe nga gurë të rrëzuar. Ai ndjeu praninë e tij me një drithërimë malli dhe kraharori iu mbush me ajrin e athët dhe të ftohtë të vendlindjes. Dëgjoheshin zëra dhe të lehura qensh. Dritat vezullonin në terrin e natës, të vogla, të mekura pas kanateve të dritareve. Aty diku, në mes të fshatit, ai kishte shtëpinë e vet. Zbriti poshtë, hyri në një rrugicë dhe tani po ecte sokakëve. Ndonjë qen i lëshuar egërsohej brenda avllive të rrethuara me mure duke e shoqëruar me të lehura. U gjend te shtegu i shtëpisë dhe ndjeu t'i rrihte zemra fort. Qeni lehu që nga hajati. Ende s'e kishin lëshuar. Ai e dinte se atë e lëshonte babai vonë, kur binte për të fjetur. Ngjiti një palë shkallë të gurta dhe shtyu derën. Njerëzit, që ishin ulur pranë zjarrit, rreth vatrës, u ngritën. Dikush lëshoi një klithmë gëzimi dhe habie dhe ai u ndodh midis tyre. Ndjeu ta pushtonin krahët e nënës, të puthurën e saj, shtrëngimin e dorës së babait dhe sytë plot ndriçim të motrave dhe vëllezërve të vegjël që i hidheshin njëri pas tjetrit në qafë. Mendohej t'i hetonte të gjitha në gjysmëmugëtirën e dhomës së ndriçuar vetëm nga zjarri. Nëna vuri dhe një kërcu tjetër në oxhak, gjysmerrësira u ndeh edhe më tepër, po një gjuhë flake u ngjit duke brambulluar.

— Ndizna kandilin, — u dëgjua zëri i të atit.

Që nga oxhaku kandili i ndoqi hijet e natës nga muret e shtëpisë. E ëma e goditi kërcurin e thatë me mashë. Shpërtheu një tufë shkëndijash dhe nga të dyja anët kërcurin filluan ta lëpinin gjuhët e flakëve të kuqe. Një poçe ishte vënë në zjarr. Vala ia ngrinte kapakun dhe në dhomë përhapej era e groshëve.

— Afrohu, mos mërdhin. Merr hidh këtë shark krahëve se je djersitur nga rruga, — u dëgjua zëri i nënës, që nuk e mbante vendi.

— Kur je nisur nga çeta? — e pyeti i ati.

— Me të marrë letrën.

E ëma kishte vënë tiganin dhe po skuqte miellin për lëngun e groshëve. Ajo po përgatiste darkën, me gjithë ato ecejake nëpër shtëpi, pa të cilat nikoqiret s'i mendon dot kurrë. Pastaj skuqi vezë. I biri vuri re se nëna këtë herë nuk i gatoi me miell, siç bënte zakonisht, që gjella të shtohet e t'u dilte të nëntë frymëve. Mbi mollëzat e faqeve të saj binin reflekset e flakëve dhe ia bënë më të kuqe se ç'i kishte në të vërtetë, një të kuq të panatyrshëm, plot rremba, që disa njerëz e kanë vetiu. Ajo ishte nëna e tij pesëdhjetëvjeçare, që varfëria, hallet dhe sëmundja e tregonin shumë më të madhe.

— Unë pandehja se do të të gjeja shtrirë në rroba, — i tha partizani së ëmës.

— Kam qenë dhe ca e sëmurë, jo aq rëndë, sa ç'të shkruante yt atë, po ti e di se nëna jote dy ditë bjer dhe një ditë ngrehu, kështu e ka shkuar gjithë jetën e saj.

— Kanë shkuar kohë e duhej të vije, — ndërhyri i ati.

Vetëm tani e kuptoi se ajo letra që kishin dërguar në çetë me atë partizanin prej fshatit



të tyre, duhej të mos kishte shkakun e vërtetë. Ndoshta prindërit i kishte marrë thjesht malli. Edhe atë e kishte marrë malli: për nënën, motrat dhe vëllezërit, për të atin, për të afërmit, për mushkën Murrë, për avllinë dhe bahçen me mollë, për shokët, për sokakët e shtëpitë e gurta. Ai ishte nisur me një ankth të madh në zemër dhe tani, që ndodhej midis njerëzve të tij, ende s'çlirohej dot nga ai ankth që ishte lidhur dhe me plot ngjarje të papritura gjatë ditëve të udhëtimit. Kapërdihej dhe mendohej ta fshihte shqetësimin, sepse fytyra e tij ishte nën vështrimin e të gjithëve. Megjithatë mendoi se si mund t'i dërgonin një letër të tillë vetëm se i kishte marrë malli. Jo, jo. Një shkak tjetër, shumë i madh duhej të kishte qenë.

— Kaq e domosdoshme ishte ardhja ime? —  
tha sikur të ishte penduar që kishte ardhur.

— Doemos e domosdoshme!

Në këto fjalë të babait partizani besoi se një shkak i rëndësishëm duhej t'i kishte detyruar t'i shkruanin në atë mënyrë alarmuese në letër.

Mendja filloi t'i punonte për të gjetur se cili mund të qe ky shkak. Ta kërkonin për të mbjellë arat? Po tani ishte janar. Po pse i kishte shkuar mendja tek arat, kur tani s'ishte as koha e të mbjellave dhe as e të korrave? Partizani hodhi përsëri sytë e tij hetues, sikur ajo që kërkonte ai të ishte fshehur këtu, midis këtyre njerëzve që e kishin rrethuar me mall e dashuri. I ati shkundi çibukun mbi truallin e vatrës. Të goditurat ritmike të tij u shoqëruan nga të kolliturat e herëpashershme.

— Mos ke qenë ti i sëmurë, baba? — pyeti i biri.

— Jo, o bir, asnjë nuk ka qenë i sëmurë.

Po tani ne u plakëm dhe pleqëria është sëmundje.

Partizanit i shkuan të rrëqethura në trup. Ai ndjeu të ftohtë nga shpatullat dhe mori mashën e goditi kërcurin që digjej mes flakëve. Ditën që kishte dalë partizan, kishte ikur pa fjalën e të atit. Ai ishte djali më i madh në shtatë fëmijët. Kishte pasur dhe dy të tjerë përpara vetes. Ata kishin vdekur njëri pas tjetrit, pastaj kishte lindur ai. Tri ditë pas lindjes e kishin mbështjellë në shpërgënj të leshtë dhe e kishin nxjerrë në kryqëzimin e rrugëve të fshatit. Ai që e takoi i pari, u bë kumbar i shtëpisë. Emrin ia vunë Spiro, që ta kishte jetën të gjatë. Lehona kishte marrë të ftohtë dhe askush s'e besoi se do të shpëtonte.

Po në të shtatin vit lindi fëmija e dytë dhe pasuan dhe pesë të tjerë. Spiroja filloi një burrëri të hershme. E ëma përkundte djepe njerën pas tjetrës, i ati i vari shpresat te shpatullat e tij e të mushkës për të mëkëmbur fëmijët, ndërsa Spiron priste ta bënte krahun e tij të fortë. E futi çoban dhe fëmija që në moshën 11-vjeçare shijoi bukën e hidhur të hyzmeqarit. Kur u përhap Lëvizja në fshat, Spiroja u fut në grupet e rinisë. I ati që gjithmonë mysafir në shtëpi. Qiraxhiu e ka shtëpinë mbi samarin e mushkës. Po fjala i kishte ardhur, se fjala fluturon si era. I pari i kishte folur agai i fshatit. Unë e di se të kam bërë mirë, i kishte thënë. Djali yt ka rrezik të mbetet udhëve. Ai i dinte ato që zhvilloheshin në fshatin e tij, në fshatrat përreth dhe në qytetin e vogël të krahinës, ku i takonte të shkonte përherë. Por atij i dukej sikur s'do të kishte kurrë kohë në jetën e vet të merrej me të tillë punë. Rinia do ndryshonte jetën. Po të bëhej ashtu, aq më

mirë për të. Ai i varfër ishte dhe s'kishte ç'të humbiste. Po, gjersa të vinin ato kohë që thuheshin, fëmija duheshin ushqyer, ata nuk mund ta prisnin atë kohë me gojë të mbyllura. Dhe këto gojë i ushqente vetëm ai. Nga arat zallishta, dhe në të korrat më të mbara, nuk merrte as dy muaj bukë. Njëherë i kish takuar të mbarte në mushkë një partizan të plagosur. Në fillim nuk i kishin treguar asgjë. Një të sëmurë do ta çonin në qytet. Ai ishte i hequr në fytyrë, me xhakëtë ushtarake, me pantallona shajaku, hedhur supeve një shark të zi. Kur e hipën në mushkë, qiraxhiu i dalloi fashat që i kryqoheshin në kraharor e i shkonin pas shpatullave, ku duhej të kishte një plagë. Plaga duhej të ishte e rëndë, se ai dëgjoi të kërcitурën e dhëmbëve kur qëndronte mbi samarin e mushkës.

— Ti je yni, — i kishin thënë të dy burrat që e shoqëronin. — Nga ti nuk na del fjala.

Ishte llogaritur që në qytetin e vogël të arrinin natën. Qe një natë dimri pa hënë dhe ata dy burrat po i tregonin se nga duhej të shkonin në një nga lagjet e jashtme në krye të qytetit, andej nga fillonin të ngriheshin malet. Qëndruan para një shtëpie disi të veçuar nga të tjerat. Kur zbritën të plagosurin, njëri nga të dy burrat nxori portofolin dhe i tha:

— Sa të bën haka?

Nuk e kishin bërë pazarin më parë. Të dy burrat i kërkuan t'ua çonte të sëmurin me çdo kusht nga rruga që kërkonin ata dhe të niseshin në një kohë që do t'u shmangeshin takimeve me udhëtarët. Këtë të fundit ata nuk ia thanë, po qiraxhiu e kuptoi se ata do ta bënin rrugën natën e do të dilnin vetëm një herë në xhade dhe përsëri do të ndiqnin një rru-

gë këmbësore. Në fillim ai ndjeu rrezikun e këtij udhëtimiti, po sa më rreziqe të kishte udhëtimiti, aq më shtrenjtë paguhej. Qiraxhiut nuk i pëlqejnë kurrë rrugët e shkurtra. Udhëtimet ditën, natën, të fjeturit rrugës, shtigjet e ngushta, të përpjetat e rrezikshme, kalimi i lumenjve në stinë të ndryshme të vitit, të ecurit mbi ura gjysmë të prishura, këto janë pjesë e jetës së tyre në lëvizje të përhershme. Po ky udhëtim kishte një rrezik të një lloji tjetër. Për të rreziku i udhëtimeve ishte një instinkt i fituar gjatë zanatit të tij të gjatë dhe ajo frika që i lindi në fillim i kaloi. Në të vërtetë ai ishte futur në rrezikun e atyre të treve. Dëgjoi ta thërritnin të plagosurin «shok». Kjo tregonte se ata nuk ishin farefisi i tij. Fjala «shok», që kishte ekzistuar në shekuj, sa kishte qenë njeriu, tani kishte marrë një kuptim të ri.

— Hakën, shok, — përsëriti burri me portofol në dorë, kur pa ngurrimin e tjetrit.

— S'bën asgjë, — foli qiraxhiu.

Kjo ishte e para herë që ai s'kërkonte të merrte shpërblimin e udhëtimit. Nuk e kuptoi, këtë vendim e kishte marrë që gjatë rrugës, apo i lindi befasi tani që po rregullonte samarin e mushkës gati për t'u nisur.

— Ti na bëre një shërbim të madh, shok! Ke një vatër me fëmijë, — dhe burri i futi një kartëmonedhë në xhepin e palltos prej shajaku.

Qiraxhiu mbeti pa lëvizur.

— Vdekje fashizmit! — dëgjoi zërin e burrit në errësirë, që kishte mbetur vetëm me qiraxhiun, se ai tjetri me të plagosurin ishin futur brenda.

Tërhoqi mushkën prej kapistre dhe pas dë-

gjonte trokun e potkonjve të saj. Nuk guxoi të shikonte sa lekëshe ishte ajo kartëmonedha që i kishte futur i panjohuri në xhepin e palltos. Ecte dhe filloi të sillte ndër mend fytyrat e tre të panjohurve, rrugën që kishin përshkuar, fjalët e pakta që kishin shkëmbyer. Ata duhej ta njihnin, në mos shumë, doemos duhej të dinin diçka për të. Mund t'ia kishte thënë dhe Idrizi, që e kishte njoftuar i pari dhe që merrej me ata të këshillave nacionalçlirimtare. Së pari, i kishin dhënë besë, së dyti, e kishin quajtur «yni» dhe së treti, dinin dhe hallet e tij që ishte babai i shumë fëmijëve. Kur po hynte në fshat, takoi aganë që i tha në rrugë ato fjalët për të birin. E thirri dhe e qortoi të birin, por ai vuri re se nuk i kishte aq peshë fjala, si dikur. Për herë të parë ndjeu se me të birin duhej të fliste si me një ortak që do ta çanin jetën krah për krah së bashku. Ai do të ishte në këto ortakëri, këtej e tutje, krahu më i fortë. Tek ai ish in gjithë shpresat për të mbajtur një familje prej 9 vetash. Shtatë gojë prisnin vetëm të hanin, bile dhe ai vetë, që po u afrohej të gjashtëdhjetave. I biri, pra, duhej të luftonte me jetën, jo më për veten, po për të tjerët. I ati kishte ndër mend t'ia jepte atij mushkën Murrë, të paktën pas një viti, kur ai të mbushte shtatëmbëdhjetë vjeç. Për një qiraxhi kjo moshë është ende e papjekur. Kokalla është e njomë për të ngjitur e zbritur barrët e rënda nga samari i kafshës, për të rrahur rrugët e njohura dhe të panjohura, për të tërhequr myshterinjtë e paktë. Në fillim do ta merrte me vete ca kohë, siç kishte bërë disa herë, për t'i mësuar të fshehtat e zanatit. Po jo që tani. Ai ishte keq dhe s'donte ta shkëpuste nga agai, të paktën dhe një vit, sa të lante disa borxhe. Ai

e dinte nga përvoja e tij se laku i të birit do fillonte të çlirohej pak nga pak, kur të rrite-shin vëllezërit e tjerë. Ata ishin katër. Do të rritnin njëri-tjetrin. Ai s'do të kishte mundësi mbase t'i ndiqte të gjithë, kur t'i vinin supet me radhë asaj barre të rëndë që quhet jetë, se më i vogli s'ishte as gjashtë vjeç. Por e dinte se kështu do të ndodhte patjetër, siç e kishte parë ai gjatë jetës së tij te të gjitha familjet e të varfërve. Pastaj do të ndaheshin secili në hall të vet dhe secili do të fillonte përsëri nga e para. Po kur i ati mendoi se gjithçka kishte marrë fund, i biri pas një heshtjeje të gjatë ngriti kokën dhe me një ton të qetë tha:

— Baba nuk mund të ndahem nga shokët.

I ati hasi vështrimin e qetë e të sigurt të të birit dhe e kuptoi se kishte humbur atë që kërkonte. Përsëri ajo fjala e çuditshme «shok» që kishte dëgjuar nga ata të tre duke udhëtuar me të plagosurit, dhe ajo e kishte lidhur edhe të birin në një mënyrë të pazgjdhshme. E kuptoi se i biri nuk do të ndahej nga shokët. Gjer ku mund të arrinin veprimet e tij? Këtë nuk e dinte. Por dinte se ende s'mund t'ia dorëzonte askujt bishtin e kapistrës së mushkës gjersa t'i kishin fuqi muskujt e duarve dhe të këmbëve. Dhe vërtet, një ditë në fshat u hap lajmi se i biri kishte lënë në brinjë kopenë e agait dhe kishte dalë partizan. Që atëherë i biri kishte fjetur një natë në shtëpi, po të atin nuk e kishte gjetur aty dhe ja tani ishte takimi i parë që kur kishte dalë në mal. Dhe ishin atë e bir ballë për ballë, në dy qoshet e konakut.

Në vatër kërcurin e kishin mbuluar flakët dhe luhatjet e tyre lëviznin në muret përballë.

Tani dhoma ndriçohej më shumë dhe partizani u hodhi një sy të vëmendshëm të gjithë atyre që qëndronin rreth vatrës. Sytë i mbetën tek i ati. Kishte ndezur çibukun, këmbëkryq rreth zjarrit, me sytë e mbërthyer mbi prushin e kuq që kishte hapur me mashë para vetes. Po, mendoi partizani, letra ishte një kurth. Askush nuk ishte i sëmurë, siç i kishin shkruar. Babai dukej i ligështuar dhe më shumë nga mendimet, se ai halle kishte pasur gjithmonë. Nesër, mendoi partizani, do të nxjerrë mushkën Murrë nga kasollja dhe do të ma dorëzojë. Merre, do më thotë, kjo ka qenë pasuria ime me të cilën ju kam rritur. Këtë të lë trashëgim edhe ty. Tani s'më punojnë as duart, as këmbët. Ti je më i madhi. Vendos vetë si do të bësh. Po të duash, merre edhe mushkën në çetë, dhe nënën, dhe vëllezërit, dhe motrat. Vetëm unë s'vij dot, jam plak e më kanë ligështuar udhët dhe barrët. Ose mbyllua derën që nga jashtë të vdesin në mëshirë të fatit. Rrugë tjetër s'ka! Ti, kur more vendimin për të ikur në çetë, duhej të kishe menduar dhe për ata që le pas. Ja pse të kam thirrur! Kjo nuk i kishte vajtur në mend gjer para pak çastesh. Po ta kishte ditur, nuk do të kishte ardhur. Po a nuk ishte njëlloj? Ai tani ishte burrë dhe askush nuk mund ta mbannte me zor. Kur kishte ikur, e dinte se kishte lënë një baba në moshë të thyer, një nënë që s'qe e zonja të kalonte pragun e shtëpisë, gjashtë gojë vetëm për bukë dhe mushkën Murrë. Atje në çetë, sa herë kishin rënë në biseda për shtëpitë që kishin lënë, komisari u thoshte se këtë luftë e bëjnë të varfrit për të varfrit. Kjo ishte lufta e fundit. Një partizan nga fshatrat e Kurveleshit, kur binin në biseda për

familjet, tregonte se kishte lënë pas shtatë fëmijë të vegjël dhe gruan. Kurse ai kishte dhe një burrë në shtëpi, babanë. A i dinte babai të gjitha këto? Por i ati i kishte dërguar në çetë një letër me një lajm të hidhur, e kishte prurë gjer në shtëpi dhe tani donte ta lidhte pas samarit të mushkës me të dyja anët e litarit të saj të fortë.

— Gjithë ata që kanë ardhur në çetë, janë të varfër, baba, — tha papritur partizani, sikur ta kishte pyetur njeri.

Plaku thithi çibukun dhe ngriti sytë.

— Doemos të varfër! Të pasurit nuk e lënë mallin e gjënë e të marrin malet.

Djali nga kjo përgjigje e ndjeu veten të lehtësuar, shikoi vëllanë e vogël që i rrinte pranë dhe i përkëdheli flokët i mallëngjyer.

— Ti je tretur shumë, bir, — i tha nëna me një vështrim hetues.

— Shtroju fëmijëve të flenë, djali është lodhur nga rruga, — tha i shoqi.

Ajo u ngrit dhe u shtroi fëmijëve në fund të shtëpisë. Pesë fëmijë flinin rresht njëri pas tjetrit. Djali i vogël flinte me nënën, ndërsa i shoqi flinte në konakun tjetër. Në net të ftohta ai flinte në qoshen përballë. Si vuri në gjumë fëmijët, shkoi në dhomën tjetër për t'i shtruar të shoqit dhe të birit. I ati e pyeti për djemtë e fshatit që ishin në një çetë me të. Pastaj erdhi fjala te Sefedini. Ai kishte qenë në çetë dhe kishte ikur. I biri i tha se nuk donte të fliste për të. Ai ishte dezertor. Çeta e kërkonte dhe, po ta kapte, do ta pushkatonte menjëherë si tradhtar.

— Mbase e shtyu halli, — tha i ati. — Ai ka vajtur çoban tek agai, në vendin tënd.

— Lufta që bëjmë është halli më i madh, —



tha i biri dhe i pëlqeu që ishte hapur një bisedë e tillë, se ai në këtë mënyrë mendoj se po i përgjigjej të atit për veten.

Por i ati nuk foli më. Thithi përsëri çibukun dhe vështroi të birin përmes fjollave të tymit. Thellë në shpirt ndjeu një kënaqësi që mund t'ia dalloje vetëm nga sytë. I biri dinte t'i jepte udhë muhabetit më shumë se për moshën që kishte. Po partizani e mori për krejt ndryshe këtë heshtje. Ai priste nga çasti në çast ato fjalët e rënda sa trarët e shtëpisë që u qëndronte mbi krye, duke i shpjeguar shkakun pse e kishte thirrur. Erdhi e ëma. Ajo kishte në dorë një këmishë, një fanellë leshi, pantallona shajaku, të gjithë të të shoqit. Në zjarrziente një kusi me ujë për të larë të birin. Ai shkoi dhe u ndërrua në dhomën tjetër. Kur u kthye, burrë e grua vunë re se pulpën e këmbës se majtë e kishte lidhur me një rrip këmishë që në pjesën më të madhe kishte marrë ngjyrën e kuqë të errët të gjakut të ngrirë. E ëma lëshoi një klithmë kurse i ati iu qas pranë.

— Plagë plumbi?

— Po.

— Qenka e re!

Kur vuri re se e ëma po qante, ai u mundua ta qetësonte. S'ishte veçse një plagë e lehtë. I ati ia kishte zgjidhur, po leckë s'hiqej nga gjaku i ngrirë. I kërkoi së shoqes pak ujë të ngrohtë dhe ia njomi dalëngadalë, derisa ia hoqi.

— Korba unë! Dhe neve na u mbyllën sytë e s'e pamë!

Në të vërtetë partizani e kishte fshehur me kujdes këmbën e plagosur për të mos ia diktuar.

— Një leckë të pastër dhe kutinë e duhanit! — thirri burri.

I ati i kontrolloi kërcirin e këmbës.

— Të dhemb? — e pyeti.

— Jo, plumbi më ka marrë në mish.

Ai kishte afruar kandilin te plaga dhe e shtypte lehtë me dorë mishin anës saj për të parë se gjer ku e kishte dëmtuar. Përqark kishte mbetur gjak i ngrirë i mavijosur.

— Ta djegim.

— Me se?

— Më bjer shishen e rakisë. Lëri të qarat!  
— i bërtiti së shoqes që derdhte lot në hesh-tje me një fytyrë të pikëlluar.

Ja lau plagën nga të gjitha anët, ia dogji me raki, pastaj ia lidhi, duke i vënë duhan të grirë.

— Të piqet, — tha plaku gati me vete, duke lënë të nënkuptohej se kishte mbaruar.

Partizani lëshoi këmbëzën e pantallonave prej shajaku me vriga e pulla anash dhe e la të zbërthyer, i ati shkoi e u ul te qoshja e tij pranë oxhakut, mbushi çibukun me duhan, mori një thëngjill nga vatra me gishtërinjtë e trashë, e hodhi në pëllëmbën e dorës e që andej në çibuk.

E ëma kishte sjellë magjen në fund të dhomës dhe mbushi ibrikun me ujë të nxehtë për ta larë. Asaj i kishin mbetur sytë te plaga e të birit dhe fytyrës së saj nuk i kishte kaluar ende tronditja. Te vatra u ul pranë tij dhe me përgjërim e dhembje e pyeti:

— Të dhemb?

— Fare pak, vetëm kur eci.

— Duket e re, kur e ke marrë?

— Gjatë rrugës.

— Me kë ke rënë në përpjekje?

— Me Dak Gulashin!

— Me Dak Gulashin? Ç'të shpuri te Dak Gulashi?! — dhe me këtë pyetje shprehej më tepër habia.

— Letra më gjeti në Malet me Gropa dhe unë, për t'i rënë sa më shkurt, kalova nga Qafa e Burgajetit dhe dola në Guras.

— S'e dije që Dak Gulashi ka tradhtuar e ka marrë më qafë gjithë farefisën?

— Dija që Dak Gulashi ishte mik i vjetër i xhaxhit dhe i shtëpisë sonë, simpatizant i Luftës Nacionalçlirimtare.

— Që kur tradhtoi Lëvizjen, as xhaxhai nuk e qas.

— Të thashë, të mos ia ngrije ashtu mendjen djalit me atë të shkretë letër! Në vend të nuses na solle mandatën në shtëpi. Korba unë!

E ëma jetonte me këtë ngjarje sikur ende të mos kishte mbaruar fundi i saj, ndërsa i biri dëgjoi në atë përgjërime të dhembshëm fjalën «nuse». Për ç'nuse e kishte fjalën nëna? Ai kishte dalë në mal për të luftuar dhe jo për nuse. Mos e kishin fejuar?

Partizani mprehu veshin dhe syrin, por askush nuk kaloi më tej se fjalët e nënës dhe ai vetë nuk pati guximin të pyeste. Ia hodhi sytë të atit. Ai thithte çibukun pa ua vënë veshin fjalëve të së shoqes. Ishte natyra e tij që e priste me të njëjtën qetësi si lajmin më të gëzuar dhe lajmin më të hidhur. Ndofta gjithë shqetësimi i tij shprehej te çibuku, që s'e hiqte kurrë nga goja, duke i humbur shpeshherë fytyra pas fjollave të tymit. Çibuku ishte oxhaku i zjarrit të tij të brendshëm që digjej vazhdimisht.

— Më bjer pak duhan për të grirë, — iu drejtua së shoqes. — Zgjidh nga ajo fleta e mirë.

Gruaja u ngrit me fytyrë të trishtuar dhe shkoi nga dhoma tjetër.

I biri vetëm tani e kuptoi përse i ati e largoi të shoqen dhe ia nguli sytë. Po sytë e të atit u ulën. Ishte hera e parë që ai po ulte sytë para të birit dhe s'po e kapte dot bisedën, hallin pse e kishte thirrur, pse ia kishte shkruar atë letër.

Ai priste të fliste babai.

— Po plagën si e more, kush të qëlloi?

Spiroja e ndjeu se i ati e kapërceu bisedën. S'deshi të niste me të sherr, s'deshi t'ia prishte së paku mallin që të dy e kishin në shpirt e në sy dhe nisi të fliste gjatë, shtruar, si për t'i thënë të atit ta mendonte më mirë shkaku për të cilin e kishte thirrur.

— Nuk ma merrte mendja kurrë që komandanti me komisarin të më thërrisnin veçan. Në fillim më pyetën nëse kisha marrë ndonjë lajm nga njerëzit e shtëpisë e pastaj më treguan se më kishte ardhur një letër.

— Ke nënën pak të sëmurë, — tha komisar. — Do të bëje mirë të shkoje.

Mua më shkoi mendja për të keq dhe u trondita.

— E ke të re nënën?

Unë s'flisja dot dhe doja të largohesha sa më shpejt prej tyre, se më vinte turp t'i lëshoja lotët që i ndieja se po më mbushnin sytë.

— Letra thotë se nëna është e sëmurë, — tha përsëri komisar. — Vetëm kaq. Dhe të sëmurët shërohen, kurse ti më duket... — dhe ai më zgjati një pusullë dore e pa i mbaruar ende fjalët shtoi: — Mua më ka vdekur dhe nëna, dhe babai, kurse ti u ligështove përnjëherë për një lajm që more.

— Është larg fshati yt që këtej? — pyeti komandanti.

— Të ikësh mirë, një ditë më këmbë, — iu përgjigja.

— Do të të japim dhe një partizan me vete?

— Faleminderit, shkoj dhe vetëm, se e njoh vendin.

— Megjithatë duhet pasur kujdes nëpër zonat që do të kalosh. Kemi njoftime për kalimin e operacionit armik e larot e Ballit kanë filluar të gjallërohen.

Sa u ndava prej tyre, fillova ta lexoja letrën me një frymë. M'u ngrit mendja. U nisa me mendimin që të paktën të gjeja nënën gjallë, në qoftë se rronte. Shpejtoja që të kaloja me ditë Qafën e Burgajetit dhe natën ta kaloja në Guras. Kështu, të nesërmen në drekë do të arrija në shtëpi. Po moti u egërsua e lloha që filloi të zinte frymën. Qafën e Burgajetit mezi e kalova dhe, po të mos ishte Gurasi më pak se një orë larg, nuk dihet se cili do të ishte filli i jetës sime atë natë.

Në shtëpinë e Dak Gulashit u treguan të përzemërt. Më ndërruan, më dhanë për të ngrënë dhe filluan të më pyesnin se ç'më kishte shtrënguar të udhëtoja në këtë ditë kiameti. U tregova për letrën që më kish ardhur. Ata u hidhëruan për lajmin që u dhashë për nënën. Pastaj Dak Gulashi shtroi sofrën. Në fillim fjalët sikur ngeceshin diku, muhabeti s'lidhej, megjithëse Dak Gulashi herë pas here e hapte bisedën i pari. Unë s'isha mësuar të pija raki.

— Të pimë e të llafosemi, — tha ai, — kemi shumë gjëra për t'i thënë njëri-tjetrit. Janë kohë të turbullta dhe në të tilla kohë i duhet miku mikut.

— Unë s'pi, — i thashë.

— Gjersa ke hedhur pushkën në sup, je burrë. Unë të kam sonte mik të shtëpisë dhe do të bisedoj sonte me ty si burri me burrin, — dhe ai filloi të ngrinte shëndetet me radhë: — Për familjen tonë, për miqësinë tonë të vjetër, për nënën e sëmurë, për mua. — Kur papritur tha: — Ç'do t'i bësh nënës së sëmurë që je nisur me kaq axhale në këto ditë dimri e lufte?!

Mua kjo pyetje m'u duk e çuditshme. Vërtet s'mund t'i bëja ndonjë gjë sëmurdjes së nënës, po si mund të mos vija?! Po Dak Gulashi me atë pyetje donte të dilte diku tjetër.

— Ta them unë pse nëna jote është e sëmurë: s'ka të hajë. Dhe varfëria është sëmurdje. Po ne s'rrimë rehat dhe në këtë varfëri që na ka zënë. Të paktën të mbjellim një arë që kemi, të mjelim një dele e një dhi që na ndodhet.

S'po kuptoja se ku donte të dilte Dak Gulashi me këto fjalë.

— Të varfër jemi të gjithë. Vërtet lufta dhe na djeg, dhe na prish, po ne do të fitojmë dhe do ta bëjmë jetën të lirë, — thashë unë.

Dak Gulashi qeshi dhe picërroi sytë.

— Do të fitojmë? Me kë do të fitojmë? Matet miu me buallin dhe ti thua se do të fitojë miu, ë?! Ta ka prishur mëndjen komisari. Komisarët u bëjnë magji njerëzve, u futin trutë e gomarit në kokë dhe ju bërtitni si të çmendur: do të fitojmë, kurse populli digjet, vritet, vuan!

— Ç'flet kështu Dak Gulashi?! A je ti miu i shtëpisë sonë që i ke dhënë besën Luftës?! Ata që luftojnë për Shqipërinë edhe digjen, edhe vriten! —

— Po mikë i shtëpisë suaj jam dhe mirë që

të solli rruga, që mos të të lë më të vazhdosh në qorrsokakun ku je futur. Atë yll që mban ti në ballë, unë e vura para teje. Po dhe para teje e hoqa. Për mua që një marrëzi plaku dhe që më e rëndë, për ty një marrëzi rinie dhe është më e lehtë.

Mua m'u errësua dhoma dhe fytyra e këtij njeriu m'u pështiros tek e dëgjoja që po nxirrte ato fjalë nga goja.

Por ai vazhdonte të fliste:

— Është fat që ke hyrë në fshat natën, se, po të të kishin parë me atë yllin e kuq, do të të kishin shqyer, kushdo që do të të kishte takuar në rrugë. Ka filluar një operacion i madh, së shpejti pritet edhe në krahinat tona dhe ky dimër do të shkulë nga rrënjët barin e keq që ka mbirë. Dëgjomë mua! Do të të jap dhe një letër të marrësh në qytet ca miell, oriz, makarona, sheqer dhe çoji lart në fshat. Të shikosh si shërohet jot ëmë. Atë yll hiqe, se do të na vësh në bela dhe me komshinjtë.

— Kurrë! — thashë unë dhe pakuptuar kisha qëlluar me grusht mbi sofër. Gotat e rakisë ishin përmbysur.

— Avash, ti, avash, — tha plot mllef, — nuk derdhët kështu kollaj rakia e Dak Gulashit! — dhe mbushi përsëri gotat. — Merre dhe pije! Ilaçi, sa më shumë të të helmojë, aq më shpejt të shëron. Kështu janë dhe fjalët e mia. Nuk jam vetëm unë ai që kam kthyer mendjen. Juve ju përrallisnin atje në çeta komisarët dhe gjithë ato që ju thonë i merrni për të vërteta. Kështu është bërë fshati yt, kështu është bërë e gjithë Shqipëria.

— Nuk është e vërtetë!

— Nga e di ti? Ku e pe ti të vërtetën, ti bredh gur më gur e mal më mal. Bile po më

vjen dhe çudi se si të kanë lënë për nënën, se komunistët s'duan as nënë e as baba, as motër e as vëlla. Ata janë njerëz pa familje. Ç'fat i mirë që erdhe! I ndritte shpirti nënës sate që u bë sebeb me atë sëmundjen. U sëmur për vete, por do të shërojë të birin.

Ai fliste aq, sa mua s'më linte radhë. Ai gati më mbyti me fjalë, i bindur se po më thyente. Unë e kisha kaluar atë tronditjen që vjen gjithmonë kur ndodhesh përpara një të papriture. Po ziejja nga urrejtja dhe doja t'i thosha atij që kisha para se duhej të mos fliste më e as të mos përmendte miqësinë tonë, emrin e nënës sime, aq më pak të bëhej merak për mua. Si ishte e mundur! Si ishte e mundur që një ish-simpatizant i Luftës Nacionalçlirimtare, të ish-kthyer në një armik kaq të egër? Dëgjova tingëllimin e gotës. E kështu afruar fytyrën aq pranë, sa që ndjeva afshin e frymës së tij.

— Ta pimë me fund! — më ftoi përsëri me një lëvizje energjike të të gjithë trupit. — Merrre gotën dhe ktheje, si i ka hije shqiptarit. Unë e mora gotën në dorë. Ai e ktheu me fund dhe priste ta ktheja dhe unë.

— Ktheje! Për nacionalizmin shqiptar! Për Ballin e kombit! — më nxiti përsëri.

— Për fundërrinat e kombit! — bërtita pa e përmbajtur më veten dhe gotën e mbushur me raki, siç e mbaja në dorë, ia hodha në surrat.

Dak Gulashi u ngrit në këmbë si një bishë. U ngrita dhe unë.

— Kujt ia hedh rakinë në fytyrë, ti, spurdhjak! T'i hedh trutë në erë! — tha e hodhi dorën tek revolva e varur në mur.

Edhe unë mora pushkën dhe ia drejtova grykën drejt tij. U dëgjua një ulërimë gruaje.



— Shtjer, Dak Gulashi, në je, burrë!

— Më ke përmbysur trapezën dhe më ke shkelur bukën, mosmirënjohës!

— Të kam shkelur tradhtinë, mik i pabesë!

— Do m'i paguash shtrenjtë këto fjalë!

— Sa të kem këtë në dorë, nuk do të shkojë pabesia jote! Hapma rrugën! Kjo shtëpi qelbet erë tradhti!

I drejtova pushkën që mbaja gati në dorë dhe ai, dyllë i verdhë në fytyrë, u zmbraps. Hapa derën dhe shpejt në oborr, shpejtova të hyja në sokakun e ngushtë dhe po ecja në errësirën pis të zezë të natës. Nuk shikoja asgjë. Binte një shi i imët, i ftohtë. Ndofta në lagjet e sipërme binte dëborë. Kontrollova me dorë fishekët që kisha në gjerdan, pushkës ia kisha hequr siguresën dhe gishtin e mbaja gati në këmbëz të shkrepjes. Doja të shpejtoja sa të dilja jashtë fshatit. Po ecja shumë ngadalë, i penguar nga errësira. Në të dyja anët e sokakut ngriheshin shtëpi, dëgjoheshin të lehura qensh nëpër oborre. Sa të dilja nga fshati, e dija se isha në rrezik. Kushedi se ku mund të më nxirrte ky sokak i verbër. Ngaqë s'ishikoja asgjë, shpesh ia hipja ndonjë muri, pengohesha në ndonjë gur. Më ishte ngulur në tru si një gozhdë fytyra e Dak Gulashit. Ajo fytyrë më bënte ta shtrëngoja pushkën më fort dhe ta shpejtoja hapin sa të ishte e mundur, i bindur se rrezikun e kisha gjithmonë pranë. Papritur para meje u dëgjua një zë:

— Ej, kush je ti atje!?

Nuk iu përgjigja. Ndalova hapat dhe po përgjoja. Nuk dalloja asgjë.

— Përgjigju, kush je ti?! — u dëgjua zëri përsëri.

Hetova vendin. Sokaku ku qëndroja ishte i ngushtë, nga të dy anët me mure dhe gishtin e mbaja në çark të pushkës.

— Po lëvize, do të të qëlloj! — klithi zëri. — Kush je ti?

— Jam një fshatar, — thashë unë për të fituar kohë.

— Thuaj emrin!

— Dak Gulashi, — gënjeva unë. Ky ishte i vetmi emër që dija nga ky fshat.

— Dak Gulashi, ë, — u dëgjua një zë nga pas dhe një e goditur e rrufeshme pas kokës bëri që unë të humbisja çdo lidhje me botën e gjallë.

— Qeni! — u dëgjua zëri i të atit dhe nga çibuku i tij ngriheshin spiralet e tymit.

Për herë të parë e dëgjova babanë të shante me këtë fjalë një njeri. Kaq dhe ai s'foli më. Në dhomë kishte rënë heshtja. Spiroja, nga lëvizja e supeve, e kuptoi që nëna po qante. Ai s'e kishte vënë re kur kishte ardhur e qe ulur pranë tij. I ati mbushi çibukun përsëri dhe në qetësinë e plotë dëgjohej zhurma karakteristike e djegies së duhanit. Vështrimi pyetës i të atit donte të thoshte se priste vazhdimin e tregimit.

— Kur hapa sytë isha po në errësinë, i zgjuar si nga një gjumë i thellë, me kokën të rënduar e të turbullt. E ndieja trupin të këputur dhe kisha përsëri dëshirë të mbyllja sy-

të e të flija. I tronditur, shkunda kokën e provova të ngrihesha. Në errësirë po kontrolloja veten me duar. S'kisha pushkën, gjerdanin, kapelën. Ku isha kështu? Hodha dorën në tokë dhe kërkova vendin, më zuri dora diçka të butë, e afrova te hunda dhe binte erë bajgë dhe kashtë. Mezi u ngrita në këmbë dhe eca me hamendje në errësirën e plotë. U përplasa në një mur dhe ndjeva dhembje në ballë. Dëgjova një kollitje dhe u nisa drejt saj. Kisha arrihur te një derë. Njëpërmjet të plasariturve të saj pashë një zjarr dhe kokën e ndezur të një cigareje.

— Ej, ti, kush je? Hap derën! Pse më ke ni mbyllur këtu?! Por askush nuk përgjigjej. Fillova t'i bija derës si i çmendur me këmbë e me duar dhe të thërritja me gjithë forcën. Dëgjova një zë:

— Mos i bjer derës, mor derr! Akoma nuk e ke marrë vesh ku je?

Ky ishte roja që më ruante. Unë isha rob dhe ky vend, ku më kishin mbyllur, ishte burgu im, me siguri ndonjë haur bagëtish, gjersa binte erë bajgash. Ja sa keq kishin rrjedhur punët. Për Dok Gulashin unë duhej të isha një gjah që i kisha dalë në shteg. Ja ku isha një partizan i çarmatosur. Një i burgosur i kërtij rojës te dera, robi i Dak Gulashit. Tani me mua mund të tallej jo vetëm Dak Gulashi, po dhe një fëmijë. Goditja ballin me grusht, fërkoja kyçet e duarve që s'dija ku t'i futja dhe vija rrotull nëpër këtë haur të qelbur pa ditur ç'të bëja. Po sikur të mos isha kthyer në Guras? mendova. Mund të ma kishte zënë frymën tufani dhe do të më kishin gjetur të vdekur. O, do të kishte qenë njëqind herë më mirë të më kishte përpirë tufani dhe nata! Ki-

sha dalë partizan dhe vdekjen e kisha llogaritur nga plumbi. Po para një turpi të tillë, ajo vdekje do të kishte qenë, të paktën, e ndershme. Apó jo, o babë, ë?

Babai nuk më foli, veç pa nënën në sy. Ajo uli kokën. Ata diç folën në heshtje me njëritjetrin, ashtu siç ishin mësuar ata. Merak për mua s'kishin, se në vatër isha, pranë tyre, veç një hall e fshihnin që të dy. Siç dukej, im atë vuante për atë që s'ma thoshte dot dhe, si për t'i dhënë kohë vetes, më nxiti që të vazhdoja rrëfimin.

— E pastaj?

— Më vinte të pëlcitja. Doja të dilja s'andejmi qoftë dhe i vdekur. Nuk e duroja dot atë turp. Përse isha nisur e ku rashë. Ky haur duhet të ketë një dritare, thashë me vete, megjithëse në atë errësirë nuk mund të dalloja asgjë. Dukej në mënyrë fare të turbullt suvaja e mureve, e zbardhur nga gëlqerja. Këtë e kuptoja dhe nga era e gëlqeres. Gërryeja me thonj dhe vendosja hundën, se nuk e duroja dot erën e bajgës. Fillova të ecja gjatë murit, duke e kontrolluar atë me duar. Rashë në një vend bosh. Gati u rrëzova. Futa duart dhe boshllëku shkante gjer lart. Ky do të jetë oxhaku, mendova. Vazhdova të rrëshqitja po gjatë murit, me duar mbështetur pas tij, dhe preka në diçka të ftohtë. Kisha gjetur dritaren. Kapa me të dyja duart fort hekurat dhe po i tundja me gjithë fuqinë. Po hekurat qenë të trashë dhe të fortë. Patjetër, ata që më kishin mbyllur këtu, e kishin menduar dhe këtë gjë. Shkova përsëri te dera. Njëpër të krisurat e saj dukej zjarri dhe pjesë të trupit të rojës ulur pranë tij. Mendova të krijoja një rast për të hapur derën. Ai ishte vetëm një, po, dhe të

ishim shumë, isha gati të përleshesha. Më mirë i vdekur se i gjallë. I fola përsëri rojës.

— Ç'do, o derr? — u dëgjua zëri pas derës.

— Hape, o njeri. Kam atë nevojë që kanë gjithë njerëzit.

— Pse, s'të mjafton gjithë ai konak? Ke atje vend edhe për dyshek, edhe për qenef.

Unë i rashë si i tërbuar derës me gjithë forcën, i dëshpëruar, pa ditur ç'të bëja. Dëgjohe-shin bravat e saj që kërcitnin dhe zëri i rojës:

— Do qëlloj, or derr, po ik nga dera!

Të më qëllonte, do të ishte më mirë. Por ai as më qëllonte dhe as derën s'e hapte, veç rrinte atje pas saj si nata e zezë. U ula i lodhur dhe i dërrmuar. Futa dorën në gji dhe pre-ka letrën. Ajo ishte aty. Në errësirë të pashë ty, nënë. Ashtu m'u duk se të pashë, të sëmurë, pastaj të vdekur, që më prisje të hyja unë, mbase vetëm kaq dhe ti do të shëroheshe, do të ngjalleshe. Në kraharor ndieja një boshllëk të madh dhe në grykë më mbetej gjithmonë një komb që nuk e gëlltitja dot. Dhe ashtu, i ulur ndofta dremitja.

U ngrita përsëri dhe eca në errësirë. Papritur u përplasa te muri. U afrova te dera dhe nga të çarat e saj dukej e kuqja e zjarrit. Dëgjohehin hapa. Ata duhej të ishin të rojës. Ai s'flinte. Ai më ruante mua. Kështu më gjeti mëngjesi.

Hauri ku kisha kaluar natën duhej të kish-te qenë dikur i banuar. Suvaja vende-vende kishte rënë, në krye që oxhaku me një vatër gjysmë të prishur dhe nga lindja një dritare e vogël me hekura, pa kanatë, e zënë nga jashtë me kashtë. Lart nxinin trarët dhe qeprat. Në cepat e mureve vareshin cerga meriman-

gash dhe nëpër trarë lëviznin minj pushatakë. Nga të çarat e derës roja më shikonte me kurreshtje. Me siguri dhe ai më shihte për herë të parë. Unë qëndroja te vatra, larg derës. Në haur drita hynte nga lart, nga dërrasat, e çatisë. Duhej të kishte rënë dielli dhe dita të ishte e kthjellët. Te dera u shkëmbyen zëra. U dëgjuan lëvizjet e çelësit në bravë. Dera u hap dhe brenda hynë tre veta: një burrë me xhaketë meshini, me kilota, me kapelë, me çizme e me një rrip për mes të mesit ku dukej revolveri i varur. Në një anë të xhaketës kishte të qëndisur një shqiponjë, gati si të stamposur. Dy të tjerët i vinin pas me pushkë në krahë. Roja rrinte te dera. Burri me xhaketë meshini m'u afrua dhe priti të ngrihesha në këmbë, duke më ngulur një vështrim të egër.

— Kam ardhur të flas me ty, — tha

— Ngrehu qelbanik! — shau një nga shoqëruesit.

— Komandanti juaj besoj do të jetë mërzi-tur nga temenarat, — thashë unë duke u ngri-tur qetë-qetë.

— E shoh se qenke krenar, djalosh, — tha njeriu me xhaketë meshini, — po mos harro-ni se jeni një rob i forcave të Ballit.

— Jam viktimë e pabesisë së Dak Gulashit.

— Ka rëndësi që je rob. Yllin në ballë nuk ta vuri Dak Gulashi.

— Yllin në ballë ma ka vënë ideali im.

— Komunistët ju kanë futur në kokë juve të rinjve barin e tërbimit. Është mirë të qetë-sohesh dhe të mendosh për veten. Je shumë i ri, djalosh. Dhe mos harro se ne kemi në dorë dhe gurin dhe arrën.

— Ç'kërkon nga unë, zoti ballist?

— Një gjë të thjeshtë, që do të jetë për të

mirën tënde. Do të tregohemi me ty të arsyeshëm. Bëj një deklaratë se të kanë marrë partizanët me zor, shkruaj se i urren komunistët dhe trego se i ke parë me sytë e tu poshtërsitë e tyre. Thuaj se u hodhe vullnetarisht me forcat e Ballit. Të kujtoj se këtë të mirë e ke nga miku yt Dak Gulashi, ndryshe mëngjesi do të të kishte gjetur në togun me dhé.

— Ai që hedh pushkën në krahë e ka llogaritur dhe vdekjen.

— Djalosh, këtu nuk flet para komisarit.

— E di që flas para një tradhtari.

Kryeballisti m'u afrua me sy gati të kuq si të një qeni të tërbuar. Fytyra e tij e madhe qe errësuar e ngërdheshur. Më kapi fort për mjekre dhe filloi të ma tundte kokën djathtas-majtas. Ia kapa dorën dhe ia hoqa me forcë. Një nga ballistët, që i qëndronte në krah, më dha një të shtyrë dhe unë u përplasa për muri.

— Lëre, lëre! — tha ballisti me xhakëtë meshini, me një zë të mbytur e të copëtuar midis dhëmbëve të shtrënguar nga egërsia. — Kë-tij çunaku do t'ia nxjerr dhe qumështin e nënës nga hundët, po vazhdoi kështu si e ka nisur. Sonte ka fjetur rehat në këtë haur. Po të jap dy orë afat të mendohesh, — m'u drejtua mua përsëri, — dhe mbaj mend ç'të thashë. Përndryshe atje në qelitë e Gestapos do të të rrjepin për së gjalli.

— Të shitur. Doni të na trembni me Gestapon!

Dy ballistët m'u hodhën menjëherë, më kapën për krahësh, m'i kthyen duart pas dhe më lidhën me litar, pastaj m'i lidhën dhe dy këmbët dhe më lanë si trung të shtrirë në dyshemenë e haurit të nxirë nga bajgat. Kur

mbeta. vetëm, me të zvarritur shkova gjer të muri dhe u mbështeta gjysmë i ngritur. Duart dhe këmbët, të lidhura fort, nuk i lëvizja dot. Më ishin mpirë krejt dhe ndieja një nevojë të tmerrshme për t'i çliruar. Nuk qëndroja dot gjatë në një pozicion. Herë mbështeteshë për muri, herë kthehesha brinjas e herë shtrihesha dhe përmbys, se trupi s'më gjente qetësi. Më kishin kthyer në një trung, më kishin lënë të zvarritesha në një copë truall të bajgosur të haurit. Ja si isha katandisur. Isha nisur me pushkë e me gjerdan dhe kisha mbetur pa duar e këmbë, gjersa ato s'i kisha të lira. Po dhe të lira t'i kisha, ç'do të bëja me to brenda mureve të këtij hauri ku të zihej fryma? Donin të më poshtëronin, donin të më frikësonin. Në fillim kisha menduar se nuk i duhesha asnjëri. Po nuk ishte ashtu. Tani unë duhesha për diçka tjetër, që do të përlyente luftën tonë, idealin tonë. Dhe kështu, i çarmatosur, kish mbetur dhe për mua një shesh lufte, ja këtu në këtë haur bagëtish, të nxirë e të harruar. Qëllimin e tyre e kuptoja mirë. Ajo deklarata u duhej më tepër se jeta ime. Dhe për të marrë një firmë nga dora ime s'do kursenin as dhëlpërinë, as kërcënimin e torturën. Mund të më dorëzonin në Gestapo, po mund të më mbanin dhe te ky haur, sa ta shihnin se unë nuk thyhesha. Mbase më shikojnë kështu djalë të ri, u dukem çunak e besojnë te të dyja: dhe te dhëlpëria, dhe te kërcënimi. Siç tha ai kryeballisti me xhakete meshini, ata kanë dhe gurin dhe arrën. Të gjitha mund ti bëjnë. Por unë do të qëndroj!

Kur dola partizan, e kisha menduar vdekjen nga plumbi. Kam dëgjuar se vdekja është njëlloj, gjersa është vdekje. Jo, ajo vdekja nga



plumbi do të kishte qenë shumë më e lehtë. Kurse këtë vdekje jo, nuk e doja. Edhe ata e dinë se kjo vdekje është më e vështirë dhe shpresojnë të marrin atë deklaratën që ta tundin në duar duke bërë titur: Dëgjoni ç'thotë një ish-partizan! Dëgjoni ç'flasin ata me gojën e tyre! Dëgjoni si i mashtrojnë njerëzit komunistët! Çdo gjë mori fund. Ata të malit po hidhen vetë në radhët e Ballit. Dëgjoni!...

— Jo, jo! Kurrë jo!

— Me kë flet ashtu? Mos luajte nga fiqiri, more derr?! — foli roja pas derës.

Dukej që unë, në këtë bisedë me veten, kisha folur me zë. Nuk më erdhi mirë që më kishte dëgjuar ai xhahil që përgjonte pas derës. Mendova njëherë të shkoja te dera t'i thosha dy fjalë. Po ç't'i thosha atij. Kur ja, te dera u dëgjua përsëri lëvizja e çelësit në bravë, ajo u hap dhe brenda hyri Dak Gulashi i shogëruar nga roja. Si ishte e mundur! Si kishte guxim të më dilte në sy ky njeri! Më shkuan të rrëqethura në trup. Ja tek e kisha përpara njeriun që s'më kishte thyer dot në shtëpi dhe më kishte mbyllur në haur. Sa mirë bëri që erdhi. Nuk mund të vdisja i qetë pa e shikuar edhe një herë këtë fytyrë, sy në sy dhe ta pështyja në surrat. Dhe ja ku e kisha përballë.

— Ç'të kanë lidhur kështu, — tha, duke u përpjekur të fuste në këto fjalë një ndjenjë habie. — Dhe unë çuditë si janë treguar kaq pak të sjellshëm. — Më shikoi dhe s'foli. Ai bëri sikur s'e vuri re talljen time. — Zgjidhe, — i tha rojës.

— Nuk trembesh, Dak Gulashi, nga duart e mia?!

— Qetësohu, djalë! Besoj se këtë radhë do

të merremi vesh. Mirë do të ishte që puna të mos kishte vajtur gjer këtu. Po je i ri dhe unë t'i kam falur të gjitha.

Po zieja përbrenda, dhe isha gati t'i hidhesha në fyt.

— Shqiptari ka zakone e tradita. Ne jemi miq dhe miku duhet për ditë të zezë. Më mirë një mik, se një çiflig, thotë një fjalë e moçme. Sido që bëre, unë nuk do të të kisha nxjerrë ashtu nga shtëpia ime, siç ike ti. Dhe në shtëpinë time nuk do të guxonte njeri të vinte dorë mbi ty. Po ti ike si tufani dhe sot janë kohë të vështira. Po prapë do të përpiqemi, mbase e rregullojmë atë që prishe ti atë natë. Jam mik i vjetër i shtëpisë suaj dhe detyrimet e mikut do t'i kryej gjer në fund. Zgjidhe shpejt! — iu drejtua rojës, që ende qëndronte si një hu në këmbë, duke ndjekur fjalët e Daku Gulashit.

I çliruar, u ngrita, po m'u duk sikur do të më merreshin mendtë e do të rrëzohesha. Më dhimbnin kyçet e duarve dhe këmbët ende s'më dukeshin të miat. Po përballë kisha Dak Gulashin me një trup të imët, me fytyrën të rruar taze e me një palë mustaqe të hollá si një kurriz gjarpri, me ca sy bojëhiri si të maces. Ky njeri, që më qëndronte këtu përballë, më kishte borxh nderin dhe jetën dhe se ç'përralliste si një magjistar për detyrat e mikut dhe për ato që ishte gati të bënte për mua.

— Na lër vetëm! — i tha Dak Gulashi rojës.

Roja, një zdap i gjatë, me kurrizin pak të dalë, doli duke e lënë derën gjysmë hapur.

— Mos do të ulesh? — m'u drejtua mua.  
— Më dukesh i lodhur.

— Jo, Dak Gulashi, dua të rri kështu më

këmbë, të të shikoj drejt në sy. Edhe i vdekur sikur të isha, për ty do të isha ngritur nga varri.

— Ule zërin dhe mati fjalët që thua. Diçka duhet të kesh mësuar nga ajo ndodhi. Dhe ndodhi sepse u rrëmbeve dhe na prishe shumë punë. Ja, re rob. Ai që erdhi te ti sot në mëngjes, është komandant i forcave të Ballit. Këtë fakt tani e di edhe komanda.

— Gjarpër, hiqesh sikur i ke duart të pastra!

— Kështu i kishe thënë dhe atij komandantit. Unë dhe duroj, po të tjerët s'durojnë. Të duroj, se shkele për herë të parë në shtëpinë time, se dole nga pragu i shtëpisë sime, se shqiptari mikun nuk e lë kurrë në baltë. Të duroj, se je i ri e i papjekur, se komunistët të kanë çakërdisur mendjen.

Tek e dëgjoja të fliste ashtu, dridhesha i tëri nga urrejtja; mezi e përmbaja veten, kurse ai mundohej të ruante qetësinë, një qetësi të shtirur, se në të vërtetë dukej që sharjet e mia i gëlltiste me vështirësi.

— Meqë çështja jote shkoi gjer në komandë, siç të thashë, edhe unë nuk e kam aq të lehtë të manovroj. Po do të jetë dhe më keq të vejë çështja gjer në Gëstapo. Prandaj duhet vepruar sa më shpejt. Janë kohë të liga; sot vete si qeni në vresht e s'i beson dot as këmishës që ke veshur. — Ai tani e kishte ulur zërin e më ishte afruar pranë.

— Prandaj them të nënshkruash sa më shpejt atë deklaratën, se mos të ndërrohet mendja. Unë ja ku e kam prurë me vete, — dhe ai nxori nga xhepi një copë letër, e shpalosi e m'i lexoi ato pikat me radhë. — Ty të vjen

rëndë, mbase të duket si tradhti e kudi unë si i quajnë këto komunistët. Kam dëgjuar që njerëz të tillë, po i zunë, i pushkatojnë si dezertorë. Po dhe këtë e rregullojmë. Ti nënshkruaje sa t'ua tregoj atyre të komandës, pastaj deklaratën do ta mbaj unë dhe, duke e pasur në dorë, ne, bashkë, shohim e bëjmë. Duam, e mbajmë; duam, e grisim. Një copë letrë është, që shkruhet e grisët kur të duash, kurse jeta vjen vetëm një herë. Besoj se kështu s'ke asnjë kundërshtim, — dhe me sytë që hetonin gjithçka më zgjati letrën në një rën dorë, kurse në tjetrën stilografin. — Unë i kam bërë të gjitha gati, — tha dhe u mundua të buzëqeshte.

E mora letrën me duart që më dridheshin nga inati, e grisa copa-copa dhe ia përplasa në fytyrë, e pështyva dhe pastaj iu hodha për fyti dhe po e shtrëngoja, po e shtrëngoja t'ia nxirrja shpirtin me duart e mia. Ai në fillim nxori një klithmë, sytë iu shqyen dhe damarët e qafës iu frynë. Nuk e dija ku e kisha ruajtur gjithë atë forcë. Dak Gulashi kishte rënë poshtë dhe unë sipër tij, pa ia hequr duart nga fyti. Te dera u duk silueta e zgjatur e rojës. Ndjeva nga pas të goditurën e tij. Mbeta pa ndjenja, ashtu siç isha mbi trupin e shtrirë të Dak Gulashit.

Isha përsëri vetëm, i shtrirë atje ku kisha vënë nën vete Dak Gulashin. Tani besoja se burri me xhakëtë meshini dhe Dak Gulashi nuk do të vinin të më shqetësonin përsëri. Po ndieja të ftohtë. U ngrita. I erdha rrotull haurit pa asnjë qëllim. Tej derës ishte roja, zjarri

dhe dita. Duhej të ishte pasdreke. Kjo kupto-  
hej se një rreze drite binte pjerrtas gati në  
mes të haurit nga një e çarë e çatisë nga ana  
perëndimore. Ajo rreze dhe unë ishim të vet-  
met qenie të gjalla në këtë boshllëk të vogël  
të vdekur. Veçse ajo rreze ishte e lirë, kurse  
unë jo. Po ç'kërkonte këtu në këtë haur të bra-  
ktisur? Dukej sikur kishte ardhur për të më  
bërë shoqëri mua. Ajo shtizë e artë e kishte  
gjetur atë të çarë në çati. Po sikur të ngjite-  
sha gjer atje dhe të dilja jashtë, të isha i li-  
rë si rrezja? Në fillim ky mendim, që më erdhi  
ashtu papritur, m'u duk zbavitës. Po sa më shu-  
më ndiqja rrugën e rrezes, aq më tepër më  
forcohej bindja se dhe unë mund të ikja tej  
atyre trarëve të zez dhe tej atyre qeprave të  
mbuluara me dërrasa guri. Gjer tek e çara e  
çatisë mund të ngjiteshe lehtë. Po vetëm kaq.  
Qeprat, pllakat e rënda prej guri, çatia, roja.  
Po dhe të rrije këtu, ta prisje vdekjen duar-  
kryq, nuk ishte e lehtë. Kurse atje, tek dilte  
ajo rrezja, kishe dhe shpresa për të shpëtuar.  
Shigjeta e artë e rrezes ishte holluar dhe pa-  
pritmas ishte zhdukur fare. Unë shikoja lart  
në çati atë vendin nga binte ajo, sikur diçka  
të më kishte humbur. Tani, përmes asaj së  
çarë të vogël dukej një risk qielli i kaltër. Ja  
atje ishte liria. Po vija rrotull haurit dhe më  
ngjante sikur te muret, te çatia, te dritaret, te  
dera do të hapej papritur një e çarë e madhe  
që të hynte jo një rreze, po një lumë drite dhe  
unë të ikja përmes saj. Po kjo dëshirë e zjarhtë  
përplasej te muret, te çatia, te dera, te roja  
që kollitej jashtë e më shfaqeshin përsëri bu-  
rri me xhakëtë meshini dhe Dak Gulashi. Pa-  
pritur fasha e rrezes së dritës u duk nga një  
drejtim tjetër. Ajo binte që nga oxhaku mbi

vatër. Ishte më e shkurtër, po më e gjerë se e para. Një mori grimcash lëviznin në atë fashë drite si të ishin qenie të gjalla. Si s'më kishte shkuar ndër mend më parë! U ula barkas te vatra dhe shikoja në drejtim të rrezes. Dielli të verbonte. Qe një oxhak i vjetër, i zgavërryer deri lart; anash dukej boshllëku i nxirë nga blozë dhe sipër një dërrasë e madhe me një të çare nga hynte rrezja e diellit. Muri i oxhakut mbi çati qe gjysmë i prishur e i çarë nga të dyja anët. Nuk ishte më i lartë se një bojë e gjysmë njeriu. Mund ta provoja që tani. Mora gurë nëpër haur dhe i vendosa njëri mbi tjetrin të ngjitesha. Po më përpara shkova te dera dhe vëzhgova rojën. Ai ishte ulur pranë zjarrit dhe po pinte duhan. Shkova përsëri tek oxhaku, përkula trupin me një ndjenjë ankthi dhe gëzimi. Po bëhesha gati të bëja provën e parë. Po një mendim tjetër më bëri që të ndërroja mendje menjëherë. Do të nxihesha i tëri në blozë dhe do të diktohesha para kohe. Duhej pritur nata. S'kaloi dhe ca dhe fasha e dritës u zhduk. Ndofta tani dielli kishte përenduar dhe unë isha ndarë me ato dy rreze drite që më kishin treguar atë shteg shpëtimi, që mbase s'do ta kisha shkuar në mend kurrë. Kisha menduar kështu në kokë planin e arratisjes, po s'dija në ç'pikë të fshatit ndodhej hauri, si ishte terreni rreth tij që të dija nga mund të ikja, sidomos në rast se më diktonte roja. Dera kishte përballë malin dhe atë pjesë të fshatit që ngrihej në fund të faqes së tij. Nga sa mbaja mend, se në këtë fshat kisha ardhur dhe një herë, pjesa tjetër vazhdonte në të dy këmbët e malit dhe në mes hapej një përrua. Sidomos kisha nevojë të dija sa larg e kisha përroin nga mund të ikja

më me lehtësi. Gjeta një dru dhe te dritarja, përmes kashtës, munda të hapja një vrimë. Përballë dukej një grumbull i vogël shtëpish dhe më poshtë fillonte e thepisura, ku duhej të ishte përroi. Kuptohej që hauri ishte në anën tjetër të tij. Nuk doja ta hapja edhe më, se mund të më diktonte roja dhe ngjallja e dyshimeve do të prishte gjithë planet e mia. Sa kishte ende dritë, mblodha gurë të tjerë, i afrova pranë oxhakut t'i kisha gati dhe i mbulovala me kashtë që të mos dukeshin. Gjithashtu gjeta një gur me tehz dhe në të dyja anët e oxhakut fillova të bëja vend në mur për të vendosur këmbët. Punoja ngadalë. Vura re se muri kishte dhe vetë plot të hyra e të dala, veçse do të kisha vështirësi t'i dalloja në terrin e natës. Duhej të kishte ardhur mbrëmja, se dëgjoheshin zile me këmborë bagëtish që po ktheheshin në fshat, të lehurat e një qeni dhe një zë i fortë njeriu që vinte që larg. E merrja më mend atë që s'shikoja dot. Një rrugë duhej të shkonte pranë haurit, se dikush bisedonte me rojën. Kontrollova dhe një herë veten se mos më kishte mbetur ndonjë shenjë bloze dhe shkova e qëndrova pranë derës duke pritur natën. Tani roja më ruante mua dhe unë ruaja rojën. Pothuajse ai qëndronte pranë derës. Dëgjoja të kolliturën e tij dhe më pas, si u err mirë, pashë flakët e zjarrit që kishte ndezur. I erdhi shoku për ta ndërruar. Unë dëgjoja, kur po bisedonin:

- I kanë dhënë gjë për të ngrënë?
- I kanë dhënë, po s'pranoi.
- Do ta lënë shumë te ky haur në këtë breg? Këtu të pret era.
- Sabahu, s'besoj ta zërë gjallë.
- Thonë është djalë i ri.

— Djalë i ri, por i egër. Desh mbyti Dak Gulashin.

— Dak Gulashin? Si është e mundur!

— Është betuar t'ia nxjerrë shpirtin pak nga pak.

— Kush do të vijë të më ndërrojë?

— Zequa.

— Thuaji Zeqos të mos harrojë të vijë shpejt në sabah.

— Mos u bëj merak, ndiz zjarrin dhe ruaj derën.

— Në këtë natë, dhe të duash të flesh, nuk të zë gjumi nga të ftohtët.

— Natën e mirë.

— Natën e mirë.

Roja i ri hodhi dru në zjarr. Nga të çarat e derës shikojta nën flakët e zjarrit pjesë të fytyrës së tij. Kur lëvizte, fytyra i copëtohej përmes së çarës së hollë. Filloi të këndonte me zë të ulët. Dhe ia merrte, dhe ia kthente vetë:

*O ti, që bëre njerinë,*

*ç'e mundove fatzinë!*

*s'i dhe gjë në këtë jetë,*

*veçse një durim e shpresë.*

Roja vazhdonte të këndonte. Hidhej nga një këngë të tjetra, përsëriste vargje të shkëputura prej tyre dhe i vinte dru zjarrit. Mua orët më dukeshin shumë të gjata dhe koha ecte mjaft ngadalë. U ngrita nga dera dhe lëviza drejt oxhakut. Ç'orë e natës mund të ishte? Përveç meje dhe këtij njeriu pas derës, kush vallë tjetër mund të ishte zgjuar në këtë fshat në këtë orë të natës? Lëviza përsëri drejt derës. Zëri i rojës s'dëgjohej më. Vështrova për-



mes të çarave dhe dukej vetëm prushi i kuq i zjarrit, pastaj dora e njeriut që e trazoi dhe një e gogësitur:

— Ja, Abaz Ali!

Dhe përsëri heshtje. Prushi i kuq dhe nata e errët pas derës. Unë lëviza rishtas drejt oxhakut, zbattha këpucët, i lidha për mesi, hipa mbi togun e gurëve që kisha ngritur mbi vatër dhe fillova të kërkoja shkallët që kisha bërë ditën në të dyja anët e oxhakut. Fillova të ngjitesha. Mbështeta krahët në të dyja anët e murit, ngjitesha, gjersa dora këpi në krye të oxhakut dërrasën e madhe. Mbështeta këmbët mirë, e ngrita dërrasën me duar dhe hapa kreun e oxhakut. Më në fund kisha dalë mbi çati. Nata që e heshtur dhe e zezë pis. Qëndrova pezull duke mbajtur frymën. Po kërkoja me sy përmes errësirës drejtimin e përroit. Gjer tani gjithçka kishte kaluar mirë. Më kishte mbe-tur dhe pak vend, derisa të zbritja poshtë. Isha jashtë derës, jashtë çatisë që më kishte zënë frymën për një natë e një ditë. E dija se tani kisha armik këmbët e mia dhe përgjimin e rojës. Flinte apo ishte zgjuar? Dhe në flinte, dhe në ishte zgjuar, koha për mua ishte e çmuar dhe çdo vonesë kishte pranë vdekjen. Të gjitha këto atje sipër në çati unë i shqyrtova shumë shpejt. Fillova të ecja mbi pllakat e gurta me këmbë e me duar. Njëra këmbë më zuri në një pllakë, bosh, ajo u thye dhe ra me zhurmë. S'kisha vënë re se kisha arritur në fund të çatisë. U dëgjuan këmbët e rojës dhe unë u hodha fluturimthi poshtë, vrapova në bisht të bregut, drejt përroit. Roja më mori pas, vazhdoi të më qëllonte dhe nuk duhej të kishte qenë larg kur më qëlloi për herë të parë. Po nata që e errët, ai shtinte vetëm në

drejtim të hapave të mi. Unë isha zbathur dhe ai e humbi drejtimin tim. Në fillim zbrita drejt përroit, po pastaj u ktheva faqes së majtë të tij. Roja kaloi nën mua, vazhdonte të qëllonte dhe të thërriste. Në fshat u dha alarmi. Nga shtëpitë përballë u dëgjuan pushkë, pastaj zëra. Vura re se të gjithë njerëzit shkonin drejt përroit, nga qëllonte roja. U kisha humbur gjurmët. Unë e lashë përfundimisht përroit dhe i dola fshatit mbi vete, duke u larguar andej nga kisha ardhur. U dëgjuan tri pushkë dhe një bombë. Ky ishte sinjali i alarmit të Ballit. Kjo donte të thoshte se ishte marrë vesh gjithçka dhe kundër meje do të fillonte ndjekja. Po mëngjesi më zuri shumë larg fshatit, jashtë çdo rreziku. Si ra dita, u futa në një gërxh dhe, kur u sigurova se s'më ndiqte njeri, qëndrova të çlodhesha. Fillova të lidhja këpucët, se i kisha mbathur shpejt e shpejt gjatë rrugës. Vura re se njëra prej tyre më ishte mbushur me gjak. Nuk kisha kuptuar se ku isha plagosur. Më në fund diktova rrëkenë e gjakut që zbriste nga pulpa e këmbës së majtë. Tani po më sëmbonte, sikur më shponin me dhjetëra maja të holla gjilpërash. Shqeva një copë nga këmisha dhe e lidha. Fillova të kontrolloja vendin. E kisha lënë pas Qafën e Burgajetit. Pastaj nisa të zbritja poshtë, drejt luginës së Lumasit. Kur gjeta një burim qëndrova. U ula dhe piva i etur. Isha djegur për ujë dhe etja më kishte munduar më shumë se gjithçka gjatë rrugës. Piva aq shumë, sa ndjeva të më priste një thikë e ftohtë në bark. Në pasqyrën e burimit pashë të lëkundej fytyra ime. Isha nxirë nga bloza e oxhakut në duar, në rroba e me siguri dhe në fytyrë. Fillova të lahesha. Pastaj pastrova

gjakun rreth plagës së lidhur që të mos më binde në sy nga kalimtarët që mund të takoja rastësisht. Çdo njeri që do të më shikonte, do ta fytyja në dyshim. Unë tani isha krejt i çarmatosur. Duhej të mënjanoja çdo takim me çdo njeri. Dhe kështu arrita këtu.

— Ditëgjati s'bëhet ditëshkurtër, — foli babai dhe shkundi çibukun në vatrë. Pastaj u koll gjatë, u nervozua dhe u ngrit e shkoi te grazhdonte mushkën në kasolle. Nëna qëndroi pranë djalit dhe lutej t'ia shihte dhe një herë këmbën e plagosur.

Atë çast hyri babai, pa dhe ai plagën dhe qetësoi nënën: — Hajde, mos u bëj merak, martohet njeriu dhe me këtë plagë.

Partizani ngriu në vend dhe pa gjithë inat babanë.

— Mos më shiko ashtu, bir. Shiko shtëpinë. Jemi në ditë të hallit, unë, nëna, vëllezërit e motrat. Na duhet një krah për ndihmë.

— Prandaj më paske thirrur, — gati sa s'thirri.

— Kur të mbarojë leja që të ka dhënë komisar, nis. Ti s'rron dot pa shokët e çetës, ne s'rrojmë më pa një nuse. Ç'të bësh, na zuri keq pleqëria, na duhet një krah dhe për punë.

Gjithë arsyet ia kishte parashtruar i ati, me një ton të qetë e fare shkurt. U kishte dalë një rast për një vajzë të mirë në fshat, ua kishin kërkuar dhe ua kishin dhënë. Fejesë dhe martesë do të bëheshin bashkë. Miqtë ia dinin hallin qiraxhrit e as kohët s'ishin për salltanete të mëdha. Tani prindërve u kishte

trokitur pleqëria e, siç kishte thënë babai, u duhej dhe shërbimi, dhe gazi. Këtë gjë mund t'ua sillte vetëm një nuse në shtëpi. Partizani kishte dëgjuar në heshtje. Ai e ndiente se s'mund të kundërshtonte. E vetmja gjë që mund të bënte për prindërit e tij ishte ajo që po kërkonin ata. Ai e quante këtë martesë një sakrificë, megjithëse ecte në të shtatëmbëdhjetat. Zëri i ishte trashur dhe shtati i ishte hedhur. Në fshat që zakoni që djemtë të martoheshin përpara kësaj moshe. E megjithatë diçka kishte ndryshuar. Atje në çetë askush s'fliste për martesë e të martuarit ndienin shqetësimin e atyre që kishin lënë larg. Edhe të fejuarit dhe beqarët do të martoheshin kur të vinte paqja në Shqipërinë e lirë. Po këtu në fshat vepronin ligje të tjera. E jashtëzakonshme për këtë martesë nuk ishte pse dhëndri ishte i larguar partizan, po se ajo nuk bëhej sipas atij riti të trashëguar brez pas brezi. Dhëndrit më gjashtë janar i mbaronte leja dhe duhej të nisej për në çetë. Kurrë në atë fshat s'ishte bërë dasmë në janar. Por edhe koha ishte e jashtëzakonshme. Lufta ishte nderur kudo e vinte rrotull çdo ditë. Megjithatë njerëzit përpiqeshin ta shpjegonin këtë dasmë të ngutur të qiraxhiut. As mund të merret me mend që në një fshat të mos dihet gjendja e hallet e çdo shtëpie, prandaj dhe ato që thuheshin për këtë dasmë në mos të gjitha, shumica e tyre ishin të vërteta. Që kur i kish ikur djali, ai kishte mbetur i vetëm në shtëpi. Në këto kohë të vështira myshterinjte ishin pakësuar shumë veç kësaj, edhe mushka Murrë, dhe ata të dy, burrë e grua ishin plakur. Shtëpisë i duhej të paktën një krah i fortë, dhe punët e asaj arës së vogël do t'i përballonte ajo që do

të vinte. Kishte dhe një shkak tjetër, jo më pak të fortë. Babai dhe nëna kishin ardhur në atë moshë, kur donin t'ua sillte kafënë apo një gotë me ujë nusja e djalit të tyre. Ata, para se të mbyllnin sytë, e shikonin këtë si të parin dhe të fundit gëzim të madh. Ky ishte një shkak shpirtëror dhe shkaqet shpirtërore shpeshherë janë një shtytje e madhe. Dihej që lufta kishte filluar, po nuk dihej kur do të mbaronte. Qiraxhiu s'u besonte as atyre që thoshin se do të mbaronte shpejt dhe as atyre që thoshin se s'do të mbaronte kurrë. Ai, që kishte kaluar kaq luftëra në jetën e tij, e dinte se kjo luftë do të kishte një fund. Kësaj lufte i kishte dhënë një djalë dhe në këtë mënyrë ishte lidhur me të. Me gjithë hallet që kishte, thellë në shpirt e ndiente kënaqësinë që shtëpia e tij, kurrë ndonjëherë e dëgjuar në punët e fshatit, kishte hyrë në rrjedhën e ngjarjeve kaq të mëdha që kishin përfshirë me çdo fshat e qytet të Shqipërisë. Mungesën e vet në shtëpi i biri mund ta zëvendësonte me nusen. Ja pse s'kishte pritur për këtë martesë as mbarimin e luftës e as muajt tradicionalë të dasmave. Vetëm për një gjë nëna kishte ngulur këmbë. Dasma do të bëhej me pesë janar e jo më katër. Data katër ishte ditë e martë. Kurrë ajo s'kishte dëgjuar në jetën e vet të kishte kaluar ndonjë nuse pragun e shtëpisë në ditë të martë. Në qoftë se gjithë të tjerat nuk i kishin bërë ashtu siç kishin qenë zakonet, pse të mos bënin këtë, duke u shtyrë dasmën edhe një ditë.

Babai ishte borxhli te miqtë e farefisi, kishte bërë ftesa në të gjitha miqësitë. Nëna kishte hapur sepeten dhe kishte nxjerrë që andej gjërat më të vyera që ruante që nga nusëria e saj: dy palë çitjane njëra një copë e

bardhë me lule, tjetra kashmer i kuq i sjellë nga Janina; një peshlli dhe dy jelekë që i kishte qëndisur vetë për pajë, xhaxhesha i pruri një palë potina me xhufka prej telatini dhe ato të ruajtura që nga koha e hershme e gjithë këto, së bashku dhe me një libade tërë kinda, me këmishë të qëndisur me rruaza në grykë, një shami plot ojna, përbënin pajën kryesore të nuses, veç atyre dhuratave që do të sillnin sipas zakonit të gjithë të ftuarit.

Për tri ditë me radhë shtëpia e qiraxhiut ishte përherë plot. Njerëzit vinin të uronin për djalin që kishte ardhur nga çeta dhe për martesën që pritej të bëhej së afërmi. Në shtëpi ishte hapur kënga. Gjithçka dukej e jashtëzakonshme. Djali ishte veshur me një palë këpucë alpine gjermane, një xhakëtë dhe një palë pantallona prej shajaku dhe kapelën me yll të kuq. Nënës i kërkoi të bënte gati dy palë çorape leshi. Ajo e përqafoi dhe qeshi. Çarapet do t'i bënte nusja, do të ishin një kujtim i bukur për atje në male dhe do të ishin që qëndisura me ibërschim të kuq, të bardhë, jeshil, të zi, trëndafili, që ajo tanimë nuk i bënte dot.

Po kishte dhe një rrethanë tjerër që e bënte këtë dasmë ta përshkonte një fill i tendosur shqetësimi. Larg dëgjoheshin gjëmimet e topave. Grykat e maleve binin jehonën e luftës. Në shumë krahina kishte filluar Operacioni i Dimrit. Banorët e fshatit e dinin se një ditë do t'i braktisnin shtëpitë e tyre. Dhe kjo nuk ishte një ditë e largët; armiku kishte zgjedhur dimrin e ashpër. Kështu i dukej atij se do të mposhteshin më lehtë partizanët dhe populli. Banorët e fshatit e njihnin këtë taktikë të armikut dhe ishin të përgatitur. Të dukej sikur

dasma që bënte qiraxhiu nuk i përfillte këto li-  
gje të luftës.

Ditën e dasmës ra dëborë. Tej dritareve, re-  
të gri shumë të ulura pillnin flokë të bardhë  
me një qetësi të jashtëzakonshme. Nusja e ki-  
shte shtëpinë në lagjen e fundit, në të dalë të  
fshatit. E prunë hipur mbi një kalë të bardhë.  
Në sfondin e kuq të duvakut kishte qën-  
druar një cipë e hollë dëbore. Krushqit e shku-  
an tërë rrugën më këmbë dhe herë pas here  
qëllonin me pushkë. Nga kjo dasmë njerëzit  
do të mbanin mend atë që ishte më e veçantë:  
dëborën dhe duvakun e kuq, dasmën dhe jana-  
rin, këngët dhe gjëmimet e topave të luftës.

Dy konakët e shtëpisë ishin plot, kënga dhe  
rakia ndiznin njëra-tjetrën. Të dyja derdheshin  
pa u ndërprerë dhe dukej sikur dasma s'do  
të kishte fund kurrë. Po korrieri partizan ki-  
shte arritur në fshat. Ai kishte përshtuar dhe  
fshatra të tjera, po vetëm këtu dëgjoji këngë  
në orët e vona të natës.

— Atje bëhet dasmë, — i tha kryetari i kë-  
shillit nacionalçlirimtar. — Sikur të mos kishe  
ardhur me një lajm të tillë, do të kisha çuar  
të shikoje si bëhen dasmat nga anët tona. Po  
koha s'na premtton, — dhe ai i afroi filxha-  
nin me raki dhe një copë mish pastërma.

— Duhet të iki në fshatin tjetër, — tha ko-  
rieri.

— S'ke pse nxitohesh, fshati fqinj nuk  
është larg, ata dëgjojnë alarmin tonë dhe vi-  
hen në gatishmëri, kështu bëjmë gjithmonë.

Në orën dy pas mesnate u dëgjuan pesë pu-  
shkë dhe një bombë. Burrat rrëmbyen dyfe-  
kët dhe u nisën drejt qendrës së fshatit. Sinja-  
li i alarmit e tulari dasmën. Kënga nuk u pre-  
menjëherë, po burrat filluan të ngriheshin një-  
ri pas tjetrit. Vetëm të dehurit s'kuptonin ç'ki-

shte ndodhur. Mbushnin gotat dhe ftonin të tjerët të pinin. Doli dhe partizani. U ndodh ballë për ballë me babanë. Pas pak erdhi dhe nëna. Ajo dukej që ishte shumë e shqetësuar.

— Puna u shpejtua dhe një ditë, — tha i biri. — Unë njëlloj se njëlloj do të ikja.

Po nëna mendoi shtratin e shtruar me çarçafët e bardhë dhe lotët i rrodhën njëri pas tjetrit e u rrokullisën si sumbulla të vogla.

— Unë prapë do të kthehem, — tha ai dhe ia rrëmbeu kokën e vogël me shami të zezë në kraharorin e tij.

— Më duhet nga ti vetëm një gjë, — i tha babait.

— E di, — tha ai dhe pas pak u kthye me një pushkë italiane të gjatë.

Ajo ishte pushka e tij, që e ruante si gjithë të tjerët.

— Nuk mund të ikësh kështu, — tha nëna. — Nuses i do hequr duvakun, — tha dhe e mori për dore. Dhoma ku hynë ishte mbushur plot me gra. Pranë sepetes rrinte nusja, e rrethuar nga njerëz. Ajo nusëronte në këmbë. Kur hyri partizani me pushkë në sup, të gjithë hapën rrugën. — Do më falësh, — i tha dhe i hoqi duvakun. — Na takoi të rrimë bashkë shumë pak.

Ajo qëndronte pa lëvizur, me sytë gjysmë të ulur. Tani shtati i saj i derdhur, gjinjtë e hedhur mbi kraharor dhe fytyra e kuqe i dukeshin më mirë. Ajo e pa drejt në sy. Të kuqtë ia mbuloi më shumë fytyrën që i digjej nga një nur bukurie.

— Të trashëgoheni! — u dëgjuan zëra nga të gjitha anët e dhomës dhe filluan të drejtoshin nga dhëndri dhe nusja.

Shkrepi një pushkë. Nëna e përqafoi të bi-



rin me nxitim, e puthi, pastaj puthi dhe nusen. Vetëm tani nuses i shkau një pikë lot. Kjo ceremoni e shkurtër shënonte dhe epilogun e dasmës. Pastaj partizani doli i ndjekur nga njerëz. Po e përcillnin.

— T'i kesh për rrugës e për shokët, shumë prej tyre do të të urojnë atje kur të vesh, — i tha nëna e i rراسi në dorë një boçe. Ajo qëndroi në këmbë. Partizani ktheu kokën dhe pa babanë, i cili zgjati dorën dhe e futi brenda, ku ishin nusja dhe gratë.

Territorialët po kalonin pjesë-pjesë tej qafës, nga fshati s'dukej më. Partizani ktheu kokën e pa fshatin e lindjes. Nata po shuhej dhe po ndizej agu i ditës. Dëbora, që zotëronte tejmbanë peizazhin, jepte reflekse të dobëta. Drita e mëngjesit po zbardhte. Ajo bënte që objektet përreth të merrnin gjithnjë e më shumë formë. Dalloheshin shtëpitë, të mbuluara me dëborën që kishte rënë dhe kandilat e zbehtë si yjet me vezullime të largëta. Një nga ato drita ishte dhe ajo e shtëpisë së tij. E dinte se në mur, mbi shtratin e dhëndërisë, llambën që kishte varur, nëna do ta linte ndezur për tri net me radhë, siç ishte zakoni dhe ajo, nusja, do të nusëronte atje, me faqet të skuqura, me ata qerpikët e gjatë si hala gruri, ashtu siç ia kishte parë kur i hoqi duvakun. Ecte, po mendjen e kishte te shtëpia, ecte drejt krismave të luftës dhe ndiente se në shtëpi, ashtu si papritur, u shtua dhe një njeri tjetër për të cilin duhej të luftonte, ecte dhe i vinte mirë që në shpirt po i lindte dhe një dashuri tjetër, dashuria për atë.

# Buka

Ne sapo kishim mbaruar drekën. Diellin e ëmbël të prillit e kishim mbi kokë, megjithëse kishte nisur të varej tej majës së Shpatit. Kishim ngrënë me oreks, siç mund të hajë njeriu pas punës, nën qiellin e hapur, në një lartësi afër dy mijë metra, në arat majë maleve, ku po çanim ugaret për të mbjellë patate. Pranvera kishte ardhur shpejt e këtë vit po lërohej më shpejt se herët e tjera, megjithëse brigada tjetër, në disa vende me hije, i kishte gjetur shumë ara të mbuluara me dëborë. Edhe ne në atë mëngjes fillonim vonë. Të ftohtët e natës e ngrinte tokën, ndaj prisnim sa ta zinte dielli për ta shkrifëruar, përndryshe maja e plorit ngecej, sikur të kishte zënë në gur. Ne ishim tre veta: Nika, Paloku dhe unë. Kishim zënë një lug ku ngastrat e vogla vraponin njëra pas tjetrës duke u ngushtuar gjithnjë e më shumë drejt kreut, si drejt kulmit të një koni.

— Çudi me ju, — u dëgjua zëri i Nikës, — asnjëherë s'merrni ujë me vete, — dhe, si e tundi pagurin bosh, e lëshoi përtokë me një gjest nervozizmi.

— Pse ta ngremë ujin me krahë që nga

fshati? Pak dëborë kanë këto maja? — foli Pa-  
loku.

— Po kush do të shkojë të marrë dëborë?

— Ta hedhim me short.

— Jo, më mirë të vejë ai që nuk e duron  
etjen.

— Atëherë po shkoj unë, — tha Nika, që  
e kuptoi se për kë thuheshin ato fjalë.

U ngrit, mori një torbë të bardhë, nxori që  
andej një çopë bukë dhe e vuri mbi një gur,  
pastaj e shkundi torbën dhe përtokë ranë ca  
thërmia të imta.

— Besoj se kjo është e pastër, — tha dhe  
tregoi torbën prej bezeje të bardhë dhe u nis  
me hapa të mëdhenj, që i hidhte mbi gurë.  
Ne e ndoqëm me sy, vështruam njëri-tjetrin  
dhe qeshëm.

— Për ujë bëhet menjëherë nevrik. Vëre  
re sa më shpejt ecën.

— Ai nuk ecën, po fluturon.

— Po shkon në majën e Harcalës.

— Nga Harcala kam një kujtim të hidhur,  
— thashë unë.

— Cfarë?

— Më zuri një shi me breshër në lëmin e  
thekrës.

— Shirat e ftohta e të rrëmbyeshme janë  
të zakonshme në këto maja.

— Po mua më zuri për herë të parë. Isha  
me një këmishë me mëngë të shkurtra dhe  
bëja muajin e punës fizike, si tani. Isha me  
Nikën. U dukën disa re nga jugu, filluan di-  
sa gjëmime dhe pas 15-20 minutash qielli u  
bë pus. Nika, dukej, e parashikoi rrebeshin që  
po vinte, se ngarkoi mushkat me të filluar pi-  
kat e para dhe sipër i mbuloi me plastmasë.  
Rrebeshi shpërtheu menjëherë. Në fillim shi

dhe pastaj shi me breshër. Unë s'kisha provuar shi më të ftohtë në jetën time. U futa nën kavaletat me kashtë, duke sajuar një kolibe të vogël. Po shiu dhe breshri qenë aq të dendur, sa rrëkeja filloi të shkonte nën vete, ndërsa kashta më sillte mbi vete currila uji që më depërtonin deri në mish. Nika me rojën kontrolluan edhe një herë togun e thekrës në mes të lëmit se mos i hynte uji, vështroi për muarret e rrotull dhe, kur s'më pa, më foli me emër. Erdhi dhe më gjeti të mbledhur kruspull nën kavaletin me kashtë, më kapi për krahu dhe më nxori nën qiellin e hapur.

— Ti po ftohesh! Ke ardhur me një këmi-shë me mëngë të shkurtra, po këtu t'thonë malësi. Më jep duart. Lëvizi! Lëvizi! Lëshoji duart! Lëvizi! Lëvizi fort! Po të rrije dhe ca atje nën kashtë, do të kishte ngrirë.

Zhveshi xhaketën e tij dhe ma hodhi mbi supe. Edhe ajo që qull e lagur, po s'e linte shiun e rrëmbyeshëm që të më godiste drejt në mish. Ai vetë, nën tërë atë shi, e kishte lëshuar trupin aq lirshëm, sikur të ishte nën një dush me ujë të ngrohtë.

— Tani, nisu përpara, rrugës për në fshat! Ec, vetëm ec! Duke ecur s'do ta ndiesh të ftohtë e shiut.

U nisa përpara. Ai me tri mushka vinte pas meje. Qiejt ishin çarë. Shiu vazhdonte të binte me furi. Isha lagur dhe nën sqetull. Rrobat më ishin ngjitur në trup dhe kulloja i tëri. Retë qenë ulur shumë poshtë dhe majat kishin humbur krejt midis tyre e përpara shikoje një det ngjyrë hiri me horizonte krejt të mbyllura e të ngrysura. S'mund të shikoje asgjë, veç rrugës ku ecje. Relievi që kredhur në një mugë-tirë e të ngjante sikur ecje në një botë që

s'të kishte takuar ta shkelje asnjëherë. Gjëmonte dhe herë pas here vetëtimat shurdhuese që çanin qiellin e errët shkrepninin mbi majat përreth plot kërcëllimë. Nën dritën e tyre të menjëhershme, verbuese, shfaqej peizazhi përreth dhe po aq shpejt zhdukej i kredhur në mugëtirën ngjyrë hiri të reve dhe shiut të dendur.

— De, mushkë, de! Ec! ec! — dëgjohej pas zëri i Nikës dhe ai zë më kujtonte se njeriu ishte kudo i pranishëm.

Kur zbritëm poshtë, rrugës që ecte luginës ku shtrihej fshati, shiu binte i butë e i qetë.

Kishte ndodhur ashtu siç më kishte thënë Nika. Megjithëse i lagur deri në palcë, tani nuk e ndieja fare të ftohtët dhe të lagurit, por ecja fare lirshëm, pa e përfillur shiun. Nika po grindej me veten. Cepi i një thesi me thekër, ku plastmasa kishte pasur një plasari-më, qe lagur.

Ishte dëshpëruar shumë që nuk e kishte vënë re. Po si mund ta vinte re në atë duman të vërtetë? Për mua ai kishte vepruar i shpejtë dhe i fortë, si një ujk i vërtetë e prapë ankohej pse i qe lagur cepi i një thesi.

— Eh, më thoshte, — thekra, nga të lagët, mbin menjëherë, dhe mbin mbi gur, — dhe vija re se kjo e mundonte shumë.

— Po për ne që jemi lagur nga maja e flokut te maja e thoit, si s'të shkon mendja fare, — e ngacmova unë me qëllim.

— Mos ki hiç merak për veten. Me të shkuar në shtëpi, ndërrohu menjëherë dhe do ta ndiesh trupin të lehtë e do të rehatohesh, si pas një dushi me ujë të ngrohtë.

Paloku, përballë, dëgjonte në heshtje, me një fytyrë ku vijoheshin e thyheshin plot rru-

dha. Të paktën unë kisha bindje se po i tregojta diçka jo të zakonshme. Ajo ngjarje kishte lënë mbresa tek unë, dhe isha përpjekur që këto mbresa t'ia transmetoja dhe tjetrit, që më dëgjonte i mbështetur pas një shkëmbi që mbarronte plot thepa, i ngrënë nga erozioni. Të ngjante sikur ai ishte mbërthyer pas atij shkëmbi si me gozhdë e s'mund të lëvizte. Tej ngrihej mbi të gjitha maja e Harcalës, e mbuluar me dëborë dhe vende-vende, krahas vllangave të dëborës, në bunishta, jeshilonte bari ri. Ajo ngrihej si një shpatë e mprehtë, aq sa kishte të drejtë të quhej «Maja e Shpatës». Tej kreshtës dukej humnera e kulluar e qiellit. Nika po vinte. Ai po zbriste dhe ecte një kurri. Silueta e tij, që larg, mprehej e zmadhohej.

— Po vjen, — thashë unë, duke dashur ta ndërroja temën e bisedës, i bindur se ajo që i kisha treguar nuk kishte ngjallur interes te tjetri.

— A e shikon këtë copë bukë, — tha papritur Paloku, duke e marrë atë që nga guri. — Dikur neve na ka kushtuar dhe jetën. Ti je banor i ri i këtyre maleve. Vërtet ti e di që jeta s'ka qenë kështu. Po, kur s'e ke jetuar, nuk është aq e lehtë ta përfytyrosh me të gjitha hollësitë. Ti më tregove atë ngjarjen e Harcalës të gushtit të shkuar. Të ka bërë aq shumë përshtypje kujdesi i Nikës që thekra të mos i lagej! Dhe ti e tregove bukur. Kur kam qenë i ri, kam lexuar shumë. Tani lexoj më pak, po, kur gjej kohë, dhe tani kam qejf të lexoj. Nga ti s'kam lexuar gjë, po më kanë thënë që shkruan. Mbase të pëlqen dhe e shkruan dhe këtë ngjarje që dua të të tregoj. Ta shkruash origjinale, jo siç i ndryshoni ju shkri-

mtarët nganjëherë gjërat. Po ne jse, kjo është tjetër gjë. E kishim fjalën për bukën, — dhe ai lëvizi papritur nga vendi, gjithnjë me copën e bukës në duar.

Të dukej sikur tani kishe të bëje me një karakter tjetër e te balli rrudhat e shumta mblihdeshin e hapeshin me një lëvizje të çuditshme. Dhe ai filloi të tregonte.

Nuk ishte gusht, s'binte shi i ftohtë me breshër, siç e tregove ti, por ishte palca e dimrit. Gjithë grykat ishin zënë nga dëborat. Ishin vitet e para të lirisë. Reforma as na kishte dhënë, as na kishte marrë gjë. Në anët tona ishte pak më në gjendje ndonjëri që kishte më shumë krerë delesh, po për toka ishin të gjithë nevojtarë. Mos shiko tani, që është lëvizur shkëmbi nga vendi e arat u janë ngjitur maleve, po në ato vite ne kishim nga një arë ku bima thahej dhe nën hënë. Me arat te ne merreshin gratë. Ato i lëronin, ato i mbillnin dhe ato i korrnin. Tamam si në atë vjershën e Çajupit, që i ka qarë pikën. Ne ishim blegtorë të zotë, po me tokën nuk ishim lidhur. Kishim trashëguar dyfekun, kërrabën, hejbet mbi supë dhe thasët mbi samarët e mushkave dhe endeshim me një majë halle për t'u sjellë fëmijëve bukën e gojës nga fusha. A i sheh këto male? Në ç'vend tjetër mund të ketë kaq shumë shkëmbinj dhe gurë? Na dukej sikur këta shkëmbinj dhe gurë do të vazhdonin të na shoqëronin përjetë me ftohtësinë e varfërisë. Kush mund t'i lëvizte nga vendi? As vetë perëndia, në qoftë se kishte perëndi, siç thoshin. Ç'do të bënte me ne pushteti i ri? Të

varfër ishim ne, i varfër qe dhe ai. Shumëkush mendonte se do të na jepnin toka, duke na zbritur në fusha. Po të mos largohemi nga ajo që dua të të tregoj. Thasëve me miell u kishte dalë fundi. Në shtëpi të Nikës prisnin dymbëdhjetë gojë për t'u ushqyer, ndërsa në shtëpinë time nëntë. Mbaheshim me qull. Po, sado të hollë e të paktë ta bësh dhe qullin, prapë mielli duhet. Dhe unë e Nika morëm udhët. Kishim një mushkë. Duhej të çanim malet dhe grykat, të stivosura me dëborë. Rrugës nuk mund të ecje, se fundoseshe me gjithë mushkë. Premë kurriz më kurriz atje ku dëborën e hap era. Po në ndonjë shteg Nika dhe unë i bëmë mushkës udhë duke e çarë vetë dëborën. Në pellgun e Delvinës trokitëm në dyert e shumë miqve për të siguruar misër me të shtrenjtë. Edhe në tregun e zi nuk gjeje kollaj. Mundëm të gjenim misër e ca oriz duke e paguar sa frëngu pulën. Por u kishim siguruar fëmijëve nja një muaj bukë dhe kjo na bënte që t'i harronim gjithë të tjerat. Mushkën e kishim ngarkuar sa s'ngrinte më dhe kishim hedhur mbi supe dhe nga një thes orizi. Të sillje misër dhe oriz këtu në fshat, në mes të dimrit! A e di ç'do të thoshte kjo? Sikur sillje një visar. Ty të duket çudi! Ashtu më duket dhe mua tani, por atëherë... Po kishim dhe një hall tjetër. E kishin nxjerrë nga malet mushkën duke ecur kurrizeve, por e ngarkuar mushka nuk i hante dot kreshtat thikë të maleve. Halli s'na linte të prisnim shirat që të hapeshin shtigjet e rrugët. Në fshat do ta çonim dhe në krahë pjesë-pjesë, jo të gjithë njëherësh. Po për fatin tonë të mirë, nga Delvina u nisëm në një mëngjes me shi. Na lagu gjithë rrugës, po neve na dukej sikur ai binte për të mirën



tonë. Shiu do t'i hapte shtigjet e qafave e të luginave, ku dëbora stivoset e, po qe ngricë, s'hapet as në pranverë. Barrën e mushkës e kishim mbuluar me një mushama. Ne të dy kullonim nën shiun që binte pa ndërprerë. Kur dolëm në kufij të maleve tona, pamë se dëbora kishte filluar të lëpihej e rrëketë po vërshonin. Ajo copëtohej nën këmbët tona, e lagësht e kokermadhe. Pas linim një vilar ngjyrë-kafe. Balta përzihej me dëborën dhe ajo e humbiste virgjërinë e saj të bardhë. Filloi të frynte jugu dhe shiu pushoi. Dhe jugu e shkrin dëborën më shpejt se shiu. Ishim me shumë fat. Kishim frikë Qafën e Gurit të Zi, posa të arrinim na duheshin dhe nja dy orë. Po të vazhdonte kjo erë, do ta kalonim pa shumë vështirësi. Përrenjtë e rrëketë, të ushqyera nga ujërat e dëborës, gjëmonin me kërcëllimë. Kur dolëm tek e përpjeta e Thanasit, qëndruam. Oshëtima e Përroit të Thatë dëgjohej fare mirë. E dinim që këto vërshime ujërash do ta kishin fryrë e turbulluar shtratin e tij të thyer. Ai është një përbindësh i vërtetë. I tharë në verë, i pabesë në vjeshtë e në dimër. Poshtë nesh shtrihej lugina e vogël dhe tej bërrylit të malit Bohotinë ishte fshati.

Kishim bërë gjashtë orë rrugë dhe për një gjysmë ore arrinim në fshat. Mbi fushën e vogël, të çliruar nga dëbora, dridhej muzgu i mbrëmjes. Përreth malet me dëborë lëshonin thellimin e tyre të ftohtë. Ne vazhduam të zbritnim rrugën plot dredha të Shpatit të Thanasit dhe në çdo hap na shoqëronte buçima e Përroit të Thatë. Ai çante luginën e vogël më dysh dhe fshatin e linte në anë të djathtë. Të dy mendonim për pengesën e fundit, po nuk flisnim. Dhe ja u ndodhëm përballë përroit, shi-

konim ujërat e tij të turbullta, dëgjonim buçimën e tij shurdhuese dhe për disa çaste pritëm sikur dikush do t'ia ndalte shkulin e tërbuar. Pas shkëmbinjve, që dilnin e hynin, ujërat përplaseshin dhe shkuma merrte një ngjyrë ndryshku. Pesë-gjashtë metra më poshtë ujërat thyheshin e binin në honin e thellë me rrapëllimë shurdhuese.

— Ç'presim! — thashë unë. — Ujërat sa venë e po shtohen, nata po afrohet.

— Të kalojmë, — tha Nika.

Hodhëm thasët e orizit në supe. Vendi më i gjerë ishte 5-6 metra mbi honin. Atje vendosëm ta kalonim. Rrezikun e parandienim. Përroi i Thatë jo vetëm që vërshon me rrëmbim, po të vret edhe me gurë. Po për ne s'kishte shteg tjetër. Nika kapi mushkën për kapistre dhe e tërhoqi drejt përroit. Ajo ngriti veshët, nguli dy këmbët e para, shfrynte me hundë, pa lëvizur.

— Foli! — u dëgjua zëri i Nikës, i përzier me buçimën e ujit.

— De, mushkë! — dhe unë e qëllova me shkop nga pas.

Nika hyri i pari në rrjedhën e turbullt, pastaj mushka, dhe në fund unë. Ndjeva në mish të ftohtët e ujërave të dëborës dhe këmbët gati po m'i shkulte rrjedha e furishme. Shikoja mushkën përpara, që sa vinte e kridhej dhe për një çast m'u duk se uji po i mbulonte edhe samarin. Përherë e më tepër rriteshin thellësia dhe forca rrëmbyese e shkulin. Uji po më arrinte te gjoksi. E ndjeva se ishim futur keq. Mushka filloi të ecte gjithmonë e më pjerrtas. Rrjedha ia kishte shkukur këmbët, a ndofta ajo vetë po notonte. Pashë Nikën që po tërhoqte kapistrën, po dhe ai s'e komandonte dot. E kapa mushkën për

bishti, po rrjedha na rrëmbente të dy, me kafshët bashkë. Sytë e Nikës qenë shqyer. Ai e kishte hedhur në ujë thesin me oriz. Edhe 1-2 metra dhe rrjedha na vërtiste në humnerën e honit. E hodha dhe unë thesin, nxora thikën, preva litarët e barrës së mushkës dhe bërtita:

— Lëshoje kapistrën! Lëshoje, Nikë!

E kapa për krahu dhe e mbajta. Mushka, e lehtësuar nga barra, çau përpara dhe doli në breg. Edhe unë e Nika, të mbajtur dorë për dorë, me ujin gjer në gjoks, duke hequr këmbët zvarrë që të mos na i shkulte rrjedha, arritëm të dilnim. Mushka u shkund dhe në të dyja anët e samarit i vareshin bishtat e litarëve të prerë. Ne kishim qëndruar në breg dhe pas dëgjonim oshëtimën rrapëllyese të ujërave. Atë gjë të shtrenjtë, që e kishim siguruar me aq mund, na e kishte rrëmbyer ai përrua i mallkuar. Kishim shpëtuar mushkën dhe veten tonë. Ecëm në muzgun e natës që kishte rënë. Do t'u venim fëmijëve duarbosh. Do të flinim atë natë në shtëpi dhe të nesërmen përsëri do të niseshim për diku.

Fytyra e madhe plot gjak e Palokut kishte marrë atë qetësinë e parë. Unë vështroja herë atë, herë copën e bukës që ai e kishte lënë përsëri mbi gur. Po përjetoja atë që sapo kisha dëgjuar.

Sakaq kishte arritur Nika, me torbën plot dëborë. Paloku dhe unë morëm nga një copë të madhe në duar dhe filluam ta rrufitnim, ndër-sa Nika e thyente copa-copa, e fuste në pagur, e tundte fort, gjersa e shkrinte. E ktheu pagurin dhe lëshoi një «ah» kënaqësie. Unë shikojta shpatullat e tij të gjera, hundën pak të

kthyer, fytyrën ezmere të hequr dhe kërkoja të gjeja se ç'shenja mund të kishin lënë tek ai njeri gjithë ato që më tregoi Paloku. Por ai ktheu dhe një herë pagurin dhe u ngrit duke thënë:

— Ngrihemi! Edhe traktoristi e mbaroi pushimin e drekës. Ja, dëgjojeni.

Zhurmen e traktorit grykat ta sillnin sikur të ishte këtu fare pranë.

— Qetë po përtypen, — tha përsëri Nika dhe zbriti i pari në lugun me ara.

U ngritëm edhe unë e Paloku. Në qiellin e larë të prillit ndriste dielli tej Majës së Shpatës dhe pasqyra vigane e dëborës të verbonte sytë.

Dëgjohej gumëzhima e traktorit dhe zëri i Nikës.

— Ha-ho, Kacel!

## Kur humbet çdo fytyrë njeriu

Roja qëndronte në një vend të ngritur dhe dallohej që larg. Unë eca drejt. Kur u afrova, dëgjova një zë të prerë që më urdhëronte të ndaloja. Qëndrova. Pushkën e mbaja hedhur në sup.

— Kush je ti? — u dëgjua zëri i rojës.

S'dija si t'i përgjigjesha. Ta dish kush je dhe të mos kesh guxim ta thuash!

— Vij te partizanët.

— Je nga territorialet!

— Jo, vij nga qyteti.

Roja heshti dhe më vëzhgonte. Dukej se u vu në dyshim kur i thashë se vija nga qyteti.

— Keni në çetë ndonjë njeri tuajin?

— Kërkoj komisarin.

— Do prisni pak.

Roja bëri disa hapa dhe u dëgjua zëri i tij që thërriste:

— Shoku Maliq! Shoku Maliq!

U duk një burrë i gjatë me një revolver varur në rripin e mesit. Ata diç thoshin me njëri-tjetrin. Ai që quhej Maliq, duke biseduar me rojën, herë pas here shikonte nga unë. Bëri disa hapa dhe më foli:

— Ej, shok, eja lart!

— Tungjatjetani! — përshëndeti Maliqi.

— Tungjatjeta!

Ai më hodhi një vështrim hetues, ndërsa roja rrinte pak më larg.

— Përse e doni komisarin?

Dua të më shoqëroni gjer tek ai, ose te ndonjë tjetër i komandës partizane.

— Unë më parë dua të di ç'hall keni, nga vini dhe kush jeni.

— Quhem Dardel Dani, vij nga qyteti për te partizanët.

— Vini me ndonjë mision nga shokët tanë?

— Jo, vij me vullnetin tim.

Ai që quhej Maliq më shikoi dhe një herë dhe ma bëri me dorë ta ndiqja pas. Ecëm në një vend të thyer dhe pas pak dolëm në një shesh, ku ishin vendosur partizanët.

Në krye të sheshit qe një haur dhe pak më tej ngriheshin dy çadra.

— Prit këtu, — më tha Maliqi kur arri-  
tëm te hauri.

Pas pak ai u kthye dhe më çoi në njërën nga të dy çadrat. U ngrit në këmbë një djalë i ri me një kapelë të bardhë me strehë, ku binte në sy ylli i kuq dhe më dha dorën. Ky duhej të ishte komisari. Në krah i qëndronte një burrë mbi të dyzetat, me një gunë hedhur supeve.

Si zumë duart dhe u përshëndetëm, ai ma bëri me dorë që të uleshë. Çadra ishte shtruar me gjethe. Një pushkë dhe një palë dylbi ishin mbështetur në një kënd të saj.

Hoqa pushkën nga supi dhe u ula. Nga udha kisha djersitur. Nxora shaminë dhe fshi-  
va ballin. Ai burri me gunë supeve më zgja-

ti kutinë e duhanit, unë e hapa dhe mora një cigare të dredhur.

— Kishit kërkuar një nga ta komandës?

— Po.

— Urdhëroni e flisni.

— Jam një ballist dhe kam ardhur të dorëzohem te ju partizanët.

Për të dy ata që kisha përpara, kjo që e papritur. Burri me gunë supeve vrenjti vetullat dhe më nguli një vështrim shpues, ndërsa tjetri më pyeti po aq qetë sa dhe më parë:

— Ju nga e dinit që ne ishim këtu?

— Me të pyetur.

— Sa kohë keni qenë me Ballin? ,

— Po, si t'jua them, nja tre muaj, pa ca ditë.

— Dhe vendosët vetë t'i braktisnit radhët e Ballit dhe të vinit te ne?

— Po.

Unë kisha djersitur i tëri. Guximi më kishte humbur dhe fjalët s'më lidheshin më.

— Pse s'ua tregova këtë rojave që në fillim?

— Po si të them? E kisha vështirë. Më dukej sikur, me t'i thënë rojës që isha një ballist, s'do të më linte të vija gjer këtu. Është një emër që të rëndon shumë.

— Kështu thua tashti. Po kur vajte tek ata të Ballit, t'u dukën të mirë. Ata s'të morën me zor, apo jo, — tha me egërsi burri me gunë supeve.

— Vërtet vetë vajta. Po atëherë, si të them, punë miqësie dhe ashtu ma preu rradakja.

— Dhe duhet të kesh rradake më vete, — ironizoi burri me gunë, — me pushkë supeve, sikur vije për të dorëzuar ndonjë urdhër. A i di ligjet e luftës?

— I kam marrë parasysh të gjitha. Më mirë të më vrasë pushka e partizanit, se i gjallë e atje.

Tani e kisha marrë veten përsëri. Vërtet s'e kishin pritur që t'u vinte kështu një ballist për t'u dorëzuar, me pushkën në sup. Edhe mua s'ma merrte mendja se do të kaloja aq lehtë te rojat, aq më tepër që partizanët na i kishin paraqitur të egër, që s'donin të dinin për asgjë, boll të dëgjonin fjalën ballist dhe të thërnin nga këmbët. Po mua më ishte mbushur mendja top. Le të më bënin partizanët ç'të donin.

— Ju thatë që keni qenë tre muaj pa ca ditë në rreshtat e Ballit, — foli përsëri komisari. — Për ata muaj ne do të hetojmë. Në qoftë se keni kryer krime mbi partizanë ose në popull, do të vendosë gjyqi partizan.

— Krimin tim më të madh unë e thashë. Kam qenë tre muaj me Ballin.

— Atë e dëgjuam. Të gjithë ballistët s'i futim në një thes, po tani, mbi të gjitha, nga ti kërkojmë të dimë gjithçka.

Pas pak erdhi Maliqi. Ai më mori më çarmatosi dhe atë natë më mbajtën në gjendje arresti te njëra nga të dyja çadrat. Të nesërmen filluan nga pyetjet. Më kërkuan të jepja me shkrim repartin e Ballit ku kisha bërë pjesë, komandantin, vendbanimin e familjes, pse isha lidhur me Ballin dhe ç'shkak më kishte shtyrë të dorëzohesha te forcat partizane.

I kisha në kokë që të gjitha, aq më tepër që gjithë natën kisha sjellë në mendje gjithë jetën time. Hetimin e bënte një djalosh që e thërritnin zëvendëskomisar. Mbi të gjitha, më tha se duhej të tregohesha i sinqertë. Kjo ishte prova e parë nëse doja të lahesha prej llumit



ku kisha rënë. Ai qe një djalë i ri, me ca sy zhbirues dhe me fytyrë që s'mund ta kuptoje se ç'mendonte.

Unë i shkrova të gjitha, ashtu siç i dija. Më vonë zëvendëskomisari më erdhi me letrat e mia në dorë.

— I lexova të gjitha ato që ke shkruar, — tha. — Në një vend i ke rënë pak si shkurt. Këtu shkruan, — dhe ai veçoi disa fletë nga të tjerat, — se shkaku kryesor për braktisjen e Ballit qenka bërë ballisti Ymer Gozhda, sidomos një ngjarje me të në ditët e Operacionit të Dimrit, kur ai qenka treguar «një shtazë», siç shkruan ti. Sikur të na e shtjelloje më gjatë misionin tuaj me ballistin Ymer Gozhda, qoftë dhe me gojë.

— Ymer Gozhda është oficer i Ballit. Me çetën e tij kam shkuar dhe herë të tjera. Jemi nga e njëjta krahinë dhe ai kishte qejf të më merrte me vete. Hajde me mua, më thoshte. Trimat e mi s'kthehen kurrë bosh. Më lajmëruan se ai më kërkonte. Vajta. Mendova ndonjë nga ato operacionet që bënte me çetën. Po mundohesha se ç'shkak të gjeja për të mos vajtur. Kisha hyrë në një valle dhe s'po dilja dot. Më priti në komandë dhe më tha të bëheshim gati se të nesërmen do të niseshim me një mision. Do ta marrësh vesh, më tha, mos më pyet më gjatë. Do të jesh ti me ca të tjerë. Të nesërmen u nisëm me makinë. Ishim katër veta: Ymeri, dy ballistë të tjerë dhe unë. Ne jemi skuadra e zjarrit, më thanë, megjithëse s'po merrja vesh asgjë. Ymeri kishte veshur uniformë gjermane. Po kjo s'më bënte shumë përshtypje. Ai këtë e bënte dhe herë të tjera. Kur arritëm në krahinën malore të Kaplinës, u sqarua dhe misioni ynë. Ne ishim vër-

tet skuadra e zjarrit. Ballisti Ymer Gozhda ishte gjerman dhe ne zbatonim urdhrat e tij. Kur ne gjenim ndonjë njeri në shtëpi (zakonisht të moshuar, që kujtonin se prania e tyre mund t'i shpëtonte shtëpitë nga djegia), fillonte loja. Gjermani jepte urdhër të digjej. Kush zgjidhte qesen, atij dhe mund t'i kthehej mendja. Pranonte vetëm para floriri, ose sende shumë të vyera. Në të vërtetë, siç më shpjegoi një nga ballistët, ne s'kishim të bënim me djegien e shtëpive. Skuadra e vërtetë e zjarrit, me listën e hartuar nga komanda gjermane, në bashkëpunim me atë të Ballit, vinte pas.

Po hynim në një shtëpi dykatëshe, me avlli përpara, të rrethuar me një mur. Nga oxhaku dilte tym. Kjo tregonte se kishte njerëz brenda. Hymë në një portë të madhe, ngjitëm disa shkallë të drunjta që ngjiteshin lart që nga divani dhe te pragu i dhomës së zjarrit më doli përpara një plakë.

— Ç'kërkoni, mor djem, — foli plaka me një ton të qetë.

Ymer Gozhda kishte ulur kapelën, e shtyu plakën t'i hapte rrugën dhe hyri brenda pa folur. Bëri disa hapa nëpër dhomë me duart mbrapa, hodhi sytë andej-këndej, pa një sepete në fund të dhomës, e qëlloi nervoz me shqelm, pastaj e shtyu sa u përmbys në dyshtemenë prej dërrase. Sepetes iu shqye kapaku dhe ranë plot zhurmë një sahan zinku, një tigan dhe ca shtëllunga leshi.

— Ç'bëni kështu, — tha plaka duke hapur duart. — Këto janë gjëra të shtëpisë, s'janë pushkë t'ju vrasin.

Ndërkaq, Ymeri, gjithnjë me strehën e kapelës ulur, shkoi në dhomën tjetër. Ne e ndiq-

nim pas. Plaka s'ecte dot shpejt dhe arriti në vendin e ngjarjes e fundit.

Ymer Gozhda, puna e parë që bëri, për ta lozur sa më mirë rolin e oficerit të egër të Hitlerit, rrëmbeu gjithë inat një fotografi të madhe në kornizë xhami, që varej përballë derës, në mur, dhe e flaku përtokë. Xhami u thye copa-copa. Fotografitë e tjera të vogla, që ishin vendosur anës kornizës, u shpërndanë nëpër dysheme.

— Partizan, — tha Ymeri Gozhda, duke e shqiptuar këtë fjalë me një zë sa më fyshkëllyes.

Plaka lëvizi e shqetësuar dhe në fytyrën e saj u duk tronditja.

— Të mallkuar! — nëmi dhe mori në duar kornizën, hoqi copërat e thyera të xhamit dhe fshiu me pulqerin e dorës fotografinë, që vende-vende ishte gërvishtur. — Ç'partizanë, që ju djegtë rrufeja! Ju po lëndoni kujtimin e të vdekurve, — dhe e afroi fotografinë pranë vetes.

Ymeri bëri me shenjë t'ia merrnin fotografinë plakës. Ajo e shtrëngonte fort dhe e ruante të mos ia dëmtonin. Po dy ballistët e kapën për krahësh dhe ia rrëmbyen me forcë. Ajo u rrëzua përtokë. I ra shamia e kokës dhe iu dukën flokët e bardhë e të rrallë si fije liri.

— Ju shoftë zoti! Partizanët janë në mal dhe ju i kërkoni këtu te një plakë e mbetur.

Ajo i dha trupit dhe u ngrit, shkoi përballë Ymer Gozhdës dhe e pështyu në fytyrë. Oficeri fshiu me shami fytyrën, u kthye nga ne dhe me një gjest nervoz kryqëzoi kyçet e duarve të veta. Kjo ishte shenja për ta li-

dhur. Dhe dy të tjerët e lidhën plakën menjëherë.

— Frikacakë! Keni frikë nga një grua plakë që mezi qëndron në këmbë. Unë dhe me duar të zgjidhura e lidhur jam. Të tillë djem mos pastë Shqipëria!

Duhej të ishte një plakë mbi të shtatëdhjetepesat. Dikur me një trup të gjatë që tani i ishte kërrusur, me mollëzat e faqeve të dala, me rrudha të prera e të mbledhura në të dy cepat e syve. Shaminë e kishte harruar përto-kë dhe vazhdonte të ishte kokëjashtë. Mallkonte dhe përpiqej të çlirohej. Por e ngrata plakë më kot përpëlitej e, kur e shikoje ashtu, të këpuste shpirtin. Çfarë na kishte bërë kjo plakë, që silleshim kaq çnjerëzisht me të?

Ymer Gozhda na urdhëroi ta kontrollonim shtëpinë brimë më brimë po s'u gjet asgjë për të qenë. Atëherë fillonte masa e fundit. Shtëpia u spërkat me benzinë.

— Kaput partizan! — shqiptoi përsëri me atë tonin fërshëllyes Ymer Gozhda, duke lënë të kuptohej se gjithçka do të përvëlohej.

Plaka u prish në fytyrë. Një pikë loti i rrodhi nëpër faqen e zhubrosur.

— Ç'ju ka bërë shtëpia, që do ta digjni?!

— Urdhër i prerë i oficerit gjerman, — tha ballisti që lozte rolin e përkthyesit.

— Eh, që helm ju bëftë qumështi i nënave! As ju nuk jeni më të mirë.

— Po të jetë për ne, dhe merremi vesh. Po vetëm oficeri gjerman mund ta prapësojë urdhrin, por ai do kështu, — dhe ballisti fërkoji gishtin tregues me të madhin duke bërë shenjën e parave. — Por i do vetëm verdhushka.

— Ku i gjetëm ne paratë, — tha plaka, —

na latë gjë ju. Keni dalë me urë në orë dhe u keni dhënë njerëzve arratinë.

— Ndonjë plaçkë të vyer që ju ka mbetur. Ato kanë qejf gjermanët. Mendohuni! Shtëpia kushton më shumë.

Balli i plakës u rruadh. Ajo shtëpi ishte djersa e disa brezave dhe ja pas pak, do të bëhej e gjitha shkumb e hi! Eh, sikur ta dinte e gjora plakë se ç'punohej! Dhe ajo ndaj dhe dukej të kish ndënjur, duke vënë jetën në rrezik për të shpëtuar këtë shtëpi. Bula djerse iu dukën në ballë.

— Zgjdhmëni shpejt, — tha me zërin e një burri.

Ai që lozte rolin e përkthyesit, e zgjidhi.

— Prisni këtu!

Pas pak u kthye.

— Merre! Jepja atij gjermanit tënd dhe dilni menjëherë nga shtëpia!

— Do t'ia tregoj njëherë oficerit gjerman. Do përpiqem mos i mbush mendjen, — tha ballisti në rolin e përkthyesit.

Ymer Gozhda kishte shkuar në dhomën tjetër.

Ai asnjëherë s'kishte qëndruar në një vend, sidomos përballë plakës.

— Pak, — tha «përkthyesi» që sapo ishte kthyer dhe mblodhi supet. — Zoti oficer thotë se... — dhe vuri dorën te veshi, — shpëton një shtëpi.

Plaka nxori nga gjiri një kuti të vogël. E hapi dhe u dukën një palë vathë floriri. Ne të gjithë ndiqnim veprimet e gruas.

— Merri, — dhe ajo ia vërviti ballistit. — E di që bashkë do t'i ndani me atë gjermanin. Në prag të varrit, ju më grabitët kujtimet

e nusërisë. Dhe tani shporruni nga shtëpia!  
Shporruni!

Trupi i saj i dobët prej kocke dhe delli që tendosur i tëri. Me gishtin e kokalltë na tregonte derën.

Ymer Gozhda i priti vathët me buzëqeshjen e fitimtarit.

— Ke luajtur një rol të shkëlqyeshëm — tha ballisti i kënaqur nga ky fund kaq i papritur. — Ti ngule këmbë për vathët, sikur t'ia kishe parë plakës në vesh.

— Ia kam parë, — tha Ymer Gozhda dhe, duke dalë nga shtëpia, filloi të na tregonte historinë e plakës Shane.

— Unë e kam thirrur gjithmonë nënë Shana. Plakën e pengoi pleqëria dhe uniforma gjermane që nuk më njohu, se përndryshe... Dhe është një plakë trime, siç e patë. — Ymeri herë e quante plakë dhe herë nënë. Ne vazhdonim ta dëgjonim me kureshtje. Ymeri nxori fotografinë që kishin marrë në shtëpinë e plakës dhe filloi të na e tirrte historinë më tej.

— Ja, ky është burri i plakës, ndërsa ky tjetri është babai im, — dhe i tregoi ata me gisht.

Ne u afruam duke mprehur vështrimin, gjithë kureshtje, sikur do të zbulonim tek ajo fotografi enigmën e asaj që kishte nisur të na tregonte komandanti ynë.

— Kjo fotografi është e vitit 1917. Unë kam lindur në Vlorë, — vazhdoi Ymeri, — kur shkua pas prishjes së frontit austriak. Ishim vendosur të gjithë në ullishtë, kush kishte e kush s'kishte edhe një kasolle për strehë. Më kanë treguar se vuanin nga uria. Njerëzia filluan të hanin bukë prej tallash druri. Nënës

sime nuk i kishin gjinjtë qumësht. Nënë Shana një sisë ma jepte mua dhe një birit gjashtëmuajsh.

Ne s'flisnim asnjëri. Megjithëse ai kishte mbaruar, nuk na jepej të ngriheshim nga lëmi i vogël në anë të një are, ku kishim qëndruar. Nuk di ç'mendonin të tjerët, por edhe ata diçka i mundonte. Dukej edhe ai e kuptoi se ajo që na kishte treguar, nuk kishte lënë përshtypje të mira tek asnjëri. E kishte nisur rrëfimin si në një përrallë, thjesht për të shuar kureshtjen e atij që kishte pyetur.

Si është e mundur! Si është e mundur! Grin-desha me veten. Ymeri, siç dukej, ndjeu vështrimin tim e atë çast tha:

— Djali i plakës, që ka pirë në një gji me mua, është partizan. Ai, po të më kapë mua, më bën copa-copa.

Pas këtyre fjalëve Ymeri hapi një kuti të vogël, të veshur brenda me copë të zezë, ku kishte ca unaza, zemra, vathë, byzylykë dhe sende të tjera, të gjitha prej floriri. Mua sytë më shkuan te vathët e nënë Shanës. Këtë e vuri re dhe Ymeri. Ai i mori në dorë dhe i ngriti lart sikur donte t'i peshonte.

— Për një plaçkë të tillë kush nuk bëhet lakmues, — tha. — Dhe, kur plakës mund t'ia grabitë një tjetër, pse të mos ia grabit unë. Besoj se më kuptoni: për këto dy sende s'mund të jeni pjesëtarë, se për këto unë kam kujtimet e mia dhe inatin tim.

Unë ballist kam qenë, por s'kam marrë kurrrë asgjë. Mbase prandaj dhe më donte komandant Ymeri me vete. Më kishte shok pa pjesë. Po këtë herë ato dy sende do t'i kërkoja vetë. Dhe besoja të m'i jepnin. Kur dëgjova atë historinë që na tregoi Ymer Gozhda, ndjeva se

kisha bërë shumë mirë që kisha vajtur dhe unë. Do t'i merrja dhe do të gjeja mënyrën të shkoja të takoja plakën, t'i tregoja se kush ishte ai gjermani që vinte rrotull nëpër shtëpi dhe t'ia jepja kujtimet e shtrenjta të nusërisë. Por ato fjalët e fundit të komandantit tonë grabitës dhe sarraf e mbyllën dhe këtë mundësi.

Ai tani me një zë të rreptë kërkonte të zotëronte gjendjen dhe të zhdukte te ne çdo ndjenjë njerëzore që mund të na kishte lindur.

Kjo shtazë kishte humbur çdo fytyrë njeriu. Edhe vetja më dukej e ndotur që isha midis këtyre njerëzve. Ç't'ju them tjetër?

Kjo është e gjitha. Me mua më duket se ndodh si me atë litarin e tendosur nga të dyja anët, që këputet në vendin më të holluar. Unë u këputa e rashë në anën tuaj.

Zëvendëskomisari, që mbante shënime në një defter të vogël, bënte ca viza mbi fletën e bardhë. Pastaj mbylli defterin, ngriti kokën dhe unë hasa atë vështrimin e tij të papërcaktuar. I mblodhi të gjitha letrat, i futi në çantën prej meshini me rrip që e hodhi në krah dhe tha:

— Megjithatë do na presësh dhe ca, — dhe doli.

Pas një jave më thirri komisari. Më kthyen pushkën dhe më thanë se isha i lirë të vendosja: të qëndroja në rreshtat partizanë ose të shkoja në shtëpi. Unë thashë se kisha për të qëndruar. I kisha borxhe luftës që ishte ndezur dhe unë do të përpiqesha t'i shlyeja.



## Duke kërkuar një shpellë

Në mëngjes, kur po pija kafën në klub, kryetari i këshillit të fshatit erdhi dhe u ul në tavolinë. Unë e pyeta se ç'donte të merrte, por ai m'u përgjigj se e kishte porositur kafën.

— Si vete puna me historikun? — tha duke ndezur cigaren. — Nga fundi i muajit duhet ta kemi projektin gati, se vijnë dhe shokët e komisionit që kemi thirrur.

— Ka dhe çështje që duhen ndjekur e plotësuar, po kryesorja besoj të jetë gati.

Ne ishim tre veta që merreshim me historikun e fshatit. Secili kishte marrë pjesën e vet. Periudhën e Paraçlirimimit, atë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe periudhën e ndërtimit të socializmit. Unë kisha për të shkruar periudhën e parë. Merresha gjithë ditën me pleqtë e fshatit. Ata ishin arkivi i gjallë i së shkuarës. I trokitnin kujtesës dhe herë pas here shtonin ndonjë ngjarje, jepnin ndonjë hollësi, kujtonin ç'kishin dëgjuar nga të parët. Ata ndienin kënaqësi t'u drejtoheshe për kohë të moçme, që ruheshin shumë më larg se kufiri i jetës të tyre. Rrëfimet e tyre herë vinin me jehonën e legjendave, herë legjenda pleksej me realen, sa s'dije ku të vije kufijtë e ndarjes, herë të tjera fakti vinte i

gjallë bindës e atëherë pleqtë thoshin me një siguri të patundur: «E kam parë me këta sy» ose «E kam dëgjuar me këta veshë».

Kisha gjetur dhe dokumente arkivore e memoriale që nga koha e sundimit turk e gjer në tridhjetenëntën. Kisha vënë re se ato nuk mund t'i zëvendësonin tregimet e pleqve, sido që kishin rëndësinë e tyre, se fakti, siç thahet në historianët, është piedestali mbi të cilin ngrihet historia. Por as turkut dhe as Zogut s'u kishte shkuar ndërmend ndonjëherë të linin të shkruara dokumente për historikun e fshatit tonë. Veç pleqtë thoshin se fshati ynë kishte qenë kockë e fortë, ishte ngrënë dhe me sulltanët, dhe me mbretin. Dhe kishin të drejtë. Kishin gjetur fermanë të lëshuara nga dora e egër e sulltanëve që nga Stambolli, për fshatin tonë, të mbushur me rrufe dhe bubullima. Kështu kishte ndodhur dhe me prefektët e Zogut, që kishin lëshuar sa e sa raporte sekrete për Ministrinë e Punëve të Brendshme, për këtë ose për atë ngjarje turbulluese, për këtë ose atë person rebel a të dyshimtë, për mungesën e bukës dhe për kërdrinë e sëmurdjeve. Dy logjika të kundërta ishin ndeshur gjatë shekujve: Ata që lëshonin fermane e relacione për ta tulatur ose shuar ekzistencën e tij dhe fshati që u bënte ballë dhe fermanëve të sulltanëve, dhe raprezaljeve të mbretit, për të qëndruar nën një shoshë qiell, mes këshjtjellave natyrore të maleve.

Po këto dokumente qenë të shkëputura, shpeshherë të pjesshme, periudha të tëra mbeteshin të errëta, nuk mund të jepnin atë vijueshmëri ekzistence që nuk ishte ndërprerë për asnjë çast. Historia e vërtetë e fshatit kishte jetuar e gjallë te njerëzit e tij. Ata ia kishin

pasuar njëri-tjetrit, në legjenda, në këngë, në ritet e vajit e të dasmës, në emrat e buzave, arave, kodrave e maleve, në kujtesat e këtyre pleqve me koka të zbardhura. Duke u marrë me historikun, kjo bindje më përforcohej çdo ditë e më shumë. Kisha shkruar dhe ndonjë reportazh në shtypin lokal e në gazetën «Zëri i rinisë» si dhe për ndonjë figurë patriotike me raste përvjetorësh. Unë kisha mbaruar shkollën e mesme për zooveterinari e po bëja vitin e dytë të stazhit. Letërsinë e doja shumë e këtë e dinin të gjithë. Mbase kryetari i këshillit më bënte qejfin kur më thoshte se po të shkruaja mirë historikun, më jepte fjalën se do të ndërhynte gjer te kryetari i Komitetit Ekzekutiv për të më dhënë të drejtën e studimit për letërsi dhe unë këtë e besoja, si besojnë gjithë njerëzit në atë që duan. Kryetari ynë ishte shumë i interesuar për historikun, komiteti kishte caktuar dhe një afat, brenda të cilit duhej të mbaronte patjetër dhe ai më pyeste gjithnjë. Po tani te tavolina ime kish-te ardhur për tjetër punë. Të nesërmen fillonte stërvitja ushtarake dhe unë duhej të shkoja në një kope për disa ditë për të zëvendësuar çobanët.

Aty për aty i thashë të më caktonte te stani i dhive të Çoçkos. U duk që këtë nuk e pris-te, se Çoçkoja ishte larg e me ca buza të frikshme.

— Mirë fare, — tha kryetari dhe vuri një shënim në një listë.

Mua më lidhte me Çoçkon pikërisht gjurmimi i fakteve të historikut. Kryebariu i kopesë së dhive ishte një plak që dinte për Bilibilenjtë e famshëm shumë gjëra e, mbi të gjitha, shpellën ku strehoheshin ata gjatë dimrit. Unë

isha përjekur ta takoja, po plaku vinte rrallë në shtëpi, thoshin se dhe ndërresat porosiste t'ia dërgonin atje. Aq më tepër tani, që ishte koha e pjelljes së dhive, plaku nuk shkëputej nga kopeja fare e s'bënte karar me punën e askujt.

Kishte dalë rasti, pra që të takohesha me të dhe s'duhej ta humbisja në asnjë mënyrë.

U nisa të nesërmen që herët në mëngjes. Stanin e dhive të Çoçkos e dija ku ndodhej, megjithëse po shkoja për herë të parë. Çdo njeri që ka bërë në këmbë rrugën Bënçë-Progonat, ose që ka udhëtuar me korrierë në rrugën e re automobilistike që është hapur e që të shpie në Kurvelesh e gjer në minierën e fosforit, është e pamundur të mos e ketë vënë re stanin e kopesë së dhive të Çoçkos. Gurra, që zbret me vërtik që nga burimet e maleve, e ka çarë në mes Çoçkon me Hijen e Zezë, dy faqe malesh të thepitura, me përrenj, hümnera, kuro-ra kreshtash, sa dhe ai që i takon të udhëtojë përditë, nuk mund të mos i hedhë sytë hetues e kureshtarë. I ngjan sikur diçka të re do të gjejë, se natyra nuk i ka kursyer bukuritë. Hija e Zezë, e prerë thikë, me zalle të bardha që varen gjer në lumë, sipër me kreshta shkëmbore e shkëmbinj të kuq, me maja të buta, me korije bredhi e burime, Çoçkoja përballë me të hyra e të dala, me çipinë të frikshëm që zënë fill që nga lumi e rebelojnë drejt qiellit çataj-çataj, si dhëmbë të çrregullt kafshësh prehistorike, përherë të shfaqin diçka të re. Pikerisht në një zall të bardhë, rrëzë një çipini, duken hajatat e dhiye dhe kasollja e çobanëve.

Për syrin Hija e Zezë dhe Çoçkoja janë afër, po udhëtari duhet të zbresë një rrëpirë thikë që me shumë kujdes duhet të mbajë kë-

mbët dhe, të arrijë gjer te stani, duhet t'i ngjitet së përpjetës për kurrizi saqë të bën të gulçosh e ta shtrydhësh këmishën nga djersa. Mua më porositën që, kur të zbritja në lumë, si të pija ujët e burimeve të ftohta, duhej të haja medemos para se të filloja të përpjetën, përndryshe s'kisha për të arritur dot te stani i kopësë së dhive. Ashtu bëra. Çipinet më qëndronin mbi kokë dhe gjithnjë e bëheshin më të mëdhenj e të frikshëm. Ngjante sikur ata ishin ngulur pingul mbi faqen e malit dhe ishin gati të shkuleshin prej tij me një gjëmë rrapëllyese. Ja ku strehoheshin Bilbilentë, mendova me vete. Vendi që i kishte lindur, u kishte gjetur dhe jatakun.

Në stan gjeta Çeçon, «ekonomatin», siç i thoshin atij. Më dha për të ngrënë kulloshtë të ngrirë dhe gjizë kaçupi. Kryebariu, plaku Babuden, u kthye me kopenë e dhive ndaj të ngrysur. Ardhenj time nuk e priti mirë. Në fillim bëri sikur s'më vuri re, pastaj zgjati dorën ftohtë:

— Si je, more djalë! Të paskan dërguar tani në valë të punës?! Do mbeten të gjitha shterpa. Po se mos i ha meraku ata!

La kërrabën e llabanen në kasolle dhe do li duke e porositur Çeçon që të ndizte fenerin dhe të vente te hajati i dhive. Për mua s'pyeti më nieri. S'dija ç'të bëia, të rrija në kasolle apo të shkoja pas tyre. Kisha ardhur çoban dhe jo të ruaja ziarrin. Logjika të thoshte se dhe unë duhej të isha në hajatin e dhive. Atje gjeta dhe shterparin, Dinen, një dialë të ri. Atë e njihja, se kishim mbaruar së bashku tetëvjeçaren. Hajati ishte ngritur gjatë gjithë rrëzës së shkëmbit, përpara kishte një vathë të rrethuar me gardh. Plaku Babuden ecte me fener

në dorë gjatë hajatit, kapte dhi, i kontrollonte, merrte kecër. Pastaj doli në vathë me tre kecër në duar.

— Kabadha, Balëmushka dhe Bricjapja duhen zënë e lidhur se s'i duan kecërit, — tha shkurt.

Ai ma dha fenerin mua, bëri disa hapa para, duke përkulur pak trupin, dhe me një të hedhur të shpejtë kishte kapur një dhi: që nën dritën e fenerit kraharori i merrte një ngjyrë të kuqe të errët. I foli Dines, i dha dhinë dhe kecin dhe eci përsëri përmes dhive. Vatha që pak e varur, kishte zënë një shi i hollë dhe vendi që bërë rrëshqitës. Plaku Babuden ecte me këmbët pak të hapura, sytë e tij sikur shkrepnin në mes të territ për të hedhur dritën atje ku i duhej atij. Dhe një hedhje tjetër e shpejtë dhe në duart e plakut u gjend e mbërthyer një dhi. U soll kështu herë nëpër vatha e herë në hajat më shumë se tre çerekë ore, gjithmonë duke bërë nga ato hedhjet e shpejta e të menjëhershme si ato të ujkut mbi gjahun e vet. Pse këtij njeriu i thonë plak, mendova me vete. Këmbët dhe sytë, që janë shenja dalluese të moshës, ai i kishte vënë në provë këtu para meje. Duhej të kishim shkuar kështu nëpër vathë e hajatit e dhive më shumë se një orë duke zënë njërin e duke e mëndur tjetrën, duke lidhur në fund të vathës e duke kontrolluar kecër që mund të mos kishin pirë. Plaku Babuden i dallonte ata se qëndronin të truar ose u vinte pëllëmbën e dorës nën bark, te mulla, i njihte se i kujt ishte dhe e kërkonte atë ta gjente në mes të tufës. Kur gjithë asaj ecejake i kishte ardhur fundi, plaku Babuden kishte marrë dy kecër në duar.

— Këta duhen ngrohur pranë zjarrit, përndryshe gjer në mëngjes ftohen.

Njëri dukej fare i ngordhur. Në kasolle plaku filloi t'i jepte shpirt duke i fryrë me frymë në gojë. Ishin ulur rreth zjarrit dhe me siguri unë e ndieja veten më të lodhur. Çeçoja bëri përslesh me qumësht, nxori shëllirë kaçupi të trashë si copë buke. Unë hëngra fare pak. Dreka më kishte vrrarë dhe stomaku im nuk ishte stërvitur të treste aq shpejt kulloshtrenë e shëllirën e kaçupit që i ngjante më tepër një djathi të yndyrshëm.

— Pse s'hëngre? — tha plaku. — Mos deshe të pije qumësht? Buka s'ka turp.

I thashë se e ndieja veten të rënduar nga dreka. Plaku drodhi një cigare, pastaj mori sharkun dhe shkoi të flinte në anë të vathës së kopësë së dhive.

— S'fle kurrë në kasolle, — tha Çeçoja, — edhe sikur të bien gurë nga qielli.

Ramë për të fjetur dhe ne të tre në kasollen e shtruar me panica lisi të mbuluara sipër me rrogoz.

Të nesërmen Çeçoja iku që herët në mëngjes. Plaku, para se të nisej me tufën e pëllave, më tha se detyra ime ishte të laja enët, të zieja qumështin, të ruaja keçërit se mos binte larashi e, po të mundia të shkoja të prisja ca degë ilqesh për t'ua hedhur keçërve. Gjethja e dimrit u qe mbaruar. Hipitë qenë poshtë, afër lumit e Dinia do të shkonte të ngarkonte mushkën. Nata e dytë qe dhe më e lodhshme. Kishin pjellë 30 dhi njëherësh. Na u desh t'i shkonim të gjitha nëpër duar e u kthyem në kasolle më vonë se natën e parë. Dhitë ishin në trivazin e pjelljes e katër nct njëra pas tjetrës ne pothuaj mblidheshim në kasolle ve-

-tëm sa për të ngrënë darkën e binim të flinim. Në mëngjes çoheshim përsëri herët, se duheshin përsëritur me dhitë e kecërit po ato punët e darkës, veçse i kryenim jo me fener, po me dritën e ditës.

— Mbase na mban koha dhe këto dy ditë, — tha plaku, — sa të mëkëmben kecërit, se tani e kanë mundimin, pastaj ecin me këmbët e tyre.

Pesë ditët e para kaluan të lodhshme e plot tension. Ajo puna e shpellës së Bilbilenjve të famshëm sikur ishte zhdukur nga horizonti i parashikimeve të mia. Për këtë plak s'kishte as të shkuar, as të ardhme, po dhi dhe kecër. Kur kishte pasur ai kohë të mësonte për Bilbilenj-të, siç më kishin thënë? Dinia e vuri re pakënaqësinë time për plakun. Unë s'i kisha folur asgjë për të, por ai sikur e kishte lexuar në sytë e mi. Njeriun s'e tradhton vetëm fjala.

— Babudeni ka një shpirt të mirë, — tha Dinia. — Si do dhitë e kecërit, do dhe njerëzit.

Ai i thërriste thjesht Babuden, unë xha Babuden. Tani edhe unë u mësova me punët e stanit si me një ritual. Mësova dhe emra dhish e kecërish, njoha disa prej tyre e dija se ç'duhej të bëja me ta. Ishte vërtet ashtu siç kishite thënë plaku. Në krye të javës punët qenë pakësuar. E dinim se kishim dy-tri dhi dhe kecërit oë do të mëndnim dhe kaq. Nië darkë xha Babudeni na tha të ndiznim të dy fenerët. Ishte e premtë. Do të rrinim gjer vonë. Na ishte gremisur nië dhi nga buza, kishim pjekur mish, kishim dhe raki nga fshati dhe do pinim.

— Sonte ta shohësh Babudenin, — tha Dinia.



Si tavolinë na shërbente një fron i bërë me ashra të lëmuara lisi. I kishte bërë Çeçoja. Ai ishte mjeshtër i gdhendjes së drurit. Dukej sikur i kishte shkuar sipër zdrukth. Kishim dy filxhanë. Plaku e kthente me një shishe arançate. Kishim atë meze që i duhet rakisë: mish të pjekur, shëllirë kaçupi dhe qepë të sjella nga fshati.

Xha Babudeni na detyronte t'i kthenim filxhanët plot. Edhe ne i vinim një shenjë, në shishe që ta kthente gjer atje menjëhere.

— He, — më ngacmonte mua, — ti je djallë me shkollë, na trego, ç'ke lexuar në ata libra? E di atë historinë e Gjolekës që vrau Kaftanazin? — Dhe fillonte ta tregonte vetë:

— Gjolekën e mbante si trim Kaftanazi. Ai ish vetë i dytë me një shqiptar tjetër. Kur erdhi valiu i Janinës në Manastir të Bitolit, e pyeti se nga i kish këta dy trima. Arnaut, i ish përgjigjur Kaftanazi. Arnautët, po të kishin qenë të zotë, kishin mbrojtur njeriun e tyre, ish hedhur valiu. Ai e kish fjalën për gjyshin e Ismail Qemalit, që e kishin vrarë turqit pabesisht në Janinë. Kaftanazi kishte qeshur me ligësi. Gjoleka me shokë e vunë vath në vesh fjalën e Valiut të Janinës dhe të Kaftanazit. Ata u mbloodhën dhe vendosën të vrisnin Kaftanazin. Hodhën shortin dhe ai i ra Gjolekës. Kaftanazin e vrau në saraj, kur po pinte kafën e sabahut, me një shtatëshe. Krismat dhanë alarmin në saraj. Kur gjetën të vrarë Kaftazin, kush e vrau, pyesnin të llahtaritur ata që hynin e dilnin, kush e vrau pyeste dhe Gjoleka, gjersa doli në rrëmuje e sipër dhe ia hipi kalit, që e priste jashtë, e fluturoi si era. Mbase e ke dëgjuar atë këngën, përfundoi plaku: Tafil Buzit të m'i thoi/ Gjoleka

s'e turpëroi/ Kaftanazin e martoi/ me të shtata  
ia numroi/ nëpër dyzet mijë shkoi.

— Eh, ç'trimë kanë qenë! — turfulloi plaku dhe na ftoi t'i pinim filxhanët me fund.

Ai po bëhej në qejf dhe mua m'u ndezën shpresat se diçka mund të vilja nga ky plak. Doja që ashtu në mënyrë të vetvetishme ta nxirrja në bisedë për Bilbilenjtë.

Dhe ky rast u krijua papritur.

— Ç'ditë është sot? — pyeti plaku.

— E premtë.

— Dine ndizua radion, se ka atë orën e muzikës popullore.

Unë shikova orën. Kishte 17 minuta që kishte filluar emisioni me muzikë popullore sipas kërkesave të dëgjuesve.

Në stan kishim një «Orion» me bateri. E ndezi Dinia dhe në atë çast po jepej vallja e kënduar e Bilbilenjve nga grupi popullor i Progonatit.

— Bjereni këtu! — tha plaku dhe e vuri radion pranë vetes.

Ai ishte ngrehur dhe, si m'u duk mua, fytyra i kishte marrë një pamje solemne, si në rastet kur këndohen himnet. Çfarë coincidençë e shkëlqyer, përsëritja me vete dhe e ruaja xha Babudenin për çdo fjalë që do të nxirrte nga buzët.

— Ata ishin katërbëdhjetë, — tha plaku, sikur të fliste me vetveten.

— Pse katërbëdhjetë? Trembëdhjetë, kështu thotë dhe kënga: «Bilbilenjtë trembëdhjetë, vanë në litarë vetë».

— Kënga e thotë mirë. Po kënga këndon për trembëdhjetë që u varën, i katërbëdhjeti mbeti gjallë.

— Si mbeti gjallë? — thashë unë me një ndjenjë mosbesimi.

— Ata qenë katërbëdhjetë. Dy prej tyre qenë vëllezër. Avduli dhe Islami. Avduli qe i martuar po s'kishte fëmijë. Islami qe djalë i ri njëzetvjeçar pa dirsur as mustaqja. Kur Bilbilentë vendosën të dorëzoheshin, Islamin nuk e dorëzuan. Ata e dinin se ç'i priste. Për të mos u shuar një derë, vëllanë e vogël të Avdulit, Islamin, e dorëzuan te një kryemurator, mik i tyre.

Ia lanë me besa-besë. Islami ndërroi emër, punoi murator më shumë se 20 vjet. Kryemuratori i bëri sarajet një arhondi në Janinë. Aq u kënaq ky, sa, kur do merrte çelësat në dorëzim, i tha kryemjeshtrit të hapte gojën ç'kërkonte tjetër mbi pazarin që kishin bërë. Kryemjeshtri i qe përgjigjur se vërtet kërkonte diçka prej tij, po më parë t'i jepte besën. Arhondi qe ndodhur ngushtë dhe ia kishte dhënë besën. Atëherë kryemjeshtri i tregoi se një nga muraorët e tij ishte i 14-ti i Bilbilenjve të famshëm dhe i tori gjithë historinë. Arhondi ndërhyri te valiu i Janinës për të 14-in e Bilbilenjve doli fermani i faljes. Ai u kthye në fshat, u martua dhe la një djalë. Ti duhet të kesh nxjerrë në historik Nuredinin, ai ishte njeri i penës. Nuredini lindi dy djem që jetojnë dhe sot, — dhe ai më tha emrat e tyre. — Islamin, një burrë të gjatë, me çepe e fustanellë të bardhë, e ka arritur dhe babai im, e ka parë siç të shoh unë ty. Bilbilentë nuk janë shumë të largët. Te rrapi i Janinës, kur janë varur, i ka parë me sytë e tij Rushit Jupja, ushtar i turkut, topçi, që i qenë shurdhuar veshët nga buçima e topit. Ai ka vdekur në ditët e mia. Kështu është historia e të 14-tit,

— përfundoi plaku me një siguri që s'kisha si ta kundërshtoja.

Ai i radhiste faktet përpara syve si në një diapozitiv. Unë kisha gjetur dokumente për Nuredin Islam Goxhën, që i dërgonte libra klubit patriotik «Arbëria», po nuk e dija se ky ishte pjellë e njërit prej Bilbilenjve që kishin mbetur gjallë. Për fundin e Bilbilenjve më kishte dalë dhe një variant tjetër, që ata nuk ishin dorëzuar vetë, por ishin kapur tradhtisht. Ishin gjendur të rrethuar në një fshat, ishin veshur si gra për të dalë nga rrethimi, po në castet e fundit një tradhtar i kishte kallëzuar e ata ranë në dorë të turkut, pa nxierrë shpatat nga milli e pa lëvizur gishtin. Kur i tregova këtë histori, fytyra e plakut u nxi, m'inguli sytë sikur të më përpinte dhe s'më la ta mbaroja gjer në fund.

— Kush është ai zuzar e faqezi që hedh baltë mbi trimat?! Po të kishin veshur citjanet e grave, ata burra s'do të kishin ardhur gjer te ne t'u këndohej kënga. Qysh ta nxë goja atë fjalë.

Plaku ishte zemëruar! Unë s'kisha si t'ia shpjegoja se kisha nevojë për këto ballafaqime. Kjo ishte dhe detyra ime, jo t'i fshihja, po të gjurmoja gjithçka, se kështu do të dilte më mirë e vërteta. Veç kësaj, plaku e shikonte tani problemin edhe në planin etik. Vërtet ai fund sikur i zbehte Bilbilenitë, po fakti është fakt dhe historia histori. Edhe Pirroja i Epirit ishte vrarë nga një tullë. Po s'kishe si ta ndryshoje.

— Do më ballafaqosh me këtë njeri! — shpërtheu përsëri plaku! — Do t'i lë dhe dhitë në mes të sheshit dhe do të vij vetë në fshat. Po nuk më thua, — dhe plaku lëvizi nga

vendi duke zgjatur trupin drejt meje, — po mjekrat gjer në brez ku i futën, i mbështollën me shamitë e grave pas kokës? Po trupat e mëdhenj si diva, i holluan e i zvogëluan si të grave?

O zot, ç'u pjell mendja të ligjve. Po vete 70 vjeç dhe këtë s'e kam dëgjuar. Gjyshi im ish miku i tyre e babai i ka parë dhe ai me sytë e tij. Te ky stan Bilbilenjtë vinin përherë. Babai e gjyshi e bënë kasollen pak më lart, në rrezë të shkëmbit. Ata trima këtu kanë ngrënë e kanë pirë, kanë kënduar e hedhur valle. Tej këtyre çipineve të monesë kanë pasur shpellën ku kalonin dimrin. Unë kam vajtur vetë në atë shpellë dhe kam dëshmi një kamë te tyre që gjendet atje edhe sot. Babai më ka treguar se ata u nisën të dorëzoheshin nga kjo shpellë dhe s'kishin pse të visheshin me çitjane të grave.

Unë mezi e përmbajta veten nga gëzimi dhe desha t'i hidhesha plakut në qafë. Një kamë nga Bilbilenjtë! Ky do të ishte një relik i çmuar për muzeun tonë të fshatit. Si s'e kisha dëgjuar nga njeri këtë hollësi! Si nuk ma kishte thënë plaku që në fillim?

— A mund të vemi në atë shpellë?! — thashë unë.

— Që nesër! — tha plaku dhe rrahu gjurin me pëllëmbë të dorës. — Unë kam qenë vetëm njëherë. Më ka shpurë babai. Vetëm ai e dinte hyrjen e fshehtë të saj. Po ti s'do të futesh dot. Ah, të kishim Çeçon! Ai e rreh buzën mirë e të dy do të të kishim futur, — tha plaku.

— Edhe unë e rrah buzën.

— Që kur kështu? Ti ke qenë në shkollë e jo me dhi.

— Djalë vendi jam. Nëna më ka rritur jetim. Ajo më merrte me vete kur mblihte dafinë buzave për ta shitur.

— Fare mirë. Do ta shikosh atë shpellë me sytë e tu. Paç uratën, mor djalë! Se dhe unë u plaka e do të vdes. Ti më trokite në zemër. Ne jemi dhënë pas mallit, se jemi rritur me të shkretat e s'ndahemi dot. Po udha për tek ajo shpellë s'duhet të mbetet e fshehtë. Ne do t'jua lëmë juve dhe ju të tjerëve. Që nesër, — tha përsëri dhe rrahu gjurin me dorë.

Si kthyem dhe ca gota, kur erdhi koha të flinim, plaku, si zakonisht, mori sharkun dhe shkoi të shtrihej në anë të vathës së dhive, kurse ne të dy në kasolle. Mua s'po më zinte gjumi.

I mbuluar në sharkun me flokë të butë, mundohesha që përfytyroja shpellën me hyrje të fshehtë dhe diku në atë shpellë, një kamë, që e kishin kapur duart e atyre trimave që kishin mbetur për njerëzit kaq të famshëm.

E ndieja se nata e janarit do të më dukej dhe më e gjatë se ç'ishte në të vërtetë, prandaj përpiqesha t'i largoja mendimet e të më zinte gjumi. Kështu, pa e kuptuar, do të vinte dhe më shpejt e nesërmja. Atë mëngjes i pari u zgjova unë dhe i fola Dines të çohesh të ndizte zjarrin. Edhe plaku Babunden erdhi më herët. Ai dha planin e ditës.

Me tufën e pëllave do të vinte Dinia. Plaku po i jepte porositë e fundit se ç'tragë do të ndiqte djali, duke i përmendur emra vendesh ku do të kulloste kopenë. Ishte hera e parë që ai ia linte tufën e pëllave një tjetri, më tha Dinia. Unë e plaku shkulëm tufën e shterpa-

ve. Ai i ktheu dhinë poshtë një hosi dhe më shpjegoi se ato do të zbritnin gjer poshtë në lumë, pastaj do të rrotulloheshin gjatë rrethit të një buze dhe darka do t'i zinte te no-maja. Pas kësaj ne u nisëm të dy drejt Shpellës së Bilbilenjve. Plaku Babuden ecte para, unë pas tij. Ai kishte shkuar në mes të dy bërnylave një shkop të thantë të mbështetur pas kurrizit. Në brez kishte vënë një cekurë të vogël.

Këmbët i hidhte pak anash, po me aq siguri, sikur ato të ngjiteshin pas rrëpirave dhe shkëmbinjve ku shkelnin. Unë i hidhja hapat me kujdes, duke hetuar vendin. Plaku ktheu një herë kokën pas dhe, kur më pa se po e ndiqja, e vazhdoi rrugën pa folur. Vendi ishte shumë i thyer. Herë zbritnim gjer afër lumit e herë-herë ktheheshim mbrapsht për të dalë te një shteg që unë mezi orientohesha. Herë pas herë na dilnin hose, zaje të bardha, çipinë që e prisnin hapësirën në mes dhe asnjëherë s'mund ta kuptoje se nga ishe nisur. Dhe pas dhe përpara filli i rrugës ishte gjithmonë i këputur. Plaku mbante një lloj të ecuri e s'foli asnjëherë gjatë rrugës. Ne dëgjonim veç hapat e njëri-tjetrit. Unë dëshiroja ta pyesja, po më dukej sikur plaku Babuden do të ndalej para këtij apo atij hosi të frikshëm, para kësaj ose asaj shpelle dhe do më thoshte: ja, arritëm. Dhe kisha të drejtë. Me sytë e mi kisha parë shumë hose, buza, hone që mund të ishin jata-kë të sigurt, ku shokë të kishe vetëm zogjtë e sipër një copë qiell dhe diellin, në orë të caktuara të ditës. Po në ecnim e ecnim pa folur dhe me siguri, jo vetëm mua, po dhe plakat, na shfaqej i gjallë imazhi i Bilbilenjve që kushedi sa herë i shkelnin këto humenera, shkë-

mbinj e buza. Ja, këtej duhej të kalonin, mendoja, kur vinin te stani i gjyshit të plakut Babuden, ndofta këtë rrugë ata e bënë natën dhe ky mendim m'u duk pak i pabesueshëm, kur edhe ditën ishte vështirë t'i shkelje këto vende. Po ata ishin Bilbilenjtë, qortova vetveten, Bilbilenjtë që kishin kaluar male të larta të mbuluara nga dëbora në kërthizë të dimrit, që kishin çarë darën e sa rrethimeve dhe, ndërsa komandanti i ushtrisë turke priste t'i sillte hajtë të gjallë ose kokat e tyre, Bilbilenjtë hynin dhe e vrisnin në çadër. Ata i kish mallkuar allahu, në bark kishin shejtanin, s'i vriste as plumbi, s'i priste as shpata, s'i shihte as dielli, as hëna, s'i zinte as era. Ishin vetëm xhinde që silleshin nëpër natë. Kështu thoshin turqit. Këto thënie i kisha shkruar dhe në historik. Po do të shtoja se dhe unë kisha shkëlur ku kishin shkëlur ata, se dhe unë kisha parë me sytë e mi shpellën e ku strehoheshin, kisha kapur me dorën time kamën. Kjo më ngjallte emocione. Eh, sikur ajo kamë të ishte e ngulur atje në shpellë, siç thoshte plaku Babuden.

Ndërkaq po i ngjiteshim një çipini. Maja e tij sa vinte e hollohej dhe rruga ku po shkelnim (në të vërtetë s'ishte rrugë) po ngushtohej shumë. Ndofta diku papritur do të shfaqej një shteg, të cilin me siguri do ta linim pas, siç kishim bërë shpesh gjatë këtij udhëtimi. Kur u ngjitëm gjer në majë, plaku qëndroi.

— Ulu merr frymë, — tha dhe u ul edhe vetë, nxori kutinë dhe drodhi një cigare.

Unë mbusha mushkëritë me ajrin e pastër, të athët e të ftohtë. Mbi këtë çipin ishim si mbi fronin e qiellit. Papritur hapësira që zgjeruar, vështrimi të hapej në të gjitha anët dhe dielli na shikonte me syrin e tij të madh



nga qielli i kulluar i ditës së janarit. Tani sikur isha çliruar nga ato hapësira të ngushta që na kishin shoqëruar gjatë gjithë udhëtimit. Sipër nesh dukej kreshta e Çockës, horizonti i kaltër, që pritej diku, të ngjante se mund t'i kapje me dorë, ndërsa para, majtas, djathtas relievi i rrafshnaltës së Kurveleshit. Soditja peizazhin e vendlidjes nga ky çipin dhe më dukej sikur e shikoja për herë të parë. Maja e Pusit të Borës, Mali i Thatë, Këndrevica, Kanatai, Gradishta, Stoku, të çarat e menjëhershme midis tyre, humnerat, buzat, rrjedhat e Gurrës së mistershme, që këtu humbiste, këtu dilte me kaltërsinë e bardhë të zajeve të shfaqnin plot befasi bukuri të reja që të bëjnë të thuash: Çudi! Si nuk i paskam vënë re më parë!

— Te këta dy çipinë Bilbilentë linin nga një rojë, — prishi heshtjen plaku. — Futeshin në këta thepat e s'i dalloje dot as nga afër, — dhe ai tregoi shkëmbin pas krahëve. — Kontrollonin vendin nga të gjitha krahët: Rrugën e Hijës së Zezë që vinte nga Tepelena, Buzën e Bredhit, Lerat, Gradishtën dhe Stokun. Krahët i kishin të mbrojtur nga mali e nga sipër këtu s'të sjell asnjë shteg.

Po i vëzhgoja me kujdes të dy çipinët. Natyra kishte krijuar një çudi: dy minare të vërteta prej shkëmbi, sikur t'i kishte daltuar dora e njeriut. Çipini përkrah sa vinte e hollohej nga maja, po ata që të dy bashkoheshin në një masë shkëmbore të përbashkët. Ishin me të vërtetë dy pika vrojtimi të përsosura.

— Po shpella a është larg që këtej? — pyeta unë i paduruar.

— Shpella është këtu, nën këta dy çipinë. Vështrova përsëri masën e shkëmbit poshtë

nesh dhe aty s'dukej asnjë shenjë shpelle, veç humnera që varej gjer në lumin që buçiste.

— Këtu poshtë nesh është shpella! — përsëriste plaku, që e vuri re habinë time. — Ja, ne do të zbresim atje tek ai shkëmbi i kuq ku bashkohen dy çipinët. Do të zbresim gjatë këtyre thepave. Kështu i kishin shkallët Bilbilentjët, — bëri shaka xha Babudeni.

I ishim ngjitur çipinit nga ana e sipërme dhe do t'i zbritnim nga ana e lumit në një largësi që duhej t'i arrinte të pesëdhjetë metrat.

Plaku u ngrit dhe zgjidhi nga mesi litarin nën pallto, që unë tani ia dalloja.

— Ti do të zbresësh i pari, — dhe ai ma zgjati atë që të lidhesha.

— Zbres dhe pa litar, — thashë unë.

— Këtë herë, meqë e kemi, kështu do të bëjmë. Tani fillo. Mos harro, do të qëndrosh te shkëmbi i kuq.

Kur kisha zbritur, dëgjova zërin e plakut që lart:

— Ki mendjen! Do të të lëshoj litarin, mos të vret ndonjë gur! — Dhe filloi të zbriste dhe vetë.

Kur u bëmë të dy bashkë, ecëm gjatë një petaraqi, jo më i gjerë se dy pëllëmbë, që të shpinte te çipini tjetër. Petaraqi i vinte përreth dy herë, si ato spiralet e vidave, në fillim duke u ngjitur, pastaj duke zbritur e të nxirrte te masivi i shkëmbit me faqe nga lumi. Do të zbritje gjashtë-shtatë shkallë mëteposhtë dhe do të ecje faqes së shkëmbit, gjer te një ilqe, ku dilte një bërryl e shtegu ndërpritej. Këtu qëndruam. Ku ishte shpella? Mos vallë pas kësaj ilqeje me degë të gjelbra, me rrënjët të mbërthyera mbi shkëmb, te pleksura e të stërpleksura, që tregonin me ç'përpyekje kishin ç-

rë gurin e kuq, po dhe me ç'siguri ishin ngjitur pas tij?! Plaku Babuden preu te ilqja tri kërraba dhe unë s'po merrja vesh ç'i duheshin. Ai filloi të vepronte pa folur. Vari kërrabën në një degë që kalonte mbi kokat tona dhe filloi të ecte brinjas shkëmbit, duke u mbajtur nga bishti i drurit të varur, la kërrabën e parë varur dhe hodhi të dytën, duke ecur në të njëjtën mënyrë, hodhi dhe kërrabën e tretë në një degë më tej. Trupi i tij rrëshqiti pas bërrylit dhe unë nuk e pashë më.

— Nisu! — u dëgjua zëri i tij, me një akustikë të çuditshme dhe jehona zbriti gjer në lumë.

U nisa duke imituar veprimet e plakut dhe pas pak u ndodha në hyrje të shpellës. Tjetri kishte qëndruar në këmbë para meje dhe më priste. Zbrita dhe tri-katër shkallë që dukej se ishin ngrënë nga dora e njeriut dhe u ndodha përkrah plakut.

— Ja shpella! — tha shkurt xha Babudeni, si për të më kujtuar se ndodhesha para një dëshmie të pakundërshtueshme. Mbi kokat tona lakohej harku i grykës së saj pak i mbledhur, pastaj fillonte kubeja duke u zgavruar. Diellin e kish përpara, po s'arrinte ta ndriçonte të gjithë. Plaku para dhe unë pas tij ecëm mes për mes dhe dëgjonim trokun e hapave. Drita sa vinte e pakësohej dhe pak më tej fillonte mugëtira. Në të dyja anët kishte plot kthina e xhepa, saqë dhe vështrimi im kureshtar nuk mund t'i rrokte menjëherë të gjitha. Ecëm përpara drejt errësirës dhe mbi kokat tona filluan të fluturonin pëllumbat.

— Këtu pëllumbat bëjnë foletë, — tha plaku.

Dëgjoheshin gugutë e tyre, që ngjanin si rën-

kime. Unë nxora shkrepësen dhe po ndizja fijen njëren pas tjetrës për të ndriçuar rrugën. Errësira që bërë e plotë. Në njëfarë vendi shpella fillonte të ngushtohej, se kthehej në një tunel të vërtetë e tavani i saj nuk ishte shumë larg kokave tona. Qëndruam.

— Fundi s'i dihet, — tha plaku Babuden. — Po e kemi bërë një gabim, — qortoi veten. — Duhet të kishim marrë fenerin. Babai më ka thënë se kjo shpellë ka dalje nën krahët, të Çoçkos. Bilbilentë në çdo rast nevojë ecnin gjatë këtij tuneli e i dilnin në anën tjetër malit.

— A e ka provuar njeri?

— Asnjeri gjer tani. Që të mos gënjej, këtë as e kam dëgjuar, as ma kanë thënë. Po në anën tjetër të malit ka plot sterra, ato i kam parë dhe vetë.

Vazhdonin të dëgjoheshin gugutë e pëllumbave e shpesh fluturonin aq afër, sa nga përplasjet e krahëve të tyre na shuanin dritën e fijeve të shkrepëses. U kthyem. Dolëm përsëri te kufiri i dritës. Po ku ishte ajo kama për të cilën më kishte folur plaku? Si të thuash, ajo do të ishte dëshmia që e bënte këtë shpellë të Bilbilentëve.

— Tani ti do kamën, — tha plaku Babuden, që e kishte vënë re se sytë e mi kërkonin nga të gjitha anët. — Më ndiq pas!

U kthyem nga e majta, kaluam një kthinë dhe u ndodhëm në një xhep. Ajo ishte një shpellë e vogël brenda shpellës. Këtu drita zbehej e hapësira zvogëlohej.

— Ja, këtu ndiznin zjarrin. Shikoje shpellën, e nxirë nga tymi.

Në të djathtë mua më vajti syri te kama e ngulur në shkëmbin e shpellës. I pari shkoi

plaku Babuden dhe me dorën e tij lëmoi dorezën e kamës, pastaj përkuli kokën dhe e puthi. Unë eca drejt saj, sikur të ecja drejt Bilbilenjve. Ja, ku e kisha përpara kamën e tyre. Ata ishin të pranishëm te kjo kamë, siç ishin të pranishëm te kënga, te kujtesa e pagabuar e këtij plaku, te kujtesa e brezave. Kapa dorezën prej briri me një dorë, pastaj me dorën tjetër. Plaku Babuden, që kishte ndjekur këtë veprim timin, i mbërtheu dhe ai të dyja duart njëri pas tjetrit mbi të miat dhe qëndronim të dy pa folur. Ishte një betim para kujtimit të trimave.

— Në dorezën prej briri ka diçka të gdhendur. — foli plaku.

Ndezëm një fije shkrepëseje. Në anën e djathtë ishte skalitur një siluetë e vogël që paraqiste një komit me shpatën varur në brez, me fustanellë, qëndronte në këmbë, me vështrimin të tretur përpara. Ishte e habitshme si ishte e ngulur maja e saj në një të çarë shumë të hollë të shkëmbit, sa s'hvnte as presa e briskut. Tunda bishtin e saj dhe tehu prej celiku u lëkund plot vibrime. U ulëm të dy te vendi i zjarrit, në të dvia qoshet, përballë njëri-tjetrit. Unë isha mbërthver nga emocionet dhe s'flisja. Përietoja me të gjitha hollësitë ato që kisha parë në këtë shpellë.

— Kështu si unë e ti tani janë ulur dhe ata këtu rreth zjarrit. — foli plaku Babuden. — Këtu përcinin mishrat në hell, këtu bënin planet dhe merrnin vendimet. Këtu... — dhe unë përfytyroja 14 Bilbilenjtë, të ulur përkrah njëri-tjetrit, me fustanella të bardha, me shpatat në brez, me mjekrat e gjata, me cepetë e hedhura mbi supe. Na shkonin mornica në trup. Po doja t'i përmbaja emocionet dhe përpiqesha të

hyja në rolin tim të historianit. S'duhej ta humbisja rastin, kur edhe plaku që i lidhur me shumë se kurrë me Bilbilenjtë të kjo shpellë dhe në të tilla raste kujtesa ndizet e zgjon dhe kujtimet më të largëta e të fashitura.

— Përse quheshin Bilbilenj? — pyeta.

— Këtë pyetje e kam bërë edhe unë, — tha plaku. — Ca thonë se çeta kishte disa veta me emrin Bilbil, po ne njohim vetëm një me këtë emër, kapedanin e tyre nga Rexhini, Bilbil Shakon. Emrin e kapedanit të tyre mori edhe çeta. Dhe me këtë emër kapnin turkun në grykat e maleve, rripnin bejlerët, agallarët dhe arhondët. Paratë kurrë s'i mbanin për vete por ua shpërndanin fukarasë, pleqve pa binà, të verbërve dhe sakatëve, ua bënëin pajë vajzave jetime. Ata s'qenë hajni, kusarë, siç i shante turku. Kusari është kobar, ata ishin trima e fisnikë. Luftonin kundër halldupit. Dhe shkak për kapjen e Bilbilenjve u bë një arhond, Xhelili i Voshtinës, — vazhdoi plaku. — Ky qen i turkut u ishte vënë Bilbilenjve t'i kapte. E trimat ia kthyen shpërblimin. Shkuan në Voshtinë, i rrethuan sarajin dhe i vunë zjarrin, ta digjnin dhe atë brenda. Por ai mundi të shpëtonte duke ikur nga një dalje e fshehtë. Thonë se i veshur copë e çikë, ditën e xhuma, kur sulltani shkonte për t'u falur në xhami, i doli përpara karrocës së tij, ashtu i veshur tebdil. Sulltani qëndroi e pyeti. Ç'është ai leckaman që guxon të më presë rrugën?! Xhelili ish përrulur gjer në dhe e kishte thënë:

«Jam një rob i Allahut e i padishahut, që bën diell mbi dhe. Po qysh nën këtë diell bëjnë hije dhe hajnitë Bilbilenj që më don gjën e më shkretuan mallin e gjënë e më lanë kështu siç më sheh. Dhe vetë sulltani që nga Stambolli nxori ferman për Bilbilenjtë. E

mallkoi druri e gurit, e mallkoi kënga Xhelil Voshtinën: «Lanet pastë Xhelil Voshtina/ vrave trembëdhjetë trima!»

— Të ngrihemi, — tha plaku, — se historia është shumë e gjatë.

Kur dolëm në hyrje të shpellës, sytë na rrudheshin nga drita. Ne ecëm gjer në buzë të shkëmbit, ku thyhej humnera gjer në lumë.

— Këtu është shtegu i tretë, Shtegu i Pllakës. Ja, zbret këtu te këto dy shkallë, në fund të pllakës është ajo mbretja, varesh hosit më tëposhtë gjer në lumë dhe del te Kulla, te Shtegu i Mullirit, hidhesh në Gradishtë te Shpella e Labovitit për në fshat. Kështu ata mund të dilnin nga të tri drejtimet, si t'u dilte puna. Nga Shtegu i Ilqes që erdhëm ne në drejtim të Hijes së Zezë, nga tuneli i shpellës për të dalë pas malit të Çoçkos dhe nga ky Shteg i Pllakës, që i lidhte më shumë me fshatrat e tyre të vendlindjes. Atë ditën e mynxyrës së shkurtit, kallauzi u erdhi nga ky shteg. Thonë ishte një grua. Ajo u tregoi se ç'po ndodhte në Kurvelesh dhe në gjithë Labërinë. Ushtria turke kishte pllakosur vendin. Kishin zënë grykat dhe shtigjet. Kishin lidhur burrat për t'i nisur për Janinë. Thonë se në Progonat turku i kish nxjerrë jashtë në mes të borës gratë e fëmijët dhe nëpër shtëpi që futur ushtria. Llahtar më i madh nuk ish parë. Dridhej foshnja në bark të nënës. Tregojnë se tri gra, nga sikleti, i lindën fëmijët të vdekur.

«O Progonati me vulë /shtatë pashallarë u çkullë,/ e bënë sa doli ujë!» Këto vargje më erdhën vetiu pas gjithë atij tregimi të plakut. S'e bëja këtë për të treguar «se dhe unë diçka dija». Këto e vargje të tjera në anët tona këndohen në çdo festë e gosti. Po ja, ato që po tregonte plaku, e

kishin reflektimin te këto vargje, e unë, si një historian diletant, po provoja dhe vetë atë që e kisha dëgjuar e lexuar shpesh se populli e tregon historinë me këngë, se kënga është vetë historia e tij. Dhe plaku vazhdoi:

— Për të shpëtuar popullin nga mynxyra që e kish zënë, ata vendosën të dorëzoheshin vetë. Siç të thashë, të katërmbëdhjetin, Islamin, e çuan te miku i tyre nga Bënça, te kryemuratori. Bilbilenjtë, të lidhur me zinxhirë, i shkuan në të gjitha fshatrat e Labërisë e të Kurveleshit. Të dy kapedanët, Bilbil Shakua dhe Resul Sejдини ishin hipur në kalë, se për halldupin, dhe të lidhur, kishin hije të rëndë. Kur dolën nga Progonati, plasi ulërima. Kush nuk e dinte që ata nuk do të ktheheshin më.

— Pse kënga i lidh Bilbilenjtë me Progonatin? — pyeta unë. Se dhe fshatra të tjera thoshin se kishte pasur trima në çetën e Bilbilenjve dhe për këtë doja të dija dhe mendimin e plakut Babuden.

— Progonati ka qenë në ato kohëra një nga kryeqendrat e fshatrave të Labërisë. — foli plaku. — Shtatë-tetë prej tyre, — dhe plaku filloi t'i thoshte emrat, — ishin nga Progonati. Po c'u bë në Progonat, u bë dhe në fshatrat e tjera. Kudo kujë e mynxyrë. Turku e kish provuar për sa e sa viet dhe s'i kish zënë dot Bilbilenjtë. Ata iatak kishin gjithë Labërinë, që nga Delvina e Gjirokastra e në lumë të Vlorës. Mbase e ke dëgjuar që në Tërbaç të Vlorës dhe sot një shpelle i thonë «Shpella e Bilbilenjve». Doemos gjithë këto fshatra kishin dhënë dhe djemtë e tyre. Ceta luftoi jo një vit, po më shumë se dhjetë vjet. Gjatë kësaj kohe nga çeta e Bilbilenjve, erdhën dhe ikën, u vranë e morën plagë. Ndaj, nëse e thonë, të drejtë kanë. Ata të trembëdhjetë,



që i këndon kënga, janë të atij vitit të mynxyrës së madhe, që u varën te rrapi i Janinës. Kam dëgjuar se dhe Lekdushi, dhe Golemi, dhe Kuci kanë pasur Bilbilenj. Po se mos vetëm këta. Ti me shokë, po të shkoni fshat më fshat, do t'ua gjeni dhe emrat. Bilbilenjtë kanë qenë të gjithë Labërisë e gjithë Labëria mburret me ta. Dëshën dhe me vdekjen e tyre të lehtësonin popullin. U dorëzuan për t'i shpëtuar fëmijët, gratë dhe pleq-të. Po mynxyra mbeti që mbeti.

Fjalët e fundit të plakut tingëllonin si një qortim për trimat.

— Po tani që të tregova gjithë ç'dija, e ti pe me sytë e tu dhe shpellën e kamën e tyre, dua të të bëj një pyetje.

Plakut papritur i kishte rënë një hije e rëndë në fytyrë dhe kjo donte të thoshte se pyetja që do të më bënte kishte shumë rëndësi për të e veç kësaj atë diçka e mundonte. Po çfarë dija unë para këtij plaku për Bilbilenjtë dhe me se mund ta shuaja kureshtjen e tij?

— Do të të pyes për një gjë, — përsëriti plakun, — dhe nuk dua të më bësh qejfin, po të më përgjigjesh hapur, ashtu siç e mendon dhe gjykon ti.

— Patjetër, patjetër! — thashë unë me një ndjenjë të thellë mirënjohjeje para historianit tim.

— Bilbilenjtë qenë te kjo shpellë atë shkurt, kur turku kish mbyllur si në çark Kurveleshin dhe Labërinë. Si thua ti, sikur të vinte dhe vetë sultani me gjithë ushtrinë e Turqisë, a do kish mundur t'i diktonte dhe t'i kapte te kjo shpellë?!

— Jo! — u përgjigja prerë.

Plakut iu mbushën sytë me dritë. Përgjigjja ime ishte përfundimi i një hetimi të gjatë për çetën e Bilbilenjve. Kisha pyetur, kisha gër-

muar nëpër arkiva e libra. Udhëtarë, kronikanë, historianë të ndryshëm i përmendnin Bilbilenjtë si luftëtarë të famshëm të dalë nga gjiri i popullit. Por ata veç përmendnin emrin e çetës dhe famën e veprës së tyre dhe s'jepnin asnjë hollësi, bie fjala sa kohë veproi çeta, cilët qenë anëtarët e saj, si ranë në duar të turkut. Ky plak ishte arkiv i gjallë i Bilbilenjve. Kisha dëgjuar dhe tregime të pleqve të tjerë. Ata përgjithësisht të jepnin një informacion, aq sa dhe këngët e shumta për ta. Po duke dëgjuar plakun Babuden, vija re se ai nuk ishte asnjë komentues e as një ilustrues i këngëve. Pa dyshim që ato kishin rëndësinë e tyre. Po historia do dhe më shumë. Dhe plaku Babuden të jepte truallin ku kishte mbirë dhe vetë kënga. Dinte emrat e të katërmbedhjetëve, të jepte aq hollësi për familjet dhe ata vetë dhe më në fund kjo shpellë dhe kama ishin si dëshmi materiale se ai fjalën nuk e hidhte në erë. Tani për Bilbilenjtë kisha një material më të bollshëm e kisha sqaruar disa pika të errëta. Po të dhënat e plakut të hapnin horizontin për të gjurmuar më tej. Sidoqoftë unë duhej t'i vihesha e ta rishkruaja dhe një herë atë pjesë të historikut për çetën e famshme të Bilbilenjve. Kisha gjetur dhe një provë materiale, kamën.

— Ç'bluan kështu në kokë? — pyeti plaku.

— Po sikur, — thashë, — atë kamën ta shkullim nga shkëmbi? Është një send shumë i çmuar për muzeun e fshatit.

— Jo! — tha plaku me vendosmëri. — Dhe kjo shpellë është një muze i gjallë. Për atë kamë asgjekundi s'mund të ketë një vend më të mirë. Bilbilenjtë kështu e kanë gjetur këtë shpellë dhe na e lanë me një kamë më shumë. Kjo kamë na thotë se shpella është vetëm e atyre.

— Sikur të kishim pasur me vete të paktën një aparat, — psherëtiva unë që, prej arsyesimit të plakut, isha tërhequr nga kërkesa ime.

— Shkruaj për të gjitha, — tha plaku, — se për të gjitha mund të shkruhet! Atyre edhe vdekja u pati hije!

— *Ngrehu, Bilbil, hidh litarë!*

— *Dale, bej, të dredh cigarë!*

*Dale, bej, të kreh mustaqet,*

*se s'jam çanaku me dhallë,*

*po jam Bilbili me pallë!*

Këto vargje kaq të njohura, epigrami i Bilbilenjve dhe i vetë trimërisë, po i përjetoja unë atje në shpellën e famshme të tyre. Më kishin buçitur papritur nga kraharori, i rrëmbyer nga një ndjenjë e çuditshme dehëse.

Zëri im shumëfishohej nga hoset e buzat që ia pasonin njëra-tjetrës dhe të ngjante sikur nga majat e gjithë çipinëve të Çoçkos po deklamoni vargjet e këngës së famshme. Plaku më dëgjonte i heshtur, me një ndjenjë habie, se, siç dukej, nuk e kishte pritur shpërthimin tim kaq të befasishëm. Dhe në fytyrën e tij endej kënaqësia.

— Po! — tha plaku Babuden, kur unë mbarova së recituar, dhe po-ja e tij tingëlloi me një akustikë të tillë, sikur shpella ta shqiptonte me gojën e saj të zgavruar.

— Kënga për Bilbilenjtë kaloi gojë më gojë e brez më brez, si shpata dorë më dorë.

U nisëm për të dalë nga Shtegu i Ilqes, plaku Babuden para, unë pas tij. U kapëm pas kërrabave të varura te ilqja. Dolem te petaraqi, që i rrethohej çipinit për mesi si një kular gjarpri dhe më në fund u gjendëm në kreshtën e tij. Tani

hapësira e qiellit u shfaq me tërë pafundësinë. Plaku Babuden gjatë gjithë rrugës, si zakonisht, eci pa folur, gjersa arritëm në stan. Aty hodhëm shëllirë kaçupi në një tas, e holluam me ujë dhe e pimë në vend të dhallit. Pastaj plaku shkoi nga kopeja e shterpave, ndërsa unë qëndrova në kasolle. Tani që kisha mbetur vetëm, të gjitha mendimet më shpinin te shpella, nga e cila sapo isha kthyer. Ndieja një kënaqësi të veçantë. Unë tani për Bilbilentë mund të flisja më me siguri e për ta dija shumë më tepër se më parë. Aty për aty më lindi ideja të shkruaja një reportazh për gazetën «Zëri i rinisë». Nxora bllokun e shënimeve dhe fjalët e para që shkrova qenë: «Duke kërkuar një shpellë».

## P È R M B A J T J A

E QARA E JETËS .....	3
PARTIZANI NË SHTËPI .....	78
BUKA .....	122
KUR HUMBET ÇDO FYTYRË NJERIU .....	133
DUKE KËRKUAR NJË SHPELLË .....	145